Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (190) QERSHOR 2022. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market
PESHKOPI MAQELLARË
Plot oferta dhe surpriza...

OPINION

Dibra sot ka nevojë për të gjithë

HIDROCENTRALI I SKAVICËS NUK SHKATËRRON VETËM DIBRËN

Nga **SHEMSI PRENÇI** — Faqe 9

REPORTAZH

Rrugëtim ndër vite me "Sarinën"

SHKOLLA JOPUBLIKE "SARINA 2002" FESTON 20-VJETORIN

Nga **SHAQIR SKARRA** — Faqe 12-13

SPORT / SHPËTIM TOSKA:

Biografia m'u bë pengesë, por publiku ishte krah meje

Nga **ADRIATIK BALLA** — Faqe 21

TREGIM

TAKIMI

Tregim nga Agron Tufa

— Faqe 16

Mziu: **NË RRUGËN E ARBRIT NUK PUNOHET**. KOSTO E NDËRTIMIT ËSHTË ABUZIVE.
Balluku: TUNELI I MURRIZIT ËSHTË ZGJATUR, POR **VLERA E KONTRATËS MBETET E PANDRYSHUAR**

Rruga e Arbrit, zgjatet me 17 muaj afati i përfundimit të punimeve

Qeveria shqiptare kishte vendosur që më datë 20 tetor 2020 zgjatjen e kontratës së ndërtimit të Rrugës së Arbrit, por vendimi u bë publik vetëm gjatë interpelancës së kërkuar nga deputeti i Dibrës Xhelal Mziu më 7 korrik 2022. Gjatë këtyre 20 muajve as Autoriteti Kontraktor i Rrugës së Arbrit, as kompania ndërtuese, as ndonjë anëtar i qeverisë apo deputet i parlamentit nuk kishin bërë publik vendimin. Zgjatja e afatit e çon përfundimin e rrugës në nëntor 2023.

DIBËR & MAT

Një destinacion magjik turistik



Në foto: Pamje nga një udhëtim me biçikleta gjatë shtegut Golema Planinë - Zhirovnicë në kuadër të projektit Cross-Border Biking, zbatuar nga AL-CDF - Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokala, financuar nga Bashkimi Europian. Foto. © Andi Qyqja

- **Qarku i Dibrës, një nga destinacionet më të bukura të Shqipërisë**
- **10 turet shumëditore**
- **Udhëtim me biçikletë maleve**

Lexoni në faqet 4-8

NË BRENDËSI:

■ **Imam Rushiti** i *Radomirës* ■ *Nëpër kohëra, nëpër vite…* ■ Prof.**Shpëtim Cami** *"koherent me ato çka thotë e bën"* ■ **Çukitje kujtimesh** *në petale jetësh që prej gjysëm shekulli* ■ *Veçanti në* **ndarjet kanunore** *në Dibër* ■ **Xhafer Martini**: *Historiani dhe shkrimtari* ■ *Promovohen dy libra të autorit* **Jahe Delia Selmani** ■ *Poezia si shprehësi lirike dhe bartëse e unit origjinal* ■ *Çmallesh kur kujton vitet…* ■ **Adivie Lazri**, *zonja e hekurt e maleve të Dibrës* ■ *"Akademik", titull i merituar për shkrimtarin dhe publicistin* **Halil Rama** ■ *Duert e Nànës…*

REDAKSIA E GAZETËS JU URON TË GJITHË BESIMTARËVE MYSLIMANË GËZUAR FESTËN E KURBAN BAJRAMIT! PAÇI GJITHMONË PAQE DHE HARMONI NË FAMILJET TUAJA!

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbrit, zgjatet me

Qeveria shqiptare kishte vendosur që më datë 20 tetor 2020 zgjatjen e kontratës së ndërtimit të Rrugës së Arbrit, por vendimi u bë publik vetëm gjatë interpelancës së kërkuar nga deputeti i Dibrës Xhelal Mziu më 7 korrik 2022. Gjatë këtyre 20 muajve as Autoriteti Kontraktor i Rrugës së Arbrit, as kompania ndërtuese, as ndonjë anëtar i qeverisë apo deputet i parlamentit nuk kishin bërë publik vendimin. Zgjatja e afatit e çon përfundimin e rrugës në nëntor 2023.

Deputeti i Dibrës Xhelal Mziu zhvilloi të enjten (7 korrik 2022), një interpelancë me ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku, për ecurinë e punimeve në Rrugën e Arbrit.



XHELAL MZIU:
“Gjysma e rrugës ka mbaruar në kohën e PD dhe ka kushtuar 70 milionë euro. Më pak se gjysma e rrugës që është në ndërtim do të kushtojë 336 milionë euro. Çfarë standardi ka kjo rrugë që kushton 5 herë më shumë?”



BELINA BALLUKU:
“Vlera e kontratës koncensionare që është 33.6 milionë lekë do të mbetet e pandryshueshme, edhe pse projektzbatimi është rishikuar, pasi ky ndryshim projekti është njohur nga autoriteti kontraktor si kusht lehtësimi, bazuar në përcaktimet kontraktuale”

MZIU: NË RRUGËN E ARBRIT NUK PUNOHET. CILËSIA E NDËRTIMIT NUK I PLOTËSON STANDARDET. KOSTO E NDËRTIMIT ËSHTË ABUZIVE.

“Pritëm edhe ca ditë nga afati përfundimtar i pritur për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, por ngaqë nuk pati asnjë njoftim, u detyruam të kërkojmë këtë interpelancë me ministren, në lidhje me këtë aks rrugor me rëndësi kombëtare”.

Deputeti Mziu e nisi fjalën e tij me një citim nga kryeministri Edi Rama në vitin 2013, që duke iu referuar rrugëve të pambaruara, thoshte “rrugët e lëna rrugëve”. Rama pati premtuar në atë kohë se “puna e parë që do të bënte ishte ndërtimi i Rrugës së Arbrit”.

“Nga viti 2005 deri në vitin 2009 në Rrugën e Arbrit u ndërtuan më shumë se 20 km me standarde bashkëkohore. Gjithashtu, u ndërtuan edhe 13 km të tjera, punimet e të cilave ishin kryer mbi 80 %, nënvizoi Mziu. Sipas tij, këto segmente rruge të ndërtuara deri në vitin 2013 kanë kushtuar jo më shumë se 70 milionë euro.”

“Me ardhjen e Rilindjes jo vetëm që puna nuk filloi në mandatin e parë, por iu desh vite për ta filluar. Dhe për këtë rrugë u bë një shpikje: U krijua fondi 1 miliardë për investime publike përmes skemës PPP. Dhe rruga e parë që do të bëhej ishte Rruga e Arbrit”, tha deputeti i Dibrës, zgjedhur me votat e Partisë Demokratike.

“Kjo rrugë ka mbetur rrugëve, sepse jo vetëm që nuk ka mbaruar, por nuk ka mbaruar as gjysma”, tha Mziu.

Mziu kritikoi cilësinë e ndërtimit, e cila nuk përmbush standardet e një rrugë nacionale, jo më të një rruge ndërkombëtare që të çon në Shkup.

“Rruga në 3D duket një rrugë vërtet bashkëkohore, por ato segmente që kanë mbaruar nuk plotësojnë asnjë standard”, tha Mziu.

Mziu akuzoi kompaninë ndërtuese për abuzim në ndërtimin e rrugës.

“Në uebsajtin e ‘Gjokës’ është shkruar se segmenti Bulqizë - Ura e Vashës është rrugë e përfunduar, madje tregon edhe se është hedhur edhe 41,200 m2. Ku është ky asfalt?!” - pyeti Mziu. Ai tha se për këtë segment rrugor janë marrë lekët dhe se rruga duhet të kishte përfunduar në vitin 2014.

Mziu tregoi në parlament disa foto ilustruese të këtij segmenti të pambaruar.

Mziu më pas akuzoi qeverinë se për të justifikuar vonesat e ndërtimit të tunelit, “shpikën ndërtimin e një by-passi”, ku kanë ndodhur shumë aksidente, edhe me pasojë vdekje.

Duke treguar një urë që nuk gjendet në terren, Mziu aludoi për ndryshime të projektit pa marrë miratimin e autoriteteve shtetërore.

Deputeti i Dibrës akuzoi edhe për shkelje të standardeve të ndërtimit, duke sjellë rastin e rrugës dogana e Bllatës - rrethrrotullimi i Maqellarës, një segment rrugor që nuk i përshtatet standardit C2.

“Kjo rrugë duhet të ishte 13 m, asfalti duhej të ishte 9 metra dhe nga 2 metra trotuar në secilën anë. Në fakt asfalti është vetëm 7 metra”, tha Xhelal Mziu.

Mziu tha se kthesat në rrugë nuk përmbushin standardet e ndërtimit si dhe ka pasur shembje të rrugës pothuajse në të gjithë gjatësinë e saj.

“Daljet nga dy tunelet për në urë janë me kthesa më pak se 90 gradë, që nuk është e standardit C2. Në çdo segment të rrugës saj ka cedim 50-60 metra”.

Mziu akuzoi për shpërdorim fondesh në ndërtimin e rrugës si dhe për braktisje të punimeve nga kompania “Gjoka ‘87”.

“Gjysma e rrugës ka mbaruar në kohën e PD dhe ka kushtuar 70 milionë euro. Më pak se gjysma e rrugës që është në ndërtim do të kushtojë 336 milionë euro. Çfarë standardi ka kjo rrugë që kushton 5 herë më shumë?”, pyeti Mziu.

Ai tha se “Gjoka sapo mbylli tunelin e Skërficës, është duke ndërtuar një segment të unazës së madhe të Tiranës dhe është duke ndërtuar tunelin e Llogarasë”.

“Që nga 29 nëntori 2021, kur u inaugurua, asnjë mjet i kompanisë nuk është duke punuar në rrugë”, tha deputeti Mziu.

Vonesat në ndërtimin e Rrugës së Arbrit deputeti Mziu i lidhi me faktin e humbjes nga PS të zgjedhjeve parlamentare në Dibër si dhe ndikimin e lobit grek dhe serb në pengimin e lidhjes së Tiranës me Shkupin me një rrugë shumë të shkurtër.

“Rruga ka ngelur rrugëve vetëm për një shkak, dhe kjo është e qëllimshme: humbja që morën në Dibër si dhe për shkak të lobit grek e serb, sepse Ballkani i Hapur kërkon akse të tjera oportune” - deklaroi Mziu.



Në foto: Pamje nga segmenti i rrugës së Arbrit pranë Urës së Vashës në Klos.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 6 (190). Qershor 2022
Gazeta doli nga shtypi, 9 korrik 2022.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit korrik 2022.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra
Editor i faqes online: Agim Deva
Kontribuan për këtë numër:
Agron TUFA
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Adriatik BALLA
Besnik ALKU
Haki PËRNEZHA
Xhafer MARTINI
Shemsi PRENÇI
Eglantina ALLIAJ
Qazim D. SHEHU
Ilmi DERVISHI
Selma MËZIU
Mevlud BUCI
Kujtime ISLAMI - SARAÇI
Halil RAMA
Destan RAMA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Balluku: "Inxhinieri i pavarur, Instituti i Ndërtimit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar kanë dhënë mendim për alternativën e dytë si zgjidhja më e mirë, e cila kërkonte spostimin e hyrjes së tunelit të Murrizit, gjë që solli rritjen e këtij tuneli me 500 metra, duke e çuar nga 3256 metra në rreth 3800 metra, kosto kjo e cila nuk cenon shumën totale të pagesës për këtë vepër nga qeveria shqiptare"

17 muaj afati i përfundimit të punimeve



"Nga viti 2005 deri në vitin 2009 në Rrugën e Arbrit u ndërtuan më shumë se 20 km me standarde bashkëkohore. Gjithashtu, u ndërtuan edhe 13 km të tjera, punimet e të cilave ishin kryer mbi 80 %. Këto segmente rruge të ndërtuara deri në vitin 2013 kanë kushtuar jo më shumë se 70 milionë euro."

"Rruga ka ngelur rrugëve vetëm për një shkak, dhe kjo është e qëllimshme: humbja që morën në Dibër si dhe për shkak të lobit grek e serb, sepse Ballkani i Hapur kërkon akse të tjera oportune" – Xhelal Mziu.

BALLUKU: NUK KA SHTESË FONDESH. TUNELI I MURRIZIT ËSHTË ZGJATUR, POR VLERA E KONTRATËS MBETET E PANDRYSHUAR: 33.6 MILIONË LEKË.

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku e nisi fjalën e saj duke theksuar rolin e rëndësishëm të qeverisë në synimet e saj për ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

"Kjo rrugë kaq e rëndësishme filloi të realizohej vetëm pasi qeveria Rama bëri të gjitha studimet mbi ato studime që ishin bërë nga viti 2007 deri në vitin 2013. Se cilat kanë qenë kushtet teknike të parashikuara në ato studime dhe si janë ato sot".

Ajo mbrojti punën e kompanive shqiptare në ndërtimin e rrugëve, përfshirë edhe kompaninë "Gjoka Konstruksion"

"Kompanitë shqiptare po i ndërtojnë sot veprat në mënyrën më të mirë, ato kanë fituar eksperiencë dhe meritojnë respekt".

Balluku tha se zyrtarisht punimet në Rrugën e Arbërit kanë filluar në korrik 2018 dhe i gjithë projekti do të zgjasë 13 vjet, përfshirë periudhën ndërtimore dhe atë të mirëmbajtjes.

"Rruga e Arbrit përfshin një gjatësi 70 km nga Tirana deri në Maqellarë, si dhe dy rrugë lidhëse, ajo e Klosit 2.42 km dhe rruga Maqellarë - Bllatë 3 km. Në total rruga është rreth 75 km, nga të cilat 20.12 km janë ndërtuar në vitet 2009-2011 nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve", tha Balluku.

"Vlera e kontratës koncensionare është tridhjetë e tre milionë milionë e gjashtëqind mijë lekë, sipas përcaktimeve kontraktore miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 28 mars 2918", theksoi Balluku.

Sipas ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, "nga korriku 2018 deri në maj 2022 janë realizuar punime në vlerën 26 milionë e 590 mijë lekë. Për periudhën 2018-2022, nga buxheti i shtetit është financuar shuma në vlerën 9 milionë e 900 mijë lekë, në përputhje me vlerat e përcaktuara në modelin financiar të miratuara në kontratë".

Balluku mohoi të ketë pasur shtesë fondesh për ndërtimin e rrugës.

"Jo vetëm që nuk kemi shtuar para në këtë kontratë, por janë bërë pagesat sipas kalendarit të punimeve."



Pamje nga kantieri i tunelit të Murrizit, i braktisur më 9 maj 2019.

"Vlera e kësteve që autoriteti kontraktor do të paguajë deri në fund të kontratës do të jetë vlera e miratuar nga VKM nr. 180. Nuk ka shtesë dhe nuk do të ketë shtesë të fondeve në këtë kontratë".

Duke folur për shtyrjen e afatit të punimeve, Balluku tha se "është kërkuar kohë shtesë për ndërtim prej 17 muajsh, duke pasur parasysh periudhën e pezullimit të punimeve në tunelin e Murrizit sipas projektit fillestar. Mbi kohën e ndërtimit, e cila ka qenë 44 muaj, duke e çuar periudhën e ndërtimit në 61 muaj. Aktualisht jemi në muajin e 46 të punimeve, ku kemi garantuar ecuri punimesh në përputhje me grafikun e punimeve të rishikuar, me cilësi dhe përputhje me standardet e ndërtimit".

"Vlera e kontratës koncensionare që është 33.6 milionë lekë do të mbetet e pandryshueshme, edhe pse projektzbatimi është rishikuar, pasi ky ndryshim projekti është njohur nga autoriteti kontraktor si kusht lehtësimi, bazuar në përcaktimet kontraktuale", tha Balluku gjatë interpelancës me deputetin Mziu.

Balluku i justifikoi vonesat për shkak të punimeve në tunelin e Murrizit.

"Punimet në tunelin e Murrizit filluan në tetor 2018. Për shkak të probleme gjeologjike, më datë 9 maj 2019 u pezulluan punimet me urdhër të inxhinierit të pavarur dhe kanë rifilluar pas miratimit nga autoriteti kontraktor me datë 20 tetor 2020"

Sipas raportit gjeologjik të kryer për këtë rast, rezultoi se kostot e vazhdimit të punimeve do të ishin shumë të mëdha. Balluku tha se janë pritur rekomandimet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përpara se të rifillonte puna në tunel.

Sipas Ballukut, shoqëria koncesionare paraqiti tre alternativa për rifillimin e punimeve.

Alternativa e parë parashikonte vijimin e punimeve të hyrjes së tunelit sipas projektit të miratuar dhe zgjidhjet përkatëse, por duke pasur kosto të lartë financiare dhe impakt negativ në mjedis.

Alternativa e dytë parashikonte shmangien e rrugës dhe të tunelit nga formacionet rrëshqitëse, ndërkohë që një alternativë e tretë ishte ndërtimi i një tuneli dhe një segmenti totalisht të ri.

"Për shkak të kostove, alternativa e parë dhe e tretë u hodhën poshtë, duke u zgjedhur alternativa e dytë për vazhdimin e punimeve", tha Balluku.

"Inxhinieri i pavarur, Instituti i Ndërtimit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar kanë dhënë mendim për alternativën e dytë si zgjidhja më e mirë, e cila kërkonte spostimin e hyrjes së tunelit të Murrizit, gjë që solli rritjen e këtij tuneli me 500 metra, duke e çuar nga 3256 metra në rreth 3800 metra, kosto kjo e cila nuk cenon shumën totale të pagesës për këtë vepër nga qeveria shqiptare", tha Balluku.

Sipas saj, më 20 tetor 2020 Ministria e Infrastrukturës ka miratuar ndryshimin teknik për projekt-zbatimin për tunelin e Murrizit, duke i hapur rrugën rinisjes së punimeve.

Balluku solli në vëmendje disa ndryshime thelbësore të projektit nga ai i vitit 2008. "Projekti i vitit 2008 ishte i standardit C3, ndërsa sot po ndërtohet një rrugë e standardit C2; rrezja minimale e kthesave ishte parashikuar 16-20 metra, ndërsa sot është minimumi 120 metra; pjerrtësia maksimale në 2012 ka qenë 7.75%, jashtë çdo standardi, ndërkohë që sot është rreth 6 %. Kuota maksimale e rrugës ka qenë 948 m mbi nivelin e detit, ndërsa sot është 862"

Duke vlerësuar standardet në rritje të ndërtimit, Balluku solli në vëmendje gjatësinë totale të tuneleve në rrugë.

"Rruga e Arbrit ishte parashikuar atëherë të kishte vetëm 2.6 km tunele, ndërsa sot ka 7.8 km tunele, që tregojnë standardet se si kjo rrugë është ndërtuar", vlerësoi ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku.

***

Megjithëse në debat u përfshinë edhe deputetë të tjerë të parlamentit, afati për mbarimin e segmenteve të ndryshme të rrugës mbeti pa përgjigje.

Ajo që bie në sy gjatë debatit parlamentar është fakti se pse qeveria shqiptare dhe institucionet përgjegjëse nuk kishin bërë publik faktin e zgjatjes së kontratës së ndërtimit, një vendim i marrë më shumë se 1 vit më parë, para se të hapej rruga për qarkullimin e mjeteve në nëntorin e kaluar.

Gjithashtu, gjatë debatit nuk iu dha përgjigje as afatit se kur segmenti i rrugës përgjatë Planit të Bardhë, që lidh Urën e Vashës më Bulqizën, do të vihej në funksionim.

Debati politik e ka shoqëruar Rrugën e Arbrit që nga nisja e punimeve në vitin 2005 dhe duket se do ta shoqërojë deri në përfundimin e saj në fund të vitit 2023.

Deri atëherë nuk dihet nëse segmente gjysmë të ndërtuara si ai i Planit të Bardhë apo përgjatë lumit të Tiranës do të përfundojnë më parë, apo nëntori i vitit 2023 do të jetë dita zyrtare e përfundimit të punimeve.

Rruga e Arbërit nr. 190



DIBËR & MAT

Një destinacion magjik turistik



Nisma e krijimit të DMO në qarkun Dibër, është një nismë pilote në Shqipëri, në kuadër të programit "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri (SRD)", financuar nga Organizata ndërkombëtare Gjermane e Zhvillimit (GIZ) dhe zbatuar për qarkun Dibër nga Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale (ALCDF).

Nga **BUJAR KAROSHI**

Bujtina "Çeliku" në Kurdari, rreth 55 km larg nga Tirana u hap zyrtarisht më 29 qershor, gjatë një veprimtarie që kishte për qëllim promovimin dhe mbështetjen për turizmin në qarkun e Dibrës.

Bujtina Çeliku ka 10 dhoma me një kapacitet rreth 40 shtretër, është një destinacion i ri i turizmit në rajon.

"Vendosur në mes malit dhe liqeneve Balgjaj, është ndërtuar një tjetër bujtinë e rrjetit të ri agroturistik të Shqipërisë, ku familja Çeliku me përkrahjen e qeverisë përmes programeve të AZHBR, po zhvillon vreshtarinë, arrat si dhe serat me produkte bio, prej nga ku gatuhen edhe ushqimet e menusë së bujtinës "Çeliku". Lumi Mat, Kepi i Skëndërbeut, Ura e Vashës e shumë atraksione të tjera që ofron zona, e bëjnë qëndrimin me familjen e shoqërinë në këtë bujtinë një ripërtëritje të vërtetë për trupin e mendjen", e prezantonte në faqen e tij bujtinën kryeministri Edi Rama në maj të këtij viti.

Me 29 qershor 2022 në mjediset e bujtinës së re në qarkun e Dibrës u mblodhën aktorët kryesorë të zinxhirit të turizmit të qarkut Dibër, që nga pronarë dhe menaxherë hotelesh, bujtinash, guida turistike, artizanë, agjenci udhëtimi dhe përfaqësues të institucioneve të pushtetit lokal, Prefekturës, Qarkut, Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, media dhe shoqëria civile për të promovuar nismën e forcimit të rrjetit të aktorëve të turizmit në nivel rajoni dhe krijimin e DMO, Organizata e Menaxhimit të Destinacionit në nivel rajonal për Qarkun Dibër.

Nisma e krijimit të DMO në qarkun Dibër, është një nismë pilote në Shqipëri, në kuadër të programit "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri (SRD)", financuar nga Organizata ndërkombëtare Gjermane e Zhvillimit (GIZ) dhe zbatuar për qarkun Dibër nga Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale (ALCDF).

Duke folur për arritjet e kësaj faze të projektit, Dhurata Gazhelli, përfaqësuese e GIZ në Shqipëri tha se janë të befasuar nga bashkëpunimi i aktorëve të turizmit në qark dhe nisur nga kjo, projekti i GIZ do të vazhdojë në një fazë tjetër katër vjeçare, me qëllim nxitjen e turizmit në këtë rajon.

Duke folur për ngritjen e bujtinave në rajon, Gazhelli i tha televizionit lokal "Dibra News" se "këta janë njerëz shumë guximtarë".

"I përgëzoj të gjithë aktorët e turizmit rural në qarkun e Dibrës, sepse janë shumë bashkëpunëtorë njëri me tjetrin".

"GIZ nuk është hera e parë që investon për turizmin në Shqipëri. Modeli i parë është ai i Thethit, i cili është një model që ka sukses në fushën e turizmit. GIZ nuk pretendon që ti bëjë gjera vetë. GIZ punon për angazhimin e aktorëve lokalë që të krijojë produkte".

"Tani kemi një broshurë dhe një produkt turistik në nivel rajonal, jo vetëm për 1-2 ditë, por për të mbajtur turistë më shumë se 6-7 ditë", tha Dhurata Gazhelli.

Besnik Alku nga Fondacioni ALCDF, duke prezantuar arritjet e kësaj faze të projektit, tha se "Dibra ka mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit".

"Duke bashkëpunuar aktorët lokalë të turizmit, mundësitë e rritjes së shërbimeve turistike në rajon janë plotësisht të mundshme".

Alku prezantoi një studim të kryer nga ALCDF në prill 2022, mbi orientimet strategjike të zhvillimit të destinacionit turistik në qarkun e Dibrës.

"Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se në Qarkun Dibër vizitohet nga rreth 87 000 vizitorë vendas dhe të huaj".

"Në krahasim me rajonet e tjera përreth, ky numër është shumë i vogël", thotë Alku, por mundësitë e Dibrës për zhvillimin e turizmit janë të mëdha.

KUSH E VIZITON DIBRËN?

Vizitorët vendas kanë numrin më të lartë, rreth 87% dhe vizitorët e huaj janë me numër më të ulët, rreth 13%.

Rrjedha e vizitorëve vendas është e lidhur kryesisht me origjinën nga qarku i Dibrës që banojnë në Tiranë, Durrës apo jashtë vendit. Vijnë te të afërmit për rastet e eventeve familjare, nostalgji për vendlindjen për fundjavë. Emigrantët dhe familjet e tyre që vijnë në pushimet e verës dhe përbëjnë afërsisht 62% e vizitorëve.

Një grup tjetër vizitorësh janë ata që vijnë për kurim në Llixhat e Peshkopisë. Ky grup i vizitorëve përbën rreth 17% të vizitorëve vendas dhe janë kryesisht nga Shkodra, Kukësi, Lezha, Durrësi, Tirana, Fieri dhe nga zonat fqinje të Maqedonisë dhe Kosovës.

Vizitorët që vijnë për fundjavë dhe për kulinari janë një grup i konsiderueshëm dhe që po vjen në rritje dhe me hapjen rrugës së Arbërit. Deri në fazën e studimit, ky grup përbën rreth 8% të vizitorëve dhe shumica ishin nga Tirana dhe Durrësi që frekuentojnë restorantet tradicionale, bujtinat dhe hotelet e qyteteve dhe rrethinave. Ky grup është i interesuar për cilësinë e produkteve të zonës, kulinarinë tradicionale dhe natyrën e bukur piktoreske.

Në studim janë evidentuar edhe amatorët e natyrës dhe aventurës, të cilët përbëjnë 4 % të vizitorëve vendas. Grupi është më shumë nga të pasionuarit që frekuentojnë rajonin e Dibrës për ecje dhe ngjitje në mal, për rafting në lumin Drini Zi, për turet e biçikletave malore dhe me makina off road.



Një grup prej 3% janë vizitorët për arsye pune, që vizitojnë kryesisht hotelet dhe restorantet e qytetit.

Vizitorët e huaj në qarkun e Dibrës janë afërsisht 11500 në vit, ose 13% e vizitorëve dhe kryesisht vijnë nga Gjermania, Austria, Çekia, Polonia, Zvicra, Franca, Anglia, Italia dhe vende të tjera Europiane.

Vizitorët e huaj preferojnë natyrën malore dhe piktoreske, ku më shumë janë të pasionuar për ecje në natyrë dhe ngjitje malore, si dhe kamping. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të pasionuar pas aventurës, për biçikletat malore, rafting, makinat off road etj. Shtigjet dhe zonat më të frekuentuara për ta janë zonat e Qafë Shtamës, Lura me liqenet akullnajore, vargmali i Korabit dhe Lumi Drin i Zi për rafting dhe Shkopeti për kanoe.

SEZONI TURISTIK

Sezoni më i frekuentuar është sezoni i verës, por edhe gjatë muajve të fundit të pranverës dhe të vjeshtës ka një numër të konsiderueshëm vizitorësh.

Vizitorët vendas preferojnë muajin Gusht më shumë për pushime dhe për evente familjare, si dhe muajt me numër të konsiderueshëm janë Maj dhe Qershor si dhe Tetori dhe Shtatori dhe janë muaj më të frekuentuar nga pushuesit në Llixhat e Peshkopisë.

Vizitorët e huaj kanë preferuar më shumë muajin Qershor, Korrik dhe Gusht. Megjithëse e favorshme për stinën e Dimrit pak shumë frekuentohet rajoni i Dibrës gjatë kësaj stine.

Sabri Shahini, i cili ka në pronësi një Bujtinë në fshatin Rabdisht, thotë se këtë vit janë të kënaqur me interesin e rritur dhe prenotimet. Bujtina e tij u bë funksionale për





"GIZ nuk është hera e parë që investon për turizmin në Shqipëri. Modeli i parë është ai i Thethit, i cili është një model që ka sukses në fushën e turizmit. GIZ nuk pretendon që ti bëjë gjera vetë. GIZ punon për angazhimin e aktorëve lokalë që të krijojë produkte".

"Pozita gjeografike e favorshme me kufij me qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Maqedoninë e Veriut, afër tregjeve më të mëdhenj kombëtare dhe ndërkombëtarë, është një mundësi e mirë për rritjen e turizmit. Hapja plotësisht e rrugës së Arbrit do të ofrojë një mundësi të mirë për rritjen e shpejtë të sektorit të turizmit.

grupet turistike para pandemisë, dhe dy vitet e vështira të pandemisë e ndërprenë rritjen e biznesit, por ky vit duket i mbarë.

"Turistët e huaj janë shumë të kënaqur me kushtet dhe natyrën, ndërsa turistët vendas janë të pakënaqur me rrugën. Kjo i frenon ata për të ardhur në fshat me familjet e tyre. Me ndërtimin e rrugës, 4 km, që na është premtuar se do të fillojë së shpejti, ne presim një fluks në rritje të turistëve vendas, jo vetëm gjatë verës, por gjatë gjithë vitit.

Rabdishti ofron mundësi të jashtëzakonshme të zhvillimit të turizmit malor. Ndërtimi i një Zipline për ngjitjet në mal është i mundshëm, por gjithashtu ofrohen edhe shtigje të tjera turistike, prej vështirësisë normale deri të vështirësia e lartë, që kërkon andrenalinë dhe fton për aventurë.

MUNDËSITË PËR ZHVILLIM

Grupi i hartimit të planit strategjik të zhvillimit të turizmi nga ALCDF ka evidentuar disa mundësi çështje kyçe që ofrojnë një rritje të shpejtë të turizmit në rajon.

Së pari në studim janë evidentuar bukuritë e shumta natyrore, flora dhe fauna e pasur në dy luginat më të mëdha lumore në vend: Drini dhe Mati. Gjithashtu, atraksione të njohura dhe të frekuentuara në nivel kombëtarë si burimi termal i Llixhave të Peshkopisë, Lura me 7 liqene akullnajorë; mali më i lartë në Shqipëri, Korabi; lugina e Shkopetit dhe Ulzës; trashëgimia e pasur historike, kulturore, arkitektura, doket dhe zakonet (Vendlindja e Skënderbeut dhe Mbretit Zog; Kullat; etj.); kulinari e pasur, me kuzhinë tipike autoktone e veçante në secilën bashki.

Një vlerë e veçantë është organizimi i grupeve artistike lokale si dhe rritja e ngjarjeve dhe festave lokale.

Pozita gjeografike e favorshme me kufij me qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Maqedoninë e Veriut, afër tregjeve më të mëdhenj kombëtare dhe ndërkombëtarë, është një mundësi e mirë për rritjen e turizmit.

Në studim vihet theksi edhe te modelet e suksesit të investimeve private në fushën e hotelerisë, restoranteve, fermave dhe agro-përpunimit, ngritjen e zyrave turistike në Peshkopi dhe Ulëz, hapja e muzeve në çdo bashki, rritja e guidave të certifikuara lokale, rregullimi i shtigjeve, vendosja e sinjalistikës dhe tabelave informuese, markimet e shtigjeve malore etj.

Hapja plotësisht e rrugës së Arbrit do të ofrojë një mundësi të mirë për rritjen e shpejtë të sektorit të turizmit.

PENGESAT

Në studimin e Planit Strategjik të Zhvillimit janë evidentuar edhe një sërë problemesh.

Një nga problemet kryesore është varfëria, e cila i ka detyruar që të shpërngulen një pjesë e madhe e banorëve të zonës. Kjo është shoqëruar dhe me ikje të investimeve lokale.

Mungesa e politikave për zhvillimin e turizmit, mungesa e investimeve serioze private, mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara për shërbimet turistike, infrastruktura jo e favorshme për nxitjen e zhvillimit të turizmit, promovim i dobët i potencialeve dhe atraksioneve turistike të zonës, cilësia e shërbimeve turistike në hotele, restorante dhe bujtina, mungesa e strategjisë së marketingut të shitjes së produkteve turistike dhe të rajonit, mungesa e fondeve etj., janë disa nga pengesat për zhvillimin e turizmit në vend.

TURIZMI KËRKON PASION

Lulzim Hupi ka çuar në vend amanetin e gjyshit të tij. Ai ka restauruar kullën e vjetër dhe ka bërë investime të reja, duke ruajtur mjedisin dhe traditën dhe duke ftuar turistë nga brenda dhe jashtë vendit.

"Ne jemi në një rajon që ka shumë energji të mirë për zhvillimin e turizmit", thotë Hupi. Ai është optimist se turizmi në rajon ka të ardhme.

"Investimet për të kthyer shtëpitë e vjetra në bujtina pritëse është një mundësi e mirë për zhvillimin ekonomik të rajonit. Tashmë kjo nuk është një ëndërr. Me zhvillimin e turizmit ka për të pasur një rritje të interesit për të investuar në fshat, duke sjellë një rritje ekonomike për fshatrat e rajonit të Dibrës. Me ndërtimin e rrugës së Arbërit do të lindë nevoja për një trajnim më të mirë për mënyrën e ofrimit të shërbimeve turistike, sepse kjo punë nuk do vetëm pasion, por do edhe dije", thotë Hupi për televizionin lokal Dibra News.

Lulzim Hupi thotë se aktualisht është emergjencë bashkëpunim mes bujtinash dhe se ky bashkëpunim duhet të rritet edhe më shumë, në krijimin e një zinxhiri bujtinash që do të ofrojnë mikpritje dhe shërbime për turistët për afate më të gjatë.

Në takimin e 29 qershorit në Kurdari të Bujtina Çeliku ishin të pranishëm shumë operatorë të turizmit në Dibër. Dhe kur i shikon të gjithë bashkë mbushesh me besim se turizmi në rajon ka të ardhme.

Takimi përmbyllës i fazës së parë të nismës për krijimin e DMO në nivel rajonal

Qarku i Dibrës, një nga destinacionet më të bukura të Shqipërisë

Me datë 29 Qershor 2022, në fshatin Kurdari, te bujtina e sapo hapur "Çeliku", u mblodhën aktorët kryesorë të zinxhirit të turizmit të qarkut Dibër, që nga pronarë dhe menaxherë hotelesh, bujtinash, guida turistike, artizanë, agjenci udhëtimi dhe përfaqësues të institucioneve të pushtetit lokal, Prefekturës, Qarkut, Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, media dhe shoqëria civile për të promovuar nismën e forcimit të rrjetit të aktorëve të turizmit në nivel rajoni dhe krijimin e DMO, Organizata e Menaxhimit të Destinacionit në nivel rajonal për Qarkun Dibër.

Nisma e krijimit të DMO në qarkun Dibër, është një nismë pilote në Shqipëri, në kuadër të programit "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale në Shqipëri (SRD)", financuar nga Organizata ndërkombëtare Gjermane e Zhvillimit (GIZ) dhe zbatuar për qarkun Dibër nga Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale (ALCDF).

Qarku i Dibrës është një nga destinacionet më të bukura të Shqipërisë, e cila dallohet nga të gjitha rajonet e tjera të vendit sepse ka:

- malin më i lartë në Shqipëri, Korabin;
- Burimet termale të Llixhave të Peshkopisë, me veti kuruese nga më të mirat në Ballkan;
- 27 Liqenet akullnajore që nga Lura, Balgjait deri në Martanesh;
- lumin Mat dhe Drini Zi, më të gjatët në Shqipëri;
- lulishtja më i vjetër urbane në Shqipëri "Mbretëresha Geraldinë" në Burrel;
- Burimi fantastik i lumit të Shutresë në Lac-Bruc;
- Kanionet unike të Shkopetit, Setës dhe Drinit të Zi, që janë të veçanta për peizazhin dhe sportet e aventurës;
- Minierat më të madha në Ballkan të kromit në Bulqizë;
- "Bjeshkët e bekuara" të ngjyrave të Korabit, Gramës, Rabdishtit, Hinoska, Kerçini, pjesë e shtegut Ballkanik SCARDUS;
- Vendi i mbretërve, heroit kombëtarë Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Ahmet Zogut;
- Vendi i Kullave të gurta të Arbërit;
- Plantacionet më të mëdha të frutave të qershisë dhe mollëve;
- Zona e jufkave dhe sheqerpares, pjesë e markës autoktone të produkteve Shqiptare, dhe shumë e shumë bukuri magjike.



Për 18 muaj, të gjithë aktorët e turizmit në bashkitë e Matit, Klosit, Bulqizës dhe Dibrës punuan sëbashku, shkëmbyen eksperiencat, analizuan rrjedhën e vizitorëve strategjik në zonën e tyre, zhvilluan dokumentin me orientimet strategjike, produktet turistike të nëntë shtigjeve shumë ditore, me 5 deri në 7 ditë në nivel rajonal, dhe tashmë janë të gatshëm për të forcuar rrjetin e tyre dhe për të krijuar një strukturë të fortë të DMO që të merret me menaxhimin e destinacionit Dibër-Mat.

"Në këtë mënyrë, rajoni i Dibrës do të jetë rajoni i parë në Shqipëri që do të ketë një DMO, - thotë Dhurata Gazulli, përfaqësuese e GIZ në Shqipëri, - model që GIZ po punon për ta ngritur në nivel kombëtarë duke ndihmuar qeverinë Shqiptare të hartojë një kuadër të duhur ligjor dhe të krijojë modele të DMO në rajone tjera".

Ekspertët e ALCDF, sëbashku me aktorët e turizmit kanë zgjedhur prioritetet kryesore të zhvillimit të turizmit në qarkun Dibër, të cilat janë të lidhura me orientimin e atyre elementeve potenciale që ofron ky destinacion, si më tërheqësit për vizitorët dhe më konkurrues me rajonet e tjera.

Këto elementë prioritarë të zhvillimit të produkteve turistike në këtë destinacion janë:

- Natyrë dhe peizazhe të mrekullueshme, me liqene, lumenj, male, gryka, kanione, pyje dhe kullota të bekuara, që mundësojnë aktivitete të larmishme turistike për të gjithë grupet e vizitorëve, vendas dhe të huaj.
- Fundjava, pushime familjare dhe relaks mes bukurive të natyrës dhe pranë restoranteve, hoteleve, kampingjeve ku shërbehet me thjeshtësi gatimet tradicionale të një kuzhine të pasur autoktone, me produkte natyrale nga fermat dhe kopshtet e shumta të fshatrave të kësaj zone që jeta tradicionale dhe eksperienca lokale është e ruajtur me fanatizëm.
- Aventurë dhe adrenalinë për të gjithë të pasionuarit e ecjeve në mal, rafting, me biçikleta malore, makina off road 4x4, me kajak në liqene, për eksplorim në shpellave dhe minierave dhe plot surpriza të tjera.
- Histori, kulturë dhe art, si një vend me histori të pasur të figurave më të ndritura historike, plot me legjenda dhe histori të panjohura, me kulla të gurta, me ngjarje dhe evente artistike dhe ku mund të shikosh dhe provosh produktet e artizanëve të zonës që përgatisin veshjet popullore, rakinë, verën, produktet blegtorale dhe shumë krijime të tjera.

Tashmë me hapjen e rrugës së Arbrit, potencialet turistike të qarku të Dibrës janë më afër tregut të madh vendas dhe të huaj. Shfrytëzimi i këtyre potencialeve turistike kërkon angazhimin e gjithë aktorëve kyç të turizmit në rajon, por dhe të komunitetit, të cilët duhet të njohin vendlindjen e tyre, dhe pastaj të jenë ambasadorët dhe udhërrëfyesit e turizmit të këtij destinacioni të magjishëm.

Pjesëmarrësit në këtë takim u njohën me broshurën turistike të destinacionit Dibër-Mat, hartën turistike dhe me zemër dhe mendje të hapur ata theksuan me nota optimizmi që turizmi do të zhvillohet në rajonin e Dibrës dhe Organizata e Menaxhimit të Destinacionit (DMO), e cila do të krijohet dhe formalizohet, do të jetë promovuesja e vlerave më të mira të mikpritjes, natyrës dhe traditës së zonave të qarkut Dibër.

Dibër-Mat një destinacion turistik magjik, atje ku mbetesh pa frymë! ***(ALCDF)***

Rruga e Arbërit nr. 190

turizëm

Guidat turistike në rajon dhe bujtinat mikpritëse janë trajnuar për ofrimin e këtyre tureve turistike, që kryesisht përfshijnë ecjet në natyre, udhëtimet me biçikleta malore dhe makinave of-road.

10 turet shumëditore në qarkun e Dibrës

TURI I ECJEVE NË NATYRË.

Qarku i Dibrës është një zonë e mahnitshme për ecjet në natyrë, ku diversiteti i relievit malorë i jep mundësi për të provuar të gjithëve të pasionuarit ecjen në natyrë, si dhe u jep mundësinë e ngjitjes në malin më të lartë të Shqipërisë, Korabi dhe në parqet me 27 liqenet akullnajore më të shumta në nivel vendi. Një zonë shumë afër metropolit që është aksi Tiranë dhe Durrës, ofron mundësinë më të shpejtë për këtë popullsi të shijojnë bukuritë e natyrës së mahnitshme të luginës së Matit dhe Drinit të Zi, që rrethohen nga këto male të bekuara dhe të bukura.

Tre janë shtigjet kryesore të identifikuar për më shumë se 5 ditë, si: "High Scardus trail" që është një shteg ndër-shtetëror mes Kosovë-Shqipëri-Maqedoni, shtegu "Ulzë-Lurë" që është një shteg që përshkon disa zona të mbrojtura dhe parqe dhe "Shtegu Arbërit" që përshkon gjithë qarkun e Dibrës që nga Mali me Gropa deri në parkun natyror Korab-Koritnik.

1. HIGH SCARDUS TRAIL



Ky shteg ndër-shtetëror Kosovë-Shqipëri-Maqedoni përshkon një pjesë të rëndësishme të territorit të Dibrës, kryesisht zonën e parkut natyrorë të Korab-Koritnik dhe Shebenik-Jabllanicë në Bulqizë. Ky shteg zgjat 7 ditë me ecje.

Dita 1: Shijo bukuritë e parku kombëtarë Shebenik-Jabllanicë.

- Nisja nga Librazhdi ose nga Struga. Shtegu kalon nëpër bukuritë e parkut kombëtarë Shebenik Jabllanicë, në luginën malorë të Fushë-Studes, ku dhe mund të shijohet dreka e parë në restorantet në këtë zonë. Pastaj ecka vazhdon përgjatë Bulqizës dhe shijohen liqenet akullnajore dhe shumë burime të tjera natyrore të këtij parku. Darka dhe akomodimi në Sebisht ose në bujtina të tjera të zonës së Gollobordës.

Dita 2: Shijoni bukuritë e grykës së madhe dhe fshatit turistik të Zerqanit.

- Ecja vazhdon përgjatë luginës së Zallit të Okshtunit, ku shijohet natyra e bukur dhe vazhdon deri në zonën e krahinës së Zerqanit e cila është e njohur për pyjet e bukura dhe livadhet e shumta. Ndalesë në fshatin Zerqan, ku shijohet dreka dhe bukuritë e këtij fshati që është pjesë e 100-të fshatrave turistik të Shqipërisë. Ecja vazhdon nëpër fushë Bulqizë dhe arrin në fshatin Lepurak te Kulla Hupi, ku është edhe darka dhe akomodimi.

Dita 3: Shijo bukuritë e bjeshkës së Hinoskës, pjesë e parkut natyrorë Korab – Korritnik

- Nisja nga fshati Popinarë dhe vazhdon ngjitja e malit të Valivarit ku shijohet bukuritë e shumta natyrore, pyjet me pishë dhe stanet e Erbarës si dhe e gjithë panorama e luginës së Drinit të Zi. Akomodimi dhe darka në bjeshkën e Hinoskës ke stanet dhe shtëpitë pritëse të Fidallarëve.

Dita 4: Shijo bukuritë e fshatit të gurtë turistik të Rabdishtit.

- Nisja nga stanet e Fidallarëve përgjatë bjeshkës së Hinoskës deri në majën me kufirin me Maqedoninë e Veriut ku shijohet pamja piktoreske e gjithë Drinit të Zi dhe parkut të Mavrovës me luginën e Radikës. Lulet e shumta mjekësore dhe tufat e bagëtive e shtojnë bukurinë e bjeshkës. Zbritja bëhet nga pjesa e bjeshkës së Rabdishtit për në fshat që është një nga 100-të fshatrat turistikë të Shqipërisë dhe dallohet për shtëpitë dhe rrugicat me gurë. Akomodimi dhe darka në Rabdisht te Bujtina Sabriu dhe Goleci.

Dita 5: Shijo bukuritë e bjeshkës së Gramës, Perla e Dibrës.

- Nisja nga Rabdishti dhe ecja përgjatë bjeshkëve të Skërtecit, Zimurit dhe arritja në Bjeshkën e Gramës, ku mund të shijohet bukuritë e shumta natyrore të kësaj bjeshke si bjeshka e Zonjave, Shllinasi, krasta e bardhë e Gramës, guri i kuq, guri i pëllumbave dhe liqeni i Gramës. Akomodimi dhe fjetja tek kampingu i staneve të Kaloshëve dhe stanet e Dede.

Dita e 6: Shijo bukuritë e bjeshkës së Shehut dhe fshatin turistik të Radomirës.

- Nisja nga Grama kalon rrëzë malit të Gramës dhe vazhdon në pyjet e Sllatinës përgjatë Portave të Korabit dhe arrin në Bjeshkën e Shehut e cila është një nga bjeshkët më të bukura në Shqipëri. Nga Bjeshka e Shehut për nga pjesa e Gipsit të Korabit bëhet zbritja në fshatin turistik të Radomirës, rrëzë majës së Korabit ku do të jetë dhe akomodimi dhe darka tek bujtina Korabi dhe hotel Radomira.

Dita 7: Ngjitja në majën e malit të Korabit, mali më i lartë në Shqipëri

- Nisja në mëngjes nga fshati Radomirë në drejtimin e fushës së Korabit, ku mund të shijoni pamjen e mrekullueshme të kësaj bjeshke dhe pastaj vazhdon në gropën e panairit që është një nga monumentet e natyrës dhe ngjitja e majës së Korabit. Kthimi bëhet nga ana e Cerenit dhe shikohen shumë monumente natyre të malit të Korabit.
- Nisja nga Radomira për Tiranë bëhet nga rruga nacionale Peshkopi – Kukës, ose turi i ecjes në mal mund të vazhdojë dhe për 3 ditë të tjera për në Topojan të Kukësit dhe në malin e Sharit në Brezovicë të Kosovës.

2. SHTEGU ULZË-LURË



Dita 1: Shijoni bukuritë e parkut rajonal të Ulzës

- Nisja nga Tirana dhe arritja në Ulzë. Vizitë në qytezën e Ulzës, bukuritë e qytezës, kisha, Zyra Informacionit Turistik dhe ecje në kodrat përreth qytezës. Dreka dhe pushimi në lokalet në Ulzë.
- Ecje në shtigjet e parkut rajonal të Ulzës. Ecja mund të harmonizohet edhe me vozitje në liqenin e Ulzës dhe arritja në Laç-Bruç. Akomodimi dhe darka në Laç-Bruç.

Dita 2: Shijoni bukuritë natyrore të zonës së mbrojtur Zall Gjocaj

- Vizitë në bukuritë e Laç-Bruçit, burimet ujore të Shutresë, shpellat dhe bukuritë e tjera. Dreka me katering me vete.
- Vizitë në bukuritë e malit të Mbasdejës dhe fshatit të Macukullit, ku shijohet jeta në fshat, kullat dhe lëndinat. Darka dhe akomodimi në familjet e fshatit në Macukull.

Dita 3: Shijoni bukuritë e liqeneve akullnajore të Lurës

- Nisja nga Macukulli përmes fushës së Pelave dhe ku vizitohen me ecje bukuritë e liqenit të luleve dhe liqeneve të tjerë të parkut kombëtarë të Lurës. Akomodimi në darkë në Hotel Lura ose bujtinat në Lurë.

Dita 4: Shijo bukuritë e parkut kombëtarë të Lurës dhe kanionet e Setës.

- Nisja nga fshati turistik i Fushë Lurës, për në Arras. Vizitë në pllajën e Lanë-Lurës dhe bukurive të tjera të malit të Runjës dhe parkut të Lurës. Pastaj shikon bukuritë e Çidhnës dhe kanioneve të Setës, me ujëvara dhe kanione të thella. Akomodimi dhe darka te kulla e Vladimir Markut (Bujtina Arbëri).

3. SHTEGU I ARBËRIT



Dita 1: Shijo bukuritë e parkut kombëtarë të mali me Gropa - Bizë i Martaneshit

- Nisja nga Tirana deri në Malin me Gropa. Ecje dhe ngjitje në malin me Gropa dhe në pjesën e Murrizit të zonës së Xibrit. Shijimi i bukurive të malit të Xibrit dhe lëndinave të kësaj treve. Akomodimi dhe darka tek bujtina "Mulliri" i Avni Hysës në Xibër.

Dita 2: Shijo bukuritë e malit dhe liqeneve të Balgjajt

- Nisja me furgon nga Xibri dhe disa ndalesa për të shijuar vlerat e pasura të traditës dhe bukuritë e fshatrave të Klosit. Nga fshati Crrujë fillon ecja për në malin e Balgjajt dhe me ecje shikohet e gjithë panorama e mrekullueshme e luginës së Lumit Mat dhe bukuritë natyrore të malit të Balgjajt dhe bjeshkëve si dhe liqeneve akullnajore në këtë mal. Akomodimi dhe darka në stanet dhe kampingjet në Balgjaj.

Dita 3: Eksploro bukuritë e malit të Bulqizës.

- Nisja nga liqenet e Balgjajt për në malet e grykës së Bulqizës, ku shikohet diversiteti natyror i relievit dhe pasuritë e shumta të florës dhe faunës së zonës. Ecja vazhdon deri në fshatin Lepurak ku dhe bëhet akomodimi dhe darka te Kulla Hupi.

Dita 4: Eksploro bukuritë dhe legjendat e malit të Bardhë dhe Grykës së Vogël.

- Nisja nga Kulla Hupi dhe ngjitja në Malin e Bardhë kur eksplorohen bukuritë e shumta natyrore të këtij mali dhe mund të shikohen disa rrënoja fortifikimesh të kohës së Skënderbeut. Nga Mali i Bardhë panorama e gjithë luginës së Drinit të Zi është si në pëllëmbë të dorës. Pastaj zbritja nga mali i Bardhë bëhet në fshatin Bllacë, ku vizitohet dhe teqeja e Bllacës dhe bukuritë e shumta të Grykës së Vogël që nga fermat, stanet dhe ferma e peshkut në Kovashic. Akomodimi dhe darka në hotelet e Shupenzës ose të Maqëllarës.

Dita e 5: Shijo bukuritë e malit të Kërçinit, pjesë e parkut natyror Korab-Koritnik.

- Nisja nga fshati turistik i Kërçishtit të Epërm, ku mund të vizitohen kishat që janë monumente kulture në këtë fshat. Nga fshati bëhet ngjitja e malit të Kërçinit, ku janë një sërë monumentesh natyre në këtë mal dhe pasi arrin në majën e malit ndodhet rrënojat e kishës së Shën Ilias dhe panorama nga maja e malit është e mrekullueshme, ku shikohet e gjithë lugina e Drinit të Zi dhe Radikës. Kthimi nga fshati Pocest dhe akomodimi me darkën në hotelet dhe bujtinat në Maqellarë.

Dita 6: Shijo bukuritë e zonës së Maqellarës dhe Drinit të Zi

- Vizitë në kalanë e Grezhdanit dhe në luginën e Drinit të Zi në Gradec dhe përgjatë luginës së Drinit arrin në Topojan, ku dhe shijon drekën buzë Drinit tek Pajtim Beca, që është edhe parku i bletëve. Nisja për në Tiranë me makinë.

4. TURI I FERMAVE DHE AGRO-TURIZMIT

Dita 1: Shijo dhe provo prodhimet BIO dhe mikpritjen dhe kulinarinë e pasur të zonës së Matit

- Nisja nga Tirana në aksin e rrugës Rreshen – Burrel dhe ndalesa e parë në fermën e Peshkut në Laç-Bruç tek Alban Neziri. Shijimi i bukur i natyrë së këtij fshati dhe burimeve të ujit të Shutresë. Dreka tek ferma e Peshkut.
- Nisja nga Laç-Bruç për në Kurdari, ku vizitorët do të kenë mundësinë e njohjes së fermave në këtë fshat, me plantacionet e vreshtarisë, kantinën e verës dhe plot surpriza të tjera nga fshati. Darka dhe akomodimi tek Bujtina "Kërcova" në Kurdari.

Dita 2: Eksploro produktet cilësore dhe gatimet tradicionale të zonës së Klosit dhe Bulqizës.

- Vizitë në baxhot e Klosit dhe në punishtet e përpunimit të lëngjeve, si dhe në disa ferma me vreshta autoktone të zonës së Klosit. Dreka në Klos tek Vëllezërit Doka.
- Nisja për në Bulqizë dhe njohja me fermat në Fushë Bulqizë dhe baxhon dhe fermat e peshkut në Zerqan. Darka dhe akomodimi në Kullën Hupi.



Dita 3: Njihuni me produktet e larmishme të fermave bujqësore, natyrën, produktet tradicionale dhe gatimet tradicionale të Dibrës.

- Vizitë në agro fermat në Maqellarë si ke plantacionet e fermës Agolli në Kërçisht, baxho e vëllezërve Piku në Allajbegi dhe ferma dhe fidanishtja e Zija Keshi në Majtarë. Dreka tek restoranti dhe parku i bletëve Pajtim Beça.
- Nisja për në Peshkopi dhe ndalesa te ferma e vëllezërve Mehmeti në Trepçë, baxho "Korabi" në Melan dhe shijimi i parkut agro-bujqësorë në Llasen të Peshkopisë. Akomodimi dhe darka te Agro-Zerja, ku mund të shikohet punishtja e jufkave, dyqani i prodhime artizanale të frutave dhe bujtina e mrekullueshme.

Dita 4: Njihuni me mikpritjen dhe bujarinë e fshatit

- Vizitë në Luginën e Shërimit, te kompleksi balnear i Llixhave të Peshkopisë ku njihen me burimet e ngrohta termale dhe burimet e ujit të ftohtë, si dhe ambientet e qendrës së trajtimit balnearë të Peshkopisë. Gjithashtu, mund të vizitojnë edhe mullirin e ujit të ftohtë që bluan drithin e banorëve të zonës. Dreka te lokalet e zonës që shquhen për gatime dhe peizazhin natyror.
- Nisja për në fshatin turistik të Rabdishtit, ku mund të vizitojnë fshatin dhe fermat me patate, plantacionet e pemëve frutore, që nga mollët dhe deri te arrat, si dhe bujtinat në fshat. Darka dhe akomodimi te "Guest House Sabriu" dhe Bujtina "Goleci".

Dita 5: Shijoni produktet agro-turistike të zonës së Dibrës dhe mikpritjen baritore të Korabit

- Vizitë në punishten e lëngut të mollës Eliksir në Rashnapojë dhe vizitë në punishten e jufkave në Vakuf, vizitë dhe drekë tek ferma e Peshkut në Arras.
- Nisja nga Arrasi dhe ndalesë e parë tek punishtja e frutave të thata dhe rakisë së kumbullës "Kaza" në fshatin Rrenx. Vizitë dhe ndalesë në baxhot në Radomirë. Darka dhe akomodimi tek Bujtina Korabi ose Hotel Radomira në këtë fshat.

Dita 6: Një eksperiencë që duhet me e provuar

- Kthimi për në Tiranë nga rruga nacionale e Kukësit, ose nga aksi i rrugës së Arbërit.

5. TURI HISTORIK "NË GJURMËT E SKËNDERBEUT"

Dita 1: Të njihemi me historinë e pasur të zonës së Matit

- Nisja nga Tirana në rrugën e Arbërit, pushim dhe mëngjes tek Bujtina Mulliri në Gurë të



Bardhë,
- Vizitë në rrënojat e kalasë së Petralbës dhe muzeu i Pjetër Budit në Klos, dreka në Gurë të Bardhë ose te Vëllezërit Doka në Klos.
- Vizitë në muzeun e qytetit të Burrelit dhe kafe tek lulishtja e mbretëreshës Geraldinë në Burrel;
- Vizitë në sarajet e Mbretit Zog dhe fjetja dhe darka tek Bujtina Kërcova në Kutari.

Dita 2: Njohja me betejat e Skënderbeut në Fushë Bulqizë
- Nisja nga Bujtina "Kërcova" dhe ndalesa e parë në Bulqizë tek monument ii Skënderbeut, njohja me betejat e Skënderbeut, legjendat dhe dreka në Fushë-Bulqizë tek pishat.
- Njohja me rrënojat dhe legjendat në malin e Bardhë, darka dhe qëndrimi tek Kulla Hupi.

Dita 3: Trashëgimia historike dhe kulturore e qytetit të Peshkopisë
- Nisja nga Kulla Hupi, për në Peshkopi.
- Ndalesa e parë në fshatin turistik Kërçisht ku njihen me Kishat dhe monumentet e kulturës. Pushim kafeje në Maqellarë dhe një ndalim tek kalaja e Grezhdanit, e fisit Ilir të Penestëve.
- Dreka tek bujtina e Jufkave Zerja.
- Turi i qytetit të Peshkopisë, ku vizitohet lagja e vjetër, muzeu i historisë dhe pavionet e etnografisë, pallati i kulturës, monumenti i të përdjekurve politikë, monumenti i Skënderbeut, zyra e informacionit turistik dhe atraksione të tjera turistike në Peshkopi.
- Darka dhe akomodimi në bujtinat dhe hotelet e qytetit të Peshkopisë.

Dita 4: Vendet, toponimitë dhe muzeu i familjes së Kastriotëve në zonën e Kastriotit



- Nisja nga Peshkopia te fshati Kastriot: vizitë në vendet toponimike të familjes së Kastriotëve në këtë fshat. Vizitë në monumentin e betejës së Torviollit në fushë Kastriot.
- Vizitë në Kepin e Qytetit dhe drekë tek Kulla e Vladimir Markut, "Bujtina Arbërit".
- Vizitë tek muzeu i familjes së Kastriotëve në fshatin Sinë. Akomodim dhe darkë tek kulla e Arbërit në Arras, ose kthimi në Peshkopi ku është edhe darka e akomodimi.

Dita 5: Lugina e Shërimit me pasuritë e saja historike dhe natyrore
- Vizitë në Luginën e Shërimit, te burimet termale të Llixhave dhe rrënojat e gradishtës së Qytezës në Bellovë.
- Dreka dhe vizitë në fshatin e gurtë të Rabdishtit.
- Nisja dhe kthimi në Tiranë.

6. TURI KULTURORË I KULLAVE TË ARBËRIT.



Dita 1: Eksploro Kullat e Matit, si dëshmi e vlerave kulturore dhe tradicionale të kësaj treve.
- Nisja nga Tirana rruga kryesore nga Miloti, ku shijon bukuritë e natyrës së mrekullueshme të luginës së Shkopetit. Ndalesa e parë në qytezën e Ulzës ku njihesh me bukuritë e kësaj qyteze, traditën, kishën dhe zyrën e informacionit turistik dhe shijon me kafe pamjen e mrekullueshme të liqenit të Ulzës.
- Vizitë në kullat tradicionale të Bushkashit (fshat turistik) në anë të liqenit dhe ku njihesh me historinë dhe vlerat arkitekturore te këtyre kullave. Në Bushkash shijon dhe drekën me peshkun e liqenit të Ulzës.
- Ndalesë në qytetin e Burrelit ku njihesh me muzeun historik në Burrel, me arkitekturën e qytetit të Burrelit, ndërtesa e Bashkisë dhe një kafe tek lulishte e mbretëreshës Geraldinë.
- Drekë në bujtinën "Kërcova" në Kutari dhe vizitë në kullat e këtij fshati.
- Vizitë ne kullat e fshatit Gurë dhe darka dhe akomodimi tek Kulla "Gjini" ose kulla "Muharremit".

Dita 2: Kullat e Klosit një pasuri dhe larmishmëri e arkitekturës tradicionale Arbërore
- Nisja nga fshati Gurrë, për në Xibër, ku njihen me stilin e veçantë të kullave në këtë zonë. Vizitë në disa kulla, rrënojat e kalasë së Petralbës dhe në muzeun e Pjetër Budit. Dreka tek Bujtina "Mulliri" i Avni Hysës në Xibër.
- Nisja nga fshati Xibër dhe ndalesë e parë në kullat e fshatit fshat në Klos dhe arritja në Fushë Bulqizë. Vizitë në teqenë e Begtashive në Fushë Bulqizë, vizitë në disa kulla të zonës dhe ndalesë për akomodim dhe darkë tek Kulla Hupi, një kullë 200 vjeçare.

Dita 3: Kullat e Bulqizës dhe Dibrës dhe monumentet kishtare si dëshmi e stilit bizantin
- Nisja nga Kulla Hupi, vizitë në fshatin turistik të Zerqanit dhe kullat e këtij fshati dhe shijim i një kafeje në këtë fshat.
- Nisja nga fshati Zerqan dhe vizitë në xhaminë e Allbegisë, kishat e Kërçishtit dhe kalanë e Grezhdanit. Dreka tek Agro-Zerja në Peshkopi.
- Vizitë në fshatin e gurtë në Rabdisht, një nga 100-fshatrat turistikë të vendit. Ecje në rrugët me kalldrëm dhe shpitë e gurit. Akomodimi dhe darka në Bujtinën sabriu dhe Goleci.

Dita e 4: Tradita e pasur zakonore e Kullave të Dibrës së poshtme
- Nisja nga Rabdishti dhe vizitë në Kulla e Zunës në fshatin Sohodoll dhe kullat e Kaloshit në fshatin Kandër në Kastriot. Dreka në kullat e Vladimir Markut, "Bujtina Arbëri", në Arras.
- Nisja nga Arrasi, ndalesë në fshatin Çidhën për t'u njohur me kullat e këtij fshati dhe ngjitja për në Fushë Lurë. Vizitë e Kullave të Lurës, si Kulla e Tolles, Kulla e Doçit, Kulla e Koçekut dhe kullat e tjera. Akomodimi dhe darka ke hotel Lura ose bujtinat e zonës.

Dita 5: Kullat e Mirditës pjesë e pasur e arkitekturës sonë.
- Nisja nga Lura dhe shijimi i zonës së Mirditës, me kullat karakteristike. Një ndalesë te kantina e verës së Arbërit, ku në afërsi të saj mund të shijohet dhe dreka dhe arritja në Tiranë.

7. TURI I BIÇIKLETAVE MALORE

Dita 1: Shijo me biçikletë parkun kombëtarë të Qafë Shtamës
- Nisja nga Tirana për në Krujë dhe kalon nëpër rrugën e parkut të Qafë Shtamës ku konsumohet dhe dreka.
- Arritja në Mat dhe ndalesa për darkë në Gurrë tek Kulla Gjini, ose në Burrel ke Vila Bruçi, ose në Kurdari tek Bujtina "Kërcova".

Dita 2: Shijo bukuritë e maleve të Dibrës në Selishtë dhe Luzni
- Nisja nga Mati përgjatë rrugës së Qafë Murrës dhe ndalesa në Selishtë për drekë. Ecja përgjatë grykës së Murrës dhe arritja në Peshkopi. Akomodimi dhe darka në hotelet ose bujtinat e Peshkopisë.

Dita 3: Shijo bukuritë e malit të Korabit
- Nisja nga Peshkopia për në Radomirë ku vizitorët do shijojnë bukuritë e Korabit. Ndalesa për drekë dhe akomodimi do të jenë në lokalet dhe bujtinat e Radomirës. Shtegu kalon në parkun natyror Korab – Korritnik.

Dita 4: Shijo dhe provo bukuritë e natyrës së Rabdishtit mikpritjen tradicionale të këtij fshati turistik
- Shtegu i biçikletave malore Hinoskë – Rabdisht. Dreka dhe ndalesa e parë në Hinoskë ke stanet e Fidallarëve dhe ngjitja e malit të Valivarit dhe kthimi në fshatin Rabdisht ku do të jetë dhe akomodimi dhe darka.

Dita 5: Shijo bukuritë dhe mikpritjen e maleve të Bulqizës
- Nisja nga Rruga nacionale Peshkopi – Tiranë në Shupenxë për në fshatin Zogje dhe ngjitja për në fshatin Bllacë dhe kalimi i malit të Bardhë për në fshatin Lepurak dhe darka dhe akomodimi në Kullën Hupi.

Dita 6: Shijo bukuritë e rrugës së Arbërit
- Nisja për nga Rruga e Arbërit për në malin me Gropa, ndalesë në Xibër për drekë tek Bujtina "Mulliri" i Avni Hysës dhe arritja në Tiranë.

8. TURI I LIQENEVE AKULLNAJORE ME MOTORA DHE MAKINA 4X4



Dita 1: Eksploro traditën vendase dhe adrenalinën e udhëtimit në 27 liqene akullnajore
- Arritja në Arras nga rruga nacionale e Kukësit ose drejtim tjetër. Darka dhe akomodimi në Arras ose në Peshkopi.

Dita 2: Eksploro bukuritë e fshatit turistik të Fushë Lurës dhe terrenit malorë përreth saj
- Nisja për në Lurë nga pjesa e Grykë Nokës dhe vizitë në pllajën e Lan Lurës dhe në pjesën e Fushë Lurës, Krej Lurë, Borie Lurë dhe darka e akomodimi në Fushë Lurë tek hotel Lura ose bujtinat.

Dita 3: Ekploro bukuritë dhe adrenalinën e liqeneve akullnajorë të Lurës, Kacnisë dhe Balgjajt.
- Nisja nga Fushë Lura përgjatë parkut të Lurës dhe vizitë tek 7 liqenet e Lurës dhe nga Fusha e Pelave kalon në Kacni dhe shikon liqenet akullnajore të Kacnisë dhe Balgjajt. Akomodimi dhe fjetje nga stanet e Balgjajt ose lokalet e minatorëve në Kacni.

Dita 4: Ekploro bukuritë e liqeneve akullnajore të Bulqizës dhe adrenalinën e rrugëve të minierave
- Lëvizja nga liqenet e Balgjait për në Bulqizë përgjatë rrugëve të shfrytëzimit të minierave dhe pyjeve dhe vizitë në liqenet akullnajore të Dhoksit, Sopajve, Liqeni Zi, Liqeni Sopotit, e tj. Darka dhe akomodimi në Bulqizë tek hotelet e qytetit dhe tek Kulla Hupi.

Dita 5: Ekploro bukuritë e parkut kombëtarë Mali me Gropa – Bizë i Martaneshit.
- Nisja nga Bulqiza, zbritja në Klos dhe përgjatë rrugës së vjetër të Arbërit vizitohen bukuritë e parkut të Bizë e Martaneshit – Mali me Gropa. Dreka në Xibër tek Bujtina "Mulliri" i Avni Hysaj dhe kthimi në Tiranë.

9. TURI I SHPELLAVE



Dita 1: Eksploro bukuritë shpellave të Laç-Bruçit
- Nisja nga Tirana përgjatë aksit rrugor që kalon në Rrëshen dhe ndalimi në fshatin Laç-Bruç. Vizitë në 3 shpellat e famshme të këtij fshati, siç janë shpella e Valit, shpella e Nezirit dhe shpella e Kputës. Një ditë e harxhuar për vizitën e këtyre shpellave. Dreka, darka dhe akomodimi në Lac Bruç ose qëndrimi në Suç për akomodim tek Bujtina Kërcova.

Dita 2: Eksploro të fshehtat e shpellave dhe historitë e tuneleve në zonën e Suçit
- Vizitë në shpellën e Allamanit në Suc dhe disa tunele në zonën e Suçit. Dreka dhe pushimi në Bujtinën Kërcova.
- Vizitë ne shpellat e Xibrit dhe akomodimi dhe qëndrimi tek Bujtina "Mulliri" në fshatin Xibër.

Dita 3: Eksploro misterin dhe përvojën e galerive në minierat e Bulqizës
- Vizitë dhe njohje me galeritë dhe minierat e Bulqizës. Vizitë në fshatin Lepurak dhe njohje me shpellën e Hoxhës në këtë fshat. Dreka tek Kulla Hupi.
- Vizitë në shpellën e Gjurasit në Shupenzë dhe qëndrim dhe akomodimi në hotelet e zonës së Shupenzës.

Dita 4: Eksploro shpellat misterioze të kanionit të Setës
- Vizitë dhe qëndrim tek shpellat e kanionit të Setës. Janë rreth 17 shpella në këtë zonë dhe më të njohurat mund të eksplorohen përgjatë një ditë. Darka dhe akomodimi tek Kulla e Vladimir Markut, bujtina "Arbëri".

10. TURI I RAFTING NË LUMIN MAT DHE DRINI I ZI



Dita 1: Shijo me kanoe bukuritë e Shkopetit dhe të Ulzës
- Nisja nga Tirana dhe ndalesa e parë në Shkopet dhe Ulzë ku mund të shijohet me kanoe bukuritë e Shkopetit dhe të liqenit të Ulzës, që janë bukuri të rralla dhe pjesë e parkut rajonal të Ulzës. Dreka dhe akomodimi në Ulzë.

Dita 2: Shijo me rafting bukuritë dhe adrenalinën e Drinit të Zi.
- Nisja nga ura e Topojanit dhe përshkon gjithë luginën e Drinit të Zi me pamje të bukura në Topojan dhe me adrenalinë në kanionet e Gradecit. Pushimi i drekës tek kamping i fluturave në Hotesh tek Labinot Murrja. Në këtë tur shijohet me ecje dhe kanioni i fluturave ne grykës e Gurrës së Mazhicës dhe udhëtimi me rafting vazhdon në Selane dhe në Katund të Ri në Luzni ku mund të konsumohet ushqim ose kafe tek restorant Damzi. Pastaj me makina bëhet kthimi në Peshkopi përgjatë fermave dhe bukurive të fshatit Dohoshisht.

Përgatiti: Besnik Alku (ALCDF)

Udhëtim me BIÇIKLETË maleve të Dibrës



Në foto: Pamje nga një udhëtim me biçikleta gjatë shtegut Golema Planinë - Zhirovnicë në kuadër të projektit Cross-Border Biking, zbatuar nga ALCDF - Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokala, financuar nga Bashkimi Europian. Fotot poshtë ilustrojnë shtigjet me biçikleta sipas titullit. © Andi Qyqja

Andi Qyqja është një çiklist që promovon udhëtimet me biçikleta maleve të Shqipërisë.

Muajt e fundit, në kuadrin e projektit Cross-Border Biking, ai ka udhëtuar në Dibër, dy anët e kufirit me Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke zbuluar disa shtigje të reja të udhëtimeve me biçikleta malore.

"Cross-Border Biking" është një projekt ndërkufitar, që ka pasur evidentimin e shtigjeve turistike me qëllim rritjen e turizmit të aventurës në rajon.

Andi Qyqja ka udhëtuar dy muajt e fundit në këtë rajon dhe shënimet e tij për këto shtigje aventure me biçikleta I ka hedhur në faqen e tij në rrjetet sociale, ndërsa videot e udhëtimit në këto shtigje gjenden në Youtube.

Ne po përcjellim për lexuesit shënimet e tij. Për të provuar udhëtimin në këto shtigje, mos hezitoni të kontaktoni një nga guide lokale në terren.

Nga **ANDI QYQJA**

30 maj: Kanë kaluar 7 vite nga hera e fundit që kam qenë në Peshkopi. Atëherë bëhej promovimi i një aktiviteti në natyrë komplet i ri për këtë zonë, rafting në Drin të zi!

Ashtu si 7 vite më parë, jam përsëri në Peshkopi për promovimin e një aktiviteti tjetër në natyrë, Mountain Biking në bjeshkët e Dibrës.

Për mua është hera e parë që bëj mountain biking në këtë zonë dhe është kënaqësi të bëj 3 nga shtigjet kryesore të ndërtuara nga ALCDF.

Cross-Border Biking është një projekt i financuar nga EU dhe ka si qëllim promovimin e zonave të Mavrovës - Rostushës dhe Dibrës, gjithashtu ka të bëj me përmirësimin e infrastrukturës për zhvillimin e turizmit të aventurës.

Le të fillojmë eksplorimin e shtigjeve!

1. SHTEGU HINOSKË-RABDISHT



1 qershor: Hinoskë-Rabdisht është një nga shtigjet kryesore të projektit Cross-Border Biking.

Padyshim, një shteg me një panoramë fantastike me një gjatësi prej 6.2 km, ku përveç adrenalinës së shtegut, mund të shijoni dhe natyrën e egër të kësaj bjeshke.

Një shteg me një nivel vështirësie mesatare, i cili mund të bëhet nga të gjithë personat që kanë një aktivitet të rregullt në Mountain Biking.

Fillimi i shtegut duket paksa i frikshëm, por është thjesht një iluzion optik, sepse sapo fillojnë metrat e para të zbritjes, bëhet shumë i sigurt dhe me hapësirë të mjaftueshme për ta shijuar këtë pjesë të shtegut që është dhe më e bukura.

Segmenti i dytë kalon në pyll dhe bëhet me i egër, më teknik dhe më impenjativ.

E gjithë linja e shtegut ka sinjalistikë dhe tabela alpine. Shtegu përfundon në fshatin Rabdisht, shumë afër Guest House Sabriu.

Për arsye se shtegu ndodhet në lartësinë 1960 metra, gjatë pranverës ka akoma borë në disa segmente të vogla që janë të bllokuara. Do t'jua sugjeroja ta bënit prej muajit qershor deri në fund të vjeshtës. (Ndiq videot këtu: **https://www.youtube.com/watch?v=-unrSpSvsyc)**

2. SHTEGU HINOSKË-ILNICE-MELAN



3 qershor: Shtegu Hinoskë-Ilnicë-Melan ka një gjatësi prej 6 km dhe fillon në lartësinë 2028 metra.

Shtegu ndahet në dy segmente: Hinoskë -Ilnice 3.7 km dhe Ilnicë-Melan 2.3 km.

Janë dy segmente totalisht të ndryshme si në terren ashtu dhe në nivel vështirësie.

Padyshim segmenti Hinoskë-Ilnicë eshte pjesa me impenjative e ketij itinerari.

Është shumë i shpejtë dhe me një terren shumë të favorshëm për zbritje, ka një shkallë vështirësie mesatare, mund të bëhet nga të gjithë ato që kanë një aktivitet të rregullt në mountain biking.

Ndërsa për të gjithë ato që janë në nivele të avancuara thjesht nuk do t'ju mjaftojë vetëm 1 zbritje nga ky segment.

Pjesa e fundit, Ilnicë-Melan, është më e lehtë dhe me pak impenjative sesa i pari, pasi ka një terren më të butë dhe më pak të pjerrët, ka sinjalistikë në çdo hyrje të shtegut.

Mund të bëhet nga të gjithë ato që kanë një aktivitet normal në mountain biking. (Ndiq videot këtu: **https://www.youtube.com/watch?v=dadw3nXMxeg)**

3. SHTEGU PEJKË-HOTESH

6 qershor: Pejkë-Hotesh është dhe shtegu i tretë që zbrita gjatë javës time në Peshkopi ku bëra 3 nga shtigjet kryesore të projektit Cross-Border Biking.

Një shteg i shkurtër, që po të mos të ishte për pjerrësinë dhe terrenin që ka, do ta quaja një shteg të nivelit fillestar, por jo! Është një shteg me vështirësi mbi mesataren dhe kërkon kujdes në disa segmente. Është i pjerrët dhe ka kthesa të ngushta përgjatë



gjithë linjës së tij.

Shtegu përfundon tek Butterfly Camping, një oaz i vogël i fshehur buzë Drinit të Zi.

Për të arritur tek Butterfly Camping ka dy mënyra: nëse jeni të nivelit të avancuar në mountain biking do jua sugjeroja Pejkë - Butterfly Camping, por nëse jeni poshtë nivelit mesatar do ju sugjeroja Hotesh - Butterfly Camping. (Ndiq videot këtu: **https://www.youtube.com/watch?v=j8rc5086YX4**)

***

Pas 3 shtigjeve kryesore të projektit të Biking Cross-Border nga pala shqiptare, tani është koha për 2 shtigje të tjera kryesore, por këtë herë nga ana e Maqedonisë së Veriut. Ashtu si në Peshkopi, edhe në Maqedoninë e Veriut, është hera e parë që bëj biçikletë malore në këto zona, kështu që jam shumë entuziast për këtë aventurë të re, por edhe për të provuar këto shtigje që ndodhen në fshatrat Zhirovnicë dhe Vrbjana.

4. SHTEGU VRBJANI - ZHIROVNICË

10 qershor: Shtegu fillon nga maja e malit dhe zbret në fshatin Vrbjani me një gjatësi prej 4.7 km. Segmenti i dytë fillon nga fshati Vrbjani dhe përfundon në Zhirovnicë me një gjatësi prej 5.3 km. Një itinerar me një gjatësi totale prej 10 km.

Pjesa e parë e shtegut nga maja e malit deri në Vrbjanë ka një terren shumë të mirë dhe niveli i shtegut është mesatar.

Pjesa e dytë e shtegut Vrbjani - Zhirovnicë ka një terren të vështirë, sepse kalon nëpër një pyll të dendur midis dy fshatrave dhe niveli i vështirësisë është mbi mesatare. Gjatë



rrugës ka shumë shkembinj dhe grumbuj gurësh, që e rrisin vështirësinë e pedalimit. (Ndiq videot këtu: **https://www.youtube.com/watch?v=J9IVYkfZYoU**)

4. SHTEGU GOLEMA PLANINË - ZHIROVNICË



13 qershor: Mbi fshatin Zhirovnicë është shtegu Golema Planina-Mala Planina-Zhirovnica që ka një gjatësi prej 10 km.

Kjo shteg në një pikë bashkohet me shtegun Hinoskë - Rabdisht por edhe me shtegun që të çon në Hinoskë - Ilnicë - Melan. Edhe pse jemi në fund të pranverës ka shumë borë që ka bllokuar një pjesë të madhe të shtegut. Ky shteg ka një terren shumë të mirë, por është një shteg i shpejtë, kërkon shumë teknika. Shtegu ka një vështirësi mbi mesatare, për faktin se ka shumë të përpjetë, por edhe shumë segmente të pjerrëta. (Ndiq videot këtu: **https://www.youtube.com/watch?v=3gebm2ED-Fs**)

Për më shumë info mbi çiklizmin malor ndiq:
Linktree: **andiqyqja**
Twitter: **AndiQyqja**
Instagram: **andi_qyqja**
Facebook: **AndiQyqjaAthlete**

opinion

Ky proces i reagimit popullor kërkon bashkim dhe jo përjashtim e përplasje në rrjetet sociale për interesa personale, si edhe kemi lexuar për fatin e keq.

Dibra sot ka nevojë për të gjithë

Nga **SHEMSI PRENÇI**

Osot o kurrë duhet të ngrihemi të bashkuar, për ta mbrojtur Dibrën nga qëllimet ogurzeza të qeveritarëve të korruptuar.

Dibra sot ka nevojë për të gjithë. Ka nevojë për ata që nuk u larguan kurrë nga Dibra. Ka nevojë për të gjithë ata që për arsye të ndryshme janë larguar e banojnë gjithkund në Shqipëri e nëpër botë.

Dibrën dhe dibranët fatkeqësisht e kanë braktisur politikanët, deputetët dhe ish-deputetët, pasi asnjëri prej tyre, majtas e djathtas, ende nuk kanë reaguar për Hec Skavica.

Një gjë të tillë nuk e bëjnë sepse nuk duan të prishen me shefat e partive, të cilët sapo vijnë në pushtet, dalldisen pas korrupsionit dhe nuk pyesin për dibranët, për Dibrën, për historinë dhe vlerat e sajë.

Hidrocentrali i Skavicës nuk shkatërron vetëm Dibrën.

Për shkak të detyrave që kam kryer në plot 32 vite, do të mundohem të arsyetoj disa nga faktet për të cilat HEC Skavica nuk duhet ndërtuar dhe Dibra, Kukësi e Prizreni duhen mbrojtur me çdo kusht e me çdo çmim!

Para se të mundohem të sjell argumente, dua t'ju kërkoj ndjesë specialistëve të fushave të ndryshme dhe jam i hapur të mirëpres vërejtje dhe korrigjime profesionale prej tyre.

Së pari, HEC Skavica, nëse realizohet, shuan një pjesë të mirë të trojeve dhe historinë e lavdishme të Dibrës dhe dibranëve që luftuan në shekuj për lirinë e kësaj treve të lakmuar nga turqit e serbët.

Së dyti, Argumenti i qeverisë se ndërtimi i Hidrocentralit të Skavicës përmirëson situatën energjetike të Shqipërisë duket shumë primitiv, pasi nuk mundesh të sakrifikosh një trevë me histori të lavdishme, një trevë me bukuri dhe resurse turistike, një trevë me pasuri minerale, vetëm për interesa pragmatiste të qeveritarëve të korruptuar me pretekstin se "do të përmirësojnë situatën energjetike në Shqipëri".

Ndërkohë që sot, burimet hidro nuk kanë prioritet në raport me burimet energjetike të erës dhe rrezeve diellore, ose TEC-eve me djegie, të cilat mbizotërojnë për faktin se nuk përmbytin ose zhdukin pasuri natyrore, zona turistike dhe njëherazi burime nëntokësore minerale etj.

Së treti, Argumentet e qeverisë se ndërtimi i HEC Skavica mënjanon ose parandalon përmbytjet në zonën e nën Shkodrës, është i gënjeshtër, pasi liqenet e HEC-ve në kaskadën e Drinit, kur ka shira me intensitet mbi 100mm shi në 24 orë dhe për një periudhë 4-5 ditë pa ndërprerje, tejmbushen nga lumenjt Drini i Bardhë, Valbona, lumi i Nikaj-Merturit, lumi i Shalës si dhe shumë lumenj e përrenj të territoreve Tropojë, Has, Pukë e Shkodër, duke detyruar autoritetet shtetëror (KESH) të shkarkojë nëpërmjet portave të shkarkimit përtej kapaciteteve të agregateve të prodhimit të energjisë deri në 2800-3200 m3/sekondë dhe duke shkaktuar kështu përmbytje në zonën e nën Shkodrës.

Po kështu, në përmbytjen e nën Shkodrës ndikojnë dhe tejmbushja e liqenit të Shkodrës nga lumi Moraça që mbledh ujrat e 3/4 të territorit të Malit të Zi dhe derdhet në pjesën veriore të liqenit të Shkodrës. Po kështu edhe ujërat e lumit Kir që derdhet në pjesën fundore të lumit Drin, para se të bashkohet me lumin Buna.

Pra, baseni i ujërave Drini e Buna është padyshim baseni më i madh në Ballkan e më gjerë.



Ekspertë europianë e botërorë kanë ofruar për qeverinë shqiptare të tjera variante më ekonomike dhe më të sigurta për parandalimin e përmbytjeve në zonën e nën Shkodrës, duke e ndarë rrjedhjen e Drinit në dy degëzime në zonën e Vaut të Dejes drejt detit Adriatik, ashtu siç ka qenë para 100 viteve.

Ekspertë europianë e botërorë kanë ofruar për qeverinë shqiptare të tjera variante më ekonomike dhe më të sigurta për parandalimin e përmbytjeve në zonën e nën Shkodrës, duke e ndarë rrjedhjen e Drinit në dy degëzime në zonën e Vaut të Dejes drejt detit Adriatik, ashtu siç ka qenë para 100 viteve.

Së katërti: Ndërtimi i HEC Skavica përbën rrezik, sepse ndërtohet në terrene shkëmbore jo shumë të qëndrueshme, duke marrë parasysh se niveli i digës së parashikuar në kuotën 443 m garanton një kapacitet ujëmbledhës nga 2.6 deri në 3.2 miliard m3 ujë, çka mbetet një rrezik i vazhdueshëm në periudhën e amortizimit dhe degradimit vit pas viti, ashtu si dhe ka ndodhur me disa hidrocentrale në shumë vende të Europës dhe botës, duke shkaktuar katastrofa me qindra mijëra jetë njerëzore (kujtojmë këtu rastin e vitit 2016 në Bosnje-Hercegovinë).

Kjo do të ishte shumë e rrezikshme jo vetëm për Dibrën, por më së shumti do ishte një "vdekje" mbi krye për popullin e qytetit të Kukësi dhe fshatrave përreth, si dhe për popullin e Prizrenit dhe Zhurit.

Prandaj dhe në të ardhmen mendoj se duhet sensibilizuar edhe kjo pjesë e popullsisë për tu bashkuar në reagimin kundër HEC Skavica.

Argumentet e qeverisë se ndërtimi i HEC Skavica mënjanon ose parandalon përmbytjet në zonën e nën Shkodrës, është i gënjeshtër, pasi liqenet e HEC-ve në kaskadën e Drinit, kur ka shira me intensitet mbi 100mm shi në 24 orë dhe për një periudhë 4-5 ditë pa ndërprerje, detyrojnë autoritetet shtetëror (KESH) të shkarkojë nëpërmjet portave të shkarkimit përtej kapaciteteve të agregateve të prodhimit të energjisë deri në 2800-3200 m3/sekondë dhe duke shkaktuar kështu përmbytje në zonën e nën Shkodrës. Po kështu, në përmbytjen e nën Shkodrës ndikojnë dhe tejmbushja e liqenit të Shkodrës nga lumi Moraça që mbledh ujrat e 3/4 të territorit të Malit të Zi dhe derdhet në pjesën veriore të liqenit të Shkodrës. Po kështu edhe ujërat e lumit Kir që derdhet në pjesën fundore të lumit Drin, para se të bashkohet me lumin Buna.

Së pesti: Ndërtimi i HEC Skavica dhe liqeni ujëmbledhës me një kapacitet nga 2.6 deri 3.2 miliard m3 ujë shtrihet në një zonë me ndjeshmëri të lartë sizmike që shtrihet mbi nënpllakën tektonik që shtrihet në aksin Prizren-Kukës-Dibër-Librazhd-Korçë. Mund të sjellim në vëmendje termetin e vitit 1967 dhe 2009 dhe në kushtet e mbingarkesës me miliarda m3 ujë pasojat do të ishin katastrofike për Kukësin dhe Prizrenin.

Së gjashti: Forma më efikase për të kundërshtuar ndërtimin e HEC Skavica, do të ishte bashkimi Dibra, Dibra e Madhe, Kukësi dhe Prizreni për protesta të fuqishme, por dhe mbledhja e mbi 50 000 firmave si dhe kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese, si e vetmja rrugë juridike dhe kushtetuese.

Së shtati: Mendoj se duhen ngritur struktura dhe organizma juridike dhe popullore për reagim paralel edhe në pikëpamje ligjore edhe me protesta të fuqishme.

Ky proces i reagimit popullor kërkon bashkim dhe jo përjashtim e përplasje në rrjetet sociale për interesa personale, si edhe kemi lexuar për fatin e keq.

Për të gjitha këto arsye dhe shumë të tjera që sjellin në vëmendje të opinionit publik: Unë jam gati të jap gjithçka për mbrojtjen e trojeve dhe varreve të të parëve tanë, por në mënyrë të veçantë për të mbrojtur Dibrën dhe varret e atyre që mbrojtën me gjak Dibrën në luftërat shekullore kundër turqve e serbëve.

Bashkohu dhe ti!

Bashkohuni dibranë kudo që jeni!

Bashkohuni dhe ju, kuksianet e historisë së lavdishme të popullit shqiptarë, që e vuani grabitjen e pronave nga ndërtimi i HEC Fierzë, e ku dhe pas 60 vitesh ende nuk keni marrë kompensimet e pronave nga qeveritë mashtruese, por dergjeni prapa zyrave të burokracisë shtetërore.

Bashkohuni dhe ju, shqiptarë të trojeve të Prizrenit dhe Zhurit, që të mos e keni "vdekjen" mbi kokë nesër.

Bashkimi zhbën çdo vendim të qeverive korruptive dhe zmbraps çdo okupator e grabitës pronash.

Po Dibrës! Po Kukësit! Po Prizreni! Jo Skavicës

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaearberit@gmail.com>

cyan magenta yelloë black

Në shpirt e ka vendlindjen e tij, ndaj e ka ngjitur fort tek mbiemri i tij, si pjesë e pandashme e identitetit.

profil

Imam Rushiti i Radomirës

Nga **OSMAN XHILI**



Atij i pëlqen ta thërrasin Rushit Radomira dhe pse mbiemri i tij i vërtetë është Ferati. Jo se nuk është fis me emër, përkundrazi. Stërgjyshi i tij, Emin Ferati, ka qenë një nga ato burra që i dolën zot vatanit. As gjakun dhe jetën nuk e kurseu për këtë kauzë të madhe. U vra nga serbët në Ceren të Kalasë së Dodës dhe emri i tij është i përmendur krahas dhjetra dëshmorëve të tjerë. Dy djemtë e tij, mulla Vehbiu dhe mulla Tahiri, ecën në mësimet dhe gjurmët e tij. U edukuan me punë, patriotizëm, por dhe me besimin e palëkundur te i madhi Zot, pasi kështu bëhet më e plotë figura njerëzore. U bënë teologë të shquar dhe imamë të nderuar. Pas viteve shtatëdhjetë, kur feja u ndal me ligj dhe besimi në Zot ishte një herezi për sistemin komunist, në shtëpinë e mulla Tahirit erdhën përfaqësues të pushtetit. I thanë se nuk mund të ushtronte më aktivitetin fetar dhe duhej të hiqte mjekrën. Mulla Tahiri u përgjigjet, se për pikën e parë nuk mund të shtyhej me qeverinë, kurse kërkesën e dytë nuk j'ua plotësonte dot. "Mjekra ime or miq, hiqet vetëm atëherë, kur të hiqet koka ku gjendet ajo".

SHKOLLIMI

Në një familje të tillë atdhetare, punëtore dhe të shkolluar, lindi dhe u rrit një tjetër filiz, po kaq i denjë, sa të parët e tij, Rushit Radomira Ferati. Ai e mbaroi shkollën tetëvjeçare me rezultate të shkëlqyera dhe i thanë të vazhdonte shkollën e mesme në Peshkopi për teknik ndërtimi. Ndoshta dega që nuk i pëlqeu dhe aq, por dhe kushtet ekonomike të disfavorshme, bënë që djali i ri të linte shkollën për disa vite. Mbase geni i të parëve që kishin studiuar për teologji e thërriste dhe Rushitin për ta përtërirë traditën e parë.



Kishte ardhur viti nëntëdhjetë, viti i kthesës së madhe, me kufij të hapur dhe për shqiptarët.Me ndihmën e një kushëriri të tij nga Tetova, Rushiti paraqitet në Medresenë e "Isa beut", në Shkup. Pas shumë peripecish dhe situatash të vështira, hezitimit të drejtorit, Bahri Aliut, ëndrra e djalit tëri u realizua. Tashmë dhe ai ishte një nga shtatëqind studentët e kësaj shkolle me aq emër në rajon.

Kaluan dy vitet e para dhe kishin hyrë në të tretin. Në zgjedhjet studentore, që bëheshin çdo vit, djali nga Radomira zgjidhet kryetar i Unionit për gjithë studentët e kësaj shkolle. Në një fjalë të shkurtër përshëndetëse, drejtor Bahriu thotë, se në fillim nuk kam dashur ta regjistroj në shkollë Rushitin. Kisha frikë se na bën probleme me studentët e tjerë dhe se nuk do të arrijë t'i kapë mësimet, pasi i kishte ndërprerë ato për disa vite. Sot, vazhdoi ai, ju e shihni, ku ka arritur ky njeri, falë vullnetit e këmbënguljes së tij të admirueshme.

Rushiti mbaroi studimet në vitin 1996 dhe shkoi në vendlindje, në Kala të Dodës. Vetëm një vit më pas e emëruan imam në Radomirë, në atë tempull, ku kishin ligjëruar dhjetëra dijetarë të fesë para tij. Ishte një peshë e rëndë, një amanet i madh, por imami i ri besonte se do t'ia dilte mbanë me sukses. Ishte shumë i lidhur me njerëzit, me hallet e problemet e tyre, duke u përpjekur mjaft për ti zgjidhur ato. Në bisedat dhe ligjëratat që mbante, me zërin e tij si bilbil, që i kishte falur Zoti, ai i bënte njerëzit për vete. I ftonte për të qenë të bashkuar, siç kishin qenë të parët e tyre.

BUJARI DHE HUMANIZËM

Ishte koha e luftës në Maqedoni. Shumë ushtarë ishin stacionuar në portat e Korabit. Një ditë, një djalë i ri, që sillte qumështin nga bjeshka e thërret mënjanë imam Rushitin.

- O hoxhë! Të kam sjellë një letër nga një shok shkolle, Servet Jusufi.

- Servet Jusufi? Po ku e gjete mikun tim?

Ishte në mal me shokët e luftës. Më pyeti se cili ishte fshati më i afërt. Kur i përmenda Radomirën, më pyeti për ty, nëse të njihja apo jo. Pastaj më dha këtë letër. Djali u largua dhe imam Rushiti hapi letrën e zhubrosur që vinte nga fronti: "Jemi nis për në dasëm të madhe - shkruante miku i tij. – Unë jam nën urdhra e nuk lëviz dot. Nëse don, më takon te porta e Korabit".

Të nesërmen niset për te vendi, ku i thoshte shoku i tij. I njihte mirë ato vise që nga fëmijëria. Kishte korrur bar, kishte mbledhur lule, kishte kullotur bagëtinë. Ja tek u nis sërish atë mëngjes prilli. Zogjtë cicëronin dhe bora ishte vende-vende, akoma e pashkrirë, sa më lart që ngjitej. Kishte marrë me vete dhe një lëkurë qengji, që miku i tij ta kishte për shtroje.

-Dikush i tha të ndalonte, duke e shkëputur nga mendimet. I tha rojes se donte të takojë komandantin, Tahir Sinanin. Pak çaste më vonë ata takohen në një shpellë aty pranë. Pasi pyeten për shëndetin e familjet, Rushiti e pyet komandantin nëse kishin nevojë për ushqim e batanije. Komandant Tahiri i thotë, se për momentin jemi në një situatë të vështirë. Furnizimet nuk kanë ardhur akoma dhe jemi katër ditë pa bukë.

Nuk ishte nevoja për ta zgjatur bisedën më tej. Mesazhi ishte i qartë. Koha, jo vetëm që nuk priste, por dhe me aq ishte tepruar. Jeta e atyre njerëzve vihej në rrezik. Ky popull, mendoi, Rushiti, gjithmonë është shquar për mikpritje. Madje, jo vetëm me njeri-tjetrin, por ka strehuar dhe hebrenjtë, duke marrë vlerësimet e botës për këtë akt. E si të mos i ndihmojmë vëllezërit tanë të një gjaku? U takua dhe me Servetin, shokun e tij të shkollës. U çmallën dhe kujtuan ato kohëra të bukura, që nuk vinin më. I tha se do të binte poshtë në fshat dhe do të takoheshin sërish, për të ndenjur më gjatë.

Me këto mendime ra në fshat. Shumë njerëz e prisnin për të bërë një mevlut. Pasi mbajti një ligjëratë për sadakanë dhe humanizmin u kërkon nga çdo shtëpi të gatuajnë bukë dhe të sjellin batanije. Në mëngjes ishin sjellë 180 bukë, sheqer, vaj, makarona e plot ushqime të tjera. Nëntë kuaj u ngarkuan me të shpejtë dhe u nisën për te vëllezërit shqiptarë në Korab, që përballeshin prej ditësh me urinë dhe mbijetesën.



Komandant Tahir Sinani u befasua, kur e pa atë karvan me ushqime në aq pak kohë. Ai që nuk ishte përlotur nga luftërat e gjëmimet e topave, ndjeu ti njomen sytë nga kjo bujari e pashoqe.

"Unë, - tha komandant Sinani, - kam qenë në Bosnje, Kosovë, Preshevë e shumë vende të tjera dhe nuk e kam parë askund këtë lloj humanizmi. Nëse nuk do arrij ta shkruaj vetë, do ta lë amanet që ta shkruajnë të tjerët". Ndoshta amaneti i komandant Tahir Sinanit mbeti pezull për pak kohë. Më pas, ai shkoi në vend. Nëse nuk arriti ta përcjellë vetë atë mbresë, nëse nuk e kanë përcjellë të tjerët para meje. I hodha unë ca rreshta mirënjohje për ato banorë të mrekullueshëm të Kalasë së Dodës dhe për mikun tim, imam Rushitin. Vetëm një muaj më vonë, komandant Tahiri u vra nga një minë e fuqishme dhe trupi i tij u shpërnda në qindra copa. Ai mbeti në histori, u skalit në këngë e në vargje për heroizmin e tij të pashoq. Bashkë me të u plagosën dy vajza tropojane, të cilat u përcollën në spital, falë ndihmës së pakursyer të popullit të kësaj zone.

Vetëm pak kohë pas mbarimit të luftës, imam Rushitin e thirrin në policinë e shtetit. Do ta pyesnin në lidhje me implikimin me luftëtarët shqiptarë të Maqedonisë, por mund dhe ta arrestonin. I vetmi faj i tij ishte se kishte ndihmuar vëllezërit shqiptarë në ato ditë të vështira. Bashkë me banorët e zonës u kishin dërguar batanije dhe ushqime. Ahmet Çaushi, në atë kohë myfti i Dibrës, e mori vesh se si po shkonte puna dhe paraqitet në polici, bashkë me imamin. U thotë përfaqësuesve të rendit se ishte gati të futej ai në burg në vend të Rushitit. U thotë se ndihej krenar, që kishte imamë të tillë të besës, të qëndresës, të humanizmit dhe luftëtarë të çështjes kombëtare. Pas kësaj gjërat marrin udhën e normalitetit dhe Rushiti shkon i qetë dhe i patrazuar në Radomirën e tij të dashur, ku e priste xhemati.

ROLI I PAJTIMTARIT

Nuk kishte vetëm pak kohë, që kishte filluar detyrën e imamit të Radomirës, kur i'u desh të përballej me sprova të vështira. Disa plagë, që dukeshin si të mbyllura para viteve nëntëdhjetë, po rishfaqeshin e përkeqësoheshin akoma më shumë. Pesë lagjet e Radomirës rrezikonin të bëheshin pre e një konflikti të brendshëm. Tejza, Sërdoku dhe Rade pretendonin se dy lagjet e tjera, Çernjeva dhe Derbaçi nuk kishin të drejtë kullotje dhe pronësie në Livadhin e gjatë, një tokë me sipërfaqe gati 80 hektarë. Arsye për këtë ishte se shumë kohë më parë, dy lagjet në fjalë nuk kishin dalë në mbrojtje të kësaj prone, kur ajo rrezikohej t'ju merrej. Kur ishin mbaruar argumentet nga secila palë dhe kur nuk shihej dritë në fund të tunelit, dikush propozoi ta linin këtë çështje në dorë të hoxhës për ta zgjidhur. Barrë e rëndë për shpatullat e njoma të imamit të ri.

Fillimisht, ai mori informacionin e duhur nga pleqtë e vjetër dhe të mençur. Jo vetëm kaq, por u kërkoi dhe ide se si mund të zgjidhej konflikti. Pas tre muaj përpjekje, diskutime e ligjërata me tema të kësaj natyre, u arrit dhe rezultati i shumëpritur. Radomira nuk ishte shumë e madhe për tu përçarë. Bashkë do të ishin në kullotje të bjeshkës, bashkë në pronësi, bashkë në të mirë e në të keqe, siç kishin qenë gjithmonë. Autoriteti i imam Rushitit fitoi kuota të reja në sytë e njerëzve që e rrethonin.

Pak kohë më vonë një tjetër situatë e rëndë u krijua në zonë, dhe pse jo e atyre përmasave, si e para. Pesë familje nga tre lagje të ndryshme të Radomirës, pretendonin secila se duhej të ishin trashëgimtarë të një toke prej rreth pesë dynymsh. Pronari i vërtetë i tokës kishte ndërruar jetë dhe tani pesë familjet që kishin lidhje gjaku me të kërkonin pronësinë. Asnjëra palë nuk lëshonte pe dhe situata po acarohej përditë e më shumë. Problemi kishte shkuar dhe në dyert e komunës dhe të autoriteteve shtetërore në rreth, pa arritur ndonjë rezultat konkret.

Sërish ju besua hoxhës zgjidhja e këtij konflikti. Ai ju drejtua dhe njëherë familjeve që pretendonin tokën, se a vërtet e kishin lënë në dorën e tij. Ato e siguruan se cilado të ishte zgjidhja e tij, nuk do ta kontestonin. U caktua një datë e afërt për tu mbledhur. Në takim kishin ardhur të gjitha palët në konflikt, pleqtë e vjetër të zonës, përfaqësues të këshillit e të komunës. Asnjeri nuk e dinte se çfarë kishte menduar imami në kokën e tij. Vetëm kur ju dha fjala, u njohën me vendimin që kishte marrë. Sipas tij, asnjëra nga palët në konflikt nuk kishte të drejtë pronësie dhe toka do ti kalonte vakëfit të xhamisë. Për më tepër, asnjëra prej këtyre familjeve nuk kishte të drejtë ta marrë as me qira për një periudhë prej të paktën dhjetë vjet, derisa të harrohej përfundimisht ky problem.

Sa e sa pajtime e ndërmjetësime bëri imam Rushiti gjatë kësaj periudhe. Njerëzit e linin gjithnjë zgjidhjen në dorën e tij, pasi kishin bindjen e plotë, se ajo do të ishte e drejtë dhe e pëlqyer nga të gjithë.

Ai i qetësonte zemrat e njerëzve me fjalën e tij, me zërin e tij si të bilbilit. Ai shëron dhe syrin e keq e magjinë dhe ka plot raste konkrete për ti treguar. Por ndoshta për këto do të flasim ndonjëherë tjetër.

Arsye të shumta e detyruan imam Rushitin të lerë vendlindjen dhe të banojë në Farkë të Tiranës. Ai po njësoj vazhdon aktivitetin e tij të ngjeshur në kontakte të shumta me njerëz. Në shpirt e ka vendlindjen e tij, ndaj e ka ngjitur fort tek mbiemri i tij, si pjesë e pandashme e identitetit.

triptik

Nëpër kohëra, nëpër vite...

Nga **MEVLUD BUCI**

Shpirti dhe kënga rrezatojnë dritë njerëzore dhe hyjnore. Para se të hyj nëpër rrjedhat e këtij triptiku, më duhet të përmend një trinom të një urtaku katolik:jeta, dashuria dhe mirësia, i cili ka domethënien e gjurmëve që lë njeriu dhe të kujtesë ndër kohëra e vite. Jeta është e shkurtër, por brenda mban tharmin e shpirtit, djersës dhe këngës. Ky trinom do të jetojë në breza, sa të jetojnë brezat e Dibrës dhe të shqiptarisë.

1.
PËRSE MË PIKOI NJË LOT?

Duke udhëtuar nëpër Rrugën e Arbërit, në atë rrugë, jo siç është sot, ecën gjysh-stërgjyshërit e mi më këmbë, dëgjoj një këngë të Naim Plakut. Dy djem të rinj, Flori Flamur Shehu e Mahir Hasani më pikasën teksa më shpëtoi një lot dhe më thanë:


-Xhaxha, përse derdh lot?...

U gjenda si ngushtë, por shpejt u thashë:

-Mallëngjehem teksa kujtoj penëviganin Naim Plaku…

Ndërsa vargjet e këngës sikur donin të dilnin me forcë nga kabina e makinës e të ushtonin në hapësirë:

Hej, fëmija e djepit kërkon pushkën,
Plaka në votër e theu furkën,
Gratë në llogore e pjekin bukën
Hej, bini trimat e mejdanit,
Hiqni sumllat e xhamadanit,
Me mbush hutën e dibranit….




Naim Plaku nuk është më, por sa herë dëgjoj këtë këngë, më vjen pranë me hijen madhështore të poetit profetik, me vargun shpërthyes e gurgullues…

2.
XHAFER MARTINI

Nëse Akademia e Shkencave , ndonjë institucion letrar apo asosacione të tjera do të analizonin veprën e Xhafer Martinit, me siguri kjo do të pranohej me dashamirësi dhe kënaqësi dhe atij do t` i akordoheshin dekorata, çmime, certifikata mirënjohjeje. Por dekorata më e madhe e tij është vepra prej 40 vëllimeve. Të gjitha librat e tij, romane, tregime, monografi, studime, gjurmime etnopsikike janë të bukura, por mua seç më tërheq disi veçan, romani 120 faqe"Fshati Mosqofsh".

Është një libër me një titull interesant dhe me një përmbajtje të fuqishme , gdhendur me realizëm dhe me një psikikë të veçantë, me ide të forta dhe tipa, karaktere



mbresëlënëse. Ky libër, krahas lexuesve të shumtë, është vlerësuar edhe nga dr.Rovena Vata, studiuese. Aty zbërthehen enigmat e jetës, dukuritë negative të fshatit shqiptar, që ka degraduar në demokraturë, ku servili gënjen, shpif, mashtron sheshit, damkos. Një prozë me një satirë të fuqishme rabëliane, shkruar me mjeshtëri. Mjeshtri i fjalës Xhafer Martini arrin të tipizojë aq bukur, sa proza e tij bëhet magjike dhe konkrete, me një sharm të jashtëzakonshëm.

3.
TOFIK TOTRAKU DJALI QË DRITËSON VENDLINDJEN

Tofik Totraku është emigrant në Itali, por ai nuk e harron vendlindjen, Lukanin e tij të dashur. Emigrantët janë heronj zëmëdhenj të punës së ndershme dhe të mendjes pjellore, ata shkruan dhe shkruajnë akte guximi dhe vullneti, duke kapërcyer dete dhe shtigje të panjohura. Tofiku, së bashku me vëllanë e tij, Latifin, ngriti vilën në Bathore, por edhe vilën e re me muret e gurta të kullës, përballë Valit shkëmbor. Nuk mund të harrohet vendlindja, jo thjesht për nostalgji, por aty është kujtesa për gjyshërit, baballarët dhe njerëzit e fisit, që e ruajtën dhe e hijeshuan atë në shekuj. Kullën e tij të re ai e rrethoi me mure guri dhe tani brazdon tokën, e mbjell atë, tokën që trashëgoi nga gjysh Veliu dhe babai Mehmeti.

Ky bir i Lukanit shquhet për mirësi, humanizëm, për dashuri e respekt për fisin fshatin e respekton traditat. Shqipja fluturon me krahë dhe Tofiku ka në gen e përditshmëri respektin për vëllezërit, kushërinjtë, shokët e miqtë.

Çdo vit më 20 Maj ai ngjitet në lartësitë e Pratit në Livadh të Gjatë, ku feston populli i Katër Grykëve, së bashku me kushërirën Ahmet Sharë Totraku e plot të tjerë. Do mbetet si kujtim I paharruar fakti që para tre vitesh ai solli në podiumin e maleve këngëtarin Sherif Dervishi dhe Musë Dautin e Hasit. Solli byrazerët , bijtë e Menës së Lurës trime, Dan Seit Mena, Adriatik Skënder Mena.

Tofik Totraku dëshmi të dinjitetit të tij ka provat e punës dhe të mirësisë. Ai i gëzohet vajzës së vogël dhe bashkëshortes, bijës së Markes së Mireshit të Dibrës.

I thjeshtë i urtë, punëtor e zemërbardhë, shembull kurajoje dhe guximi, për ta parë jetën si arritje dhe përparim, si dëshmi e respekt edhe për të tjerët…



Rruga e Arbërit nr. 190

Shkolla jopublike “Sarina 2002” feston 20 vjetorin

reportazh

Rrugëtim ndër vite me “Sarinën”

Nga **SHAQIR SKARRA**

Sivjet jo vetëm nxënësit e shkollës jopublike “Sarina”, jo vetëm kolektivi i mësuesve, por edhe vetë prindërit gëzuan së bashku. Dhe tre gëzime në një ditë. Mbyllja e vitit shkollor, mbyllja e maturës me rezultate të mira dhe festa e 20 vjetorit të shkollës jopublike “Sarina”. Njëzet vjet arsim dhe nga viti në vit duke u radhitur si një ndër shkollat më të mira në shkallë vendi.

Sot në këtë ditë të bukur feste, jo vetëm oborri i shkollës ishte mbushur plot, por edhe rrugët e lokalet aty pranë kishin njerëz më shumë se çdo ditë tjetër. E gjithë lagjja ku ndodhet godina e shkollës “Sarina” ishte në festë. Ngjyrat e saj ndjeheshin kudo. Kudo makina, lëvizje njerëzish, nxënës të buzëqeshur dhe veshur si për festë.

Ndryshe nga vitet e tjera kur shkolla “Sarina” kishte festuar e bërë aktivitete të mëdha festive, që zakonisht ishte mëngjesi ai që i bënte bashkë në oborrin e shkollës, sivjet vetë administratori i shkollës Liman Hoxha, bashkë me drejtorin Halil Begu, kishin vendosur që festën ta zhvillonin në orët e vona të pasdites. E pikërisht kur ora shënonte 18.00, Limani së bashku me Halilin prisnin në oborrin e shkollës të ftuarit. Rreshti i të ardhurve ishte i gjatë, ashtu siç ishte i gjatë edhe rrugëtimi i shkollës “Sarina”. Oborri i shkollës u mbush plot për plot, me të njohur dhe të panjohur. Kishte mysafirë të përhershëm të shkollës, kishte dhe banorë të lagjes, por kishte dhe të tjerë që futeshin për herë të parë në oborrin e shkollës “Sarina”.

Kjo mbrëmje e bukur dhe e freskët qershori ishte ditëlindja e shkollës “Sarina”. Njëzet vjet, nuk i thonë pak, një rrugëtim shumë i gjatë, me peripeci, vështirësi, mund e sakrifica, por nga viti në vit me suksese të mëdha. Dhe këtë udhëtim të bukur ndër vite më mirë se kushdo na e tregonte një monitor i përmasave të mëdha, vendosur në fasadën kryesore të shkollës. Një dokumentar i përgatitur me profesionalizëm gazetaresk, jo pak por 26 minuta, gozhdoi të pranishmit me vështrim në monitor.

Moderatori i njohur Defrim Methasani kujdesej për gjithçka, edhe për detajet më të vogla dhe tek hidhte herë-herë vështrimin nga të pranishmit, sytë nuk e gënjejnë për të gjithë të ftuarit, duke i njohur të gjithë edhe më parë. Në radhë të parë dukej zëvendësministri i Arsimit zoti Endrit Hoxha, deputeti i Kuvendit Popullor Denis Delia, përgjegjësi i zyrës arsimore Tiranë zoti Sulejman Keta, prof. dr.Ethem Ruka, rektor i Universitetit jopublik “Luarasi”, Admir Belisha - zëvëndësdekan i Fakultetit Juridik në Universitetin “Luarasi” e plot të tjerë.

Kishin ardhur edhe dy nënkryetarët e shoqatës “Lidhja e Intelektualëve Dibranë ing. Shaban Bitri e Musa Riçku.

Por në këtë mbrëmje festive të shkollës “Sarina” këtë radhë Defrimi nuk ishte i vetmi moderator. Bashkë me të moderatore ishte edhe ish nxënësja e kësaj shkolle Adela Hila,

Sot në këtë ditë të bukur feste, jo vetëm oborri i shkollës ishte mbushur plot, por edhe rrugët e lokalet aty pranë kishin njerëz më shumë se çdo ditë tjetër. E gjithë lagjja ku ndodhet godina e shkollës “Sarina” ishte në festë. Ngjyrat e saj ndjeheshin kudo. Kudo makina, lëvizje njerëzish, nxënës të buzëqeshur dhe veshur si për festë.



aktualisht studente në degën e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës.

Ora shënon 18.00 pasdite dhe oborri i shkollës ishte mbushur plot si rrallëherë tjetër. Kishin ardhur edhe mjaft ish mësues të kësaj shkolle, por që sot janë në pension, ish nxënës të shkollës “Sarina”, që sot punojnë në institucione të ndryshme sipas profesioneve. Shkolla sot kishte kaq shumë mysafirë të moshave të ndryshme, që nga fëmijët e deri tek pleqtë flokëbardhë, ashtu siç u shpreh dhe moderatori Defrim Methasani: “Një dasëm e madhe, por me krushq të zgjedhur”.

Uniforma e maturantëve, por dhe veshjet e nxënësve të tjerë si për festë krijonin një ansambël të tërë ngjyrash. Nuk mungonin as kostumet kombëtare, ku djem dhe vajza të veshura me to, hapën festën nën ritmin e një valleje të bukur popullore.

Jo vetëm fasada e shkollës, por edhe mjediset jashtë ishin zbukuruar vërtet bukur, me flamuj, banderola të ndryshme, me karrige të shumta, ku ishin ulur nxënësit e të ftuarit. Pikërisht këtu zhvillohej dhe aktiviteti i 20 -vjetorit të shkollës “Sarina”.

20 VJET MË PARË...

Atëherë Liman Hoxha sapo ishte kthyer nga emigracioni i gjatë. Kishte punuar shumë, kishte fituar dhe mendonte të investonte tashmë në vendin e tij. Mendonte si fillim të investonte në tregti, por shpejt ndryshoi mendim. Si fillim hapi një kopësht për fëmijë, me qëllim më së shumti që t’ju vinte në ndihmë sadopak komunitetit, të cilët gjatë ditës ishin të angazhuar në punë dhe nuk kishin se ku do të linin fëmijët e vegjël.

Kopshti u hap në vitin 2001 dhe kishte vetëm një klasë me 54 fëmijë. Edukatore e parë erdhi Brikena Hoxha. Vetë Limani kishte ambicie për më shumë dhe si rrjedhim në qershor të vitit 2002, krahas kopshtit, hapi shkollën jopublike “Sarina 2002” me 53 nxënës, cikli i ulët. Drejtor i parë ishte Rudina Maksuti. Mësues: Brikena Hoxha, Floresha Merko, Mentor Hoxha, Rudina Maksuti, Sherife Guri. Tashmë shkolla “Sarina 2002” sapo kishte nisur rrugëtimin e gjatë në udhën e dijes dhe nuk kishte forcë që e kthente prapa në udhën e saponisur.

Duke parë kërkesat e shumta që kishin prindërit për të regjistruar fëmijët e tyre në këtë shkollë, administratori Liman Hoxha mendoi të zgjerohej, të ndërtonte godinën e re dhe nga cikli i ulët të kalonte edhe në ciklin nëntëvjeçar dhe gjimnaz.

Ishte pikërisht viti 2005 kur shkolla jopublike “Sarina” hapi dyert edhe për maturantët që kishin mbaruar ciklin nëntëvjeçar e tani nuk ishte nevoja të largoheshin larg për t’u regjistruar në gjimnaze të ndryshme të Tiranës. Liman Hoxha po u sillte gjimnazin në komunitet. Në kohën kur sapo u hap gjimnazi, drejtor erdhi Besim Toçi, një kuadër me përvojë të gjatë në gjimnazin e qytetit të Peshkopisë, i cili me dijet e tij, me menaxhimin dhe kërkesat e larta karshi kolektivit të mësuesve ndikoi pozitivisht në rritjen cilësore të gjimnazit “Sarina”, duke u bërë i njohur tashmë edhe jashtë komunitetit. Kështu iu kërkua administratorit Liman Hoxha që duhej ndërtuar një godinë e re, e madhe e me shumë klasa. Duhej shtuar numri i



arsimtarëve të kualifikuar sipas lëndëve dhe pastaj nga viti në vit numri i nxënësve që filluan të regjistrohen në shkollën “Sarina” e kaloi numrin e parashikuar dhe gjeografinë. Kishte nxënës që vinin nga zona të ndryshme si Kamza, Kashari, Kinostudio, Lapraka, Kombinati. Pra, shkolla “Sarina” filloi të rritej nga viti në vit.

Në shkollën “Sarina” kanë shërbyer me devotshmëri si drejtues: Rudina Maksuti, Besim Toçi, Qazim Karaj dhe ai që po na pret në këtë 20 vjetor, Halil Begu. Sot në shkollën “Sarina” është një kolektiv me mësues të kualifikuar sipas lëndëve përkatëse me 60 mësues e 30 staf tjetër ndihmës. Për vetë prindërit që besojnë fëmijët e tyre në shkollën “Sarina” e dinë fare mirë se jo vetëm niveli i lartë i mësimdhënies, por edhe siguria e

Nga matura sivjet kishte edhe nxënës ekselencë, të cilët u vlerësuan me certifikata nga shkolla si: Anxhela Çejku, Armand Çera, Samel Hoxha, Lindion Haka, Ergita Hoxha, Andiela Darsi, Henri Teme, Antja Topalli, Ersilda Kobeta, Fjona Hoxha, Helga Mali, Marsida Kadiu, Rea Hida, Sindi Jaku, Xhesika Ibrahimi, Arbjola Demirxhiu, Daniela Gjidiaj, Emi Molishti, Arinda Mërkuri, Sabina Shira, Zemrite Ahmati, Rejsi Morina, Adelina Laçi.

nxënësve në këtë shkollë është e madhe, pasi transporti i nxënësve bëhet me mikrobuz nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas, ushqimi cilësor dhe i kontrolluar si dhe studim.

Moderatori Defrim Methasani, duke dalë jashtë skenarit, e nisi krejt ndryshe aktivitetin duke u shprehur: “Liman Hoxha është njeriu që guxoi 20 vjet më parë, duke hapur një kopësht privat dhe sot pas dy dekadash ndihet i lumtur dhe krenar që feston 20 vjetorin e shkollës së tij “Sarina 2002”. Në respekt të vlerave profesionale të stafit pedagogjik të shkollës, vite më parë besova dy nga tre vajzat e mia të studiojnë këti dhe ia dolën me sukses. Tashmë po me kënaqësi dhe krenari e them që moderova këtë event, sepse detyrimi ndaj administratorit Liman Hoxha, drejtorit Halil Begu, ish mësuesve dhe atyre që japin mësim sot është i ligjshëm, por edhe shërbimi profesional ndaj tyre është i merituar. Urime dhe 100 vite Sarinës!”.

MATURA E 13-TË.

Sivjet sapo ka përfunduar matura e 13-të në këtë shkollë, të cilët të gjithë me uniformën e maturës janë rreshtuar në rrershtin e parë dhe kanë të drejtë të gëzojnë, pasi sivjet dhe përqindja ka qenë më e lartë.

Nxënësit e shkollës “Sarina” nuk i pengoi as pandemia që të mos mësonin e mos të merrnin rezultate të larta në provimet e maturës. Sivjet është matura e 13-të, nuk i thonë pak 13 matura që kanë dalë nga shkolla jopublike “Sarina” dhe nga viti në vit rezultatet kanë qenë të larta, maturantët e kësaj shkolle kanë shkëlqyer edhe në universitete të ndryshme që kanë vazhduar.

Nga matura sivjet kishte edhe nxënës ekselencë, të cilët u vlerësuan me certifikata nga shkolla si: Anxhela Çejku, Armand Çera, Samel Hoxha, Lindion Haka, Ergita Hoxha, Andiela Darsi, Henri Teme, Antja Topalli, Ersilda Kobeta, Fjona Hoxha, Helga Mali, Marsida Kadiu, Rea Hida, Sindi Jaku, Xhesika Ibrahimi, Arbjola Demirxhiu, Daniela Gjidiaj, Emi Molishti, Arinda Mërkuri, Sabina Shira, Zemrite Ahmati, Rejsi Morina, Adelina Laçi.

Certifikata mirënjohje morën edhe mësuesit e ish mësuesit e shkollës: Shazivar Koka, Qazim Karaj, Klotilda Jaupi, Zabit Lleshi, Myrvete Thimio, Fatos Kodra, Irena Andoni, Tatjana Myftaraj, Brikena Hoxha, Viktor Gjini, Arta Kaca, Emine Zaimi, Nafiz Topi, Zarina Qyqja, Edmonda Çeço, Floresha Merko, Oliverta Kishta, Imelda Bregasi, Elsuida Mëcuku, Elona Leka.

Nga shkolla “Sarina” që morën dijet e para sot numërohen me qindra e qindra kuadro e intelektualë që drejtojnë e menaxhojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, por mund të përmendim: Gëzim Musha, ing elektronik, që aktualisht është me punë në Gjermani, Ekzon Çakri, mjek në Gjermani, Kledia

cyan magenta yelloë black





Shkolla "Sarina" prej kaq vitesh konkurron me shkollat më të mira në qarkun e Tiranës, në shkolla publike dhe jo publike. Nga kjo shkollë kemi nxënës që në olimpiada të ndryshme kanë marrë çmime të para dhe të dyta.

Në vitin 2002 -2003 shkolla nisi me 53 nxënës, në vitin mësimor 2003-2004, vetëm një vit më vonë, shkolla do kishte 155 nxënës, pra, trefishi i vitit të parë mësimor, kur dhe shkolla ishte hapur. E sot në këtë njëzet vjetor, shkolla jonë ka 800 nxënës.

Hoxha, ekonomi-bankë, në Gjermani, Sara Hoxha, ing, arkitekte Amerikë, Gjulja Gjoka, pedagoge Kanada, Seit Sorra -Informatikë në Kanada, Renata Picari - Ekonomi në Turqi, Indrit Koni, ing/ në Ministrinë e Transporteve, Jani Begu - mjek etj. Sinqerisht kërkojmë ndjesë që nuk mundëm që nëpërmjet këtij shkrimi t'i përmendnim të gjithë që dolën intelektualë, kuadro të kompletuar nga bankat e shkollës jopublike "Sarina".

Në shkollën "Sarina", në 20 vite kanë mbaruar mbi njëmijë maturantë gjimnazistë, mbi dymijë e pesëqind të ciklit nëntëvjeçar dhe aktualisht mësojnë në shkollë 800 nxënës.

Limani, si administratori i vetëm i shkollës, si i zoti i shtëpisë në këtë ditë feste flet pak për vete, më shumë flet për shokët me të cilët ka punuar njëzet vite me radhë: "Institucioni arsimor "Sarina" që në fillesat e saj kishte si vizion krijimin e shkollës model, në përvetësimin e programit dhe zhvillimin e dijeve të qëndrueshme përmes mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore.

Ky vizion e shndërroi këtë institucion në vatër të kultivimit të vlerave më të mira, në edukimin dhe formimin profesional të nxënësve tanë për të ardhmen, zhvillimin e personalitetit të tyre, mendimit e veprimit të pavarur, kritik, tolerant si dhe nxitjen e tyre për rezultate të larta e reale dhe për pjesëmarrje aktive në jetën e shkollës. Duke ofruar këto shërbime, shkolla "Sarina" vetëm pas një viti trefishoi numrin e nxënësve, pas dhjetë vitesh e dhjetëfishoi dhe tani që ne flasim, shkollën tonë e frekuentojnë 800 nxënës, 90 punonjës.

Këtu gjej rastin që të falënderoj pa masë prindërit që na besuan gjënë më të shtrenjtë, fëmijët e tyre. Ky besim na bën më të obliguar dhe na ngarkon me përgjegjësi, që mos të zhgënjehen.

Unë isha optimist kur u nisa në udhën e arsimit njëzet vite më parë, por të them të drejtën nuk do besoja se "Sarina" do të rritej kështu, do vinim këtu ku jemi. E kjo meritë nuk më takon mua. Jo, unë vetëm nuk mund të bëja asgjë pa këtë kolektiv të mrekullueshëm e kualifikuar, ndaj sot më takon t'i falënderoj me radhë. Mes nesh në këtë ditë feste na mungojnë dy shokë, dy kolegë të mirë: Sonila Totraku, ish mësuesja e talentuar e letërsisë dhe mësuesi i matematikës Shkëlqim Salillari. Me të dy vdekja u tregua tinëzare dhe na i shkëputi herët nga kolektivi ynë.

Falënderoj mësuesin e palodhur Azem Teta, i cili i kudogjendur dhe i palodhur për aktivitet artistike e kulturore të shkollës, si dhe mësuesit Shazivar Koka, Miftar Veliu, Fadil Vuka, Shkëlqim Çollaku, Anila Hila e plot të tjerë. Sigurisht, për sa kemi arritur ne jemi krenarë, por na motivon dhe na bën më të përgjegjshëm që të punojmë më fort, të vlerësojmë arritjet, por të mendojmë edhe për të ardhmen"

Shkolla "Sarina është tashmë vërtet një institucion i kompletuar arsimor, ku përveç klasave me jo më shumë se 25 nxënës dhe ekipit të kualifikuar të mësuesve ka edhe kabinet fizike, kimie, biologjie, informatike, gjuhët e huaja etj. Shkolla ka një palestër model me të gjitha kushtet e nevojshme, ka fusha futbolli, volejbolli e basketbolli, salla për aktivitete, kuzhinë e mensë.. Ka një bibliotekë të pasur me letërsi artistike, por edhe studime pedagogjike e psikologjike që u nevojiten nxënësve.

Administratori i shkollës Liman Hoxha tregon vetë një kujdes të vazhdueshëm të bibliotekës, duke e pasuruar herë pas here me tituj të rinj librash.

Shkolla "Sarina" ka edhe gazetën e saj dhe revistën që botohen rregullisht dhe në faqet e tyre ka shumë krijimtari nga nxënësit e shkollës. Revista e shkollës u shpërnda po këtë ditë feste për të pranishmit. Është botuar edhe almanaku i shkollës me të gjitha krijimet e nxënësve. Në shkollën "Sarina" nuk mungon as muzeu i shkollës, i cili është mjaft i pasuruar për rrugëtimin e gjatë 20 vjeçar të shkollës, ku gjejmë nxënës të dalluar, mësues, por edhe drejtuesit e shkollës si dhe mjaft çmime e olimpiada që ka fituar shkolla në 20 vite rrugëtim në fushën e dijes.

ENTUZIAZMI I DREJTOR HALILIT

Edhe kur këtij aktiviteti të madh po i vinte fundi, domosdo që do të fliste edhe drejtori i shkollës Halil Begu, i cili në fakt kishte shumë për të thënë, pasi 20 vjetori i shkollës "Sarina" nuk kishte qenë kaq i lehtë në arritjet dhe rezultatet e mëdha. Domosdo që ishte dashur shumë punë, shumë sakrificë, shumë lodhje, por mbi të gjitha, të gjithë si kolektiv



i mësimdhënies ishin të kënaqur.

Shkolla "Sarina" prej kaq vitesh konkurron me shkollat më të mira në qarkun e Tiranës, në shkolla publike dhe jo publike. Nga kjo shkollë kemi nxënës që në olimpiada të ndryshme kanë marrë çmime të para dhe të dyta.

Sot kjo shkollë ka konsoliduar jo vetëm arsimin nëntëvjeçar, por edhe arsimin e mesëm. Pranimi në shkollën "Sarina" bëhet mbi bazën e rezultateve që nxënësit kanë arritur në klasat pararendëse. Shikohet edhe sjellja dhe qëndrimi i nxënësit ndaj mësimit dhe vlerave njerëzore.

Drejtor Halili ndër të tjera në fjalën e tij u shpreh: "Ndjehem me fat dhe i privilegjuar që pikërisht sivjet ku shkolla "Sarina" feston ditëlindjen e saj të njëzet unë të jem drejtori i kësaj shkolle me emër të mirë në të gjithë qarkun e Tiranës.

Edhe pse në fakt arsimi jopublik është biznes, ky është biznes elitar dhe vetë administratori ka qenë tepër i kujdesshëm në këtë drejtim. Që këtu fillon disiplina e rregulli i madh. Mjafton të bëjmë një pasqyrë të nxënësve ndër vite dhe kuptohet vetvetiu jo vetëm disiplina e rregulli, por dhe niveli i mësimdhënies në këtë shkollë. Nëse në vitin 2002 -2003 shkolla nisi me 53 nxënës, në vitin mësimor 2003-2004, vetëm një vit më vonë, shkolla do kishte 155 nxënës, pra, trefishi i vitit të parë mësimor, kur dhe shkolla ishte hapur. E sot në këtë njëzet vjetor, shkolla jonë ka 800 nxënës. Kjo ka sjellë nevojën e shtimit të hapësirave dhe mjediseve për të cilat nuk është kursyer administratori Liman Hoxha.

Në shkollën tonë ka mjedise të bollshme, kabinete të pajisura, bibliotekë e kabinet të plotë informatike. Krahas gjuhës angleze dhe italiane në këtë shkollë mësohet edhe gjuha gjermane. Shkolla "Sarina" është një progres dijesh. Emri i "Sarinës" tashmë është bërë shumë i njohur, falë arritjeve nga viti në vit, falë punës së palodhur, falë bashkëpunimit të shkëlqyer, na mundëson që të realizojmë objektivat që kemi vendosur.

Në këto 20 vjet, që janë vite të mbushura plot arritje dhe cilësi, kanë përfunduar shkollën me dhjetëra e qindra nxënës të shkëlqyer, të cilët na kanë nderuar e vijojnë të na nderojnë në shkolla e vende pune cilësore brenda e jashtë vendit.

Frytet e kësaj pune të palodhur asnjëherë nuk na kanë munguar. Sa shumë punë është bërë dhe sa energji është derdhur që emri i shkollës të lartësohet mes shkollave më të mira të Tiranës. Jemi dalluar gjithmonë për cilësinë e mësimdhënies dhe veprimtarive shkencore e kulturore të organizuara në nivel shkolle, rajoni e më gjerë, kombëtar e ndërkombëtar. U bënë disa vite që rezultatet janë të qëndrueshme dhe në rritje. Vetëm këtë vit shkollor në olimpiada rajonale pesë nxënës nga shkolla jonë u shpallën fitues. Në arsimin e ulët u realizua kalueshmëria 100% dhe nota mesatare 9.1. Në arsimin e mesëm kalueshmëria 100% me notë mesatare 8.5. Në provimin kombëtar të klasave të pesta u realizua kalueshmëria 100% me notë mesatare 9. Në provimet e lirimit 70% e nxënësve morën notën 8, 9 e 10. Në provimet e maturës 60% morën notën 8, 9, 10. Kështu pra, arritjet e shkollës sonë kanë shumë për të dëshmuar e transmetuar në bashkinë e kryeqytetit, por mbi të gjitha, për potencialin e madh, pasi synimi i saj është të përgatisë qytetarët e denjë të së nesërmes".

Kishte mbaruar fjalën drejtor Halili, kishin mbaruar përshëndetjet nga të gjithë e aktivitetit po i vinte fundi, por ende askush nuk lëvizte të largohej. Ora shënonte 22 kur të pranishmit filluan të dalin jashtë portës së shkollës. Limani kishte dalë jashtë duke i përcjellë të gjithë. Një shtrëngim duarsh dhe një urim i përbashkët: "Festofsh edhe 30 vjetorin, edhe 40 vjetorin, edhe 50 vjetorin, Liman Hoxha! Festofsh sa më shumë përvjetorë të shkollës "Sarina".

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 190
botime

Prof.Shpëtim Cami "koherent me ato çka thotë e bën"

Nga Halil RAMA



Pasi ke lexuar librin "KOHERENCË" të autorit Shpëtim Cami – botim i "M&B", nuk ka se si të mos i bashkohesh vlerësimit të Prof. asoc. Dr. Zamira Çavos, pasi me të vërtetë në të gjen shpirtin dhe veprën e një njeriu koherent me ato çka thotë e bën.

I kompozuar në formën e një triptiku (me tre kapituj: Vlera dhe personalitete; Opinione dhe analiza; Politika dhe qeverisja si përgjegjësi)libri "Koherencë" përçon tek lexuesi mesazhet e një intelektuali me vitalitet e shpirt krijues.Autori e bën këtë në 38 shkrimet që i përgjigjen titullit të librit, si profile, reportazhe, analiza e refleksione.Ai ka meritën që t'i paraqesë personazhet dhe ngjarjet në mënyrë sugjestive, me thjeshtësi dhe në mënyrë të perceptueshme në komentet dhe në arsyetimet e veta.Në tërësinë e lëndës ndjehet dora e një publicisti të përgatitur, që shkruan me ndjenjë e me stil, cilësi këto që e bëjnë interesant këtë libër për lexuesin. Në këtë pikëpamje libri ka vlera të njëmendta dhe është i rëndësishëm fakti që botohet bash në kohën e duhur.



Duke evidentuar dhe përçuar tek lexuesi vlera të veçanta, me qartësi mendimi dhe me stil të mprehtë, autori shkruan për personalitete të cilat, edhe pse nuk jetojnë, do të ishin në unison me të, në shqetësimin e tij për të ardhmen e kombit, për Shqipërinë. Shembulli më sinjifikativ për këtëështëprofili i Prof. Nuri Abdiut, si emblemë e fisnikërisë, urtësisë dhe mençurisë dibrane. Madje, autori ia dedidon pikërisht këtij dishepulli të dijes edhe zgjedhjen e tij në dilemat midis fushës akademike dhe asaj politiko-administrative. Ndonëse me përvojë jo të pakët në këtë të fundit (si ish-Përgjegjës i Sektorit të Statistikës dhe Informacionit në Drejtorinë Arsimore Kurbin; ish-Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Transportit Rrugor, anëtar i Këshillit të Bashkisë Tirnë, Kryetar i Njësisë Bashkiake Nr.1, Tiranë, etj), referuar prof.Abdiut, autori shkruan se Ai, pa u menduar gjatëi ka rekomanduar që të angazhohet në fushën akademike. Rezultati i kësaj përzgjedhjeje është përvoja 12-vjeçare e Shpëtim Camit në sistemin e arsimit të lartë, si pedagog dhe drejtues në Universitetin Illyria, Tiranë dhe Universitetin Ndërkombëtar Strugë, Maqedoni e Veriut. Aktualisht ushtron detyrën e përgjegjësit të Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit pranë Universitetit "Barleti"në Tiranë.

U ndala jo pa qëllim, pak në CV-në e këtij autori, për të evidentuar implementimin e kësaj përvoje gati 38-vjeçare në fushën e arsimit, politikës, administratës, shoqërisë civile, biznesit dhe në fushën e botimeve, si edhe në këtë liber.

Kështu, në kapitullin e parë"Vlera dhe personalitete", autori shkruan me frymëzim, por edhe me plotë emocione dhe krenari të ligjshme për "Gjoricën, fshatin midis ujrave", si reçensë të librit të bashkëautorëve Qemal osmani e Shaqir Skarra.

Me mjeshtri të rrallë artistike autori sjelledhe jehonën e këngës dibrane në Kurbin, nëpërmjet zërit brilant të artistes së mirënjohur Liri Rasha, dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt "Mjeshër i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut". Për këtë ai i referohet kohës kur kjo artiste më 1994, me bashkëshortin e saj Pashk Jushi erdhën të jetonin pranë të afërmëve të tij në qytetin e Laçit. "Pavarësisht se në Laç mungonte tradita e këngës si në Dibër, Liria kontribuonte, jo vetëm me zërin, por edhe me përvojën e saj artistike. Ajo ishte pjesë e koncerteve me orkestrën e Pallatit të Kulturës Laç dhe Krujë, të cilat u shfaqën jo vetëm në rrethin e Krujës e të Kurbinit, por edhe në Danimarkë e Belgjikë", -shkruan autori Cami. Më tej ai i bën të ditur lexuesit se në Laç u rrit edhe e bija e Liri Rashës, Ingridi, trashëgimtarja e zërit kumbues të nënës së saj dhe që prej vitesh ka bërë emër si një zë i veçantë dhe interpretuese dinjtoze e këngës qytetare dibrane e asaj shqiptare në tërësi.

Në morinë e vlerësimeve autori i librit shkruan për shkollën e fshatit Viçisht ku u skalitën dashuria për letërsinë dhe shkëncat e natyrës.Po ashtu në reportazhet "Një udhëtim buzë Korabit" e "Një ditë e veçantë me vlera të shumëfishta" (Nga fjala në "Ditën e librit", zhvilluar nga Lidhja e Intelektualëve Dibranë në Shkollën "Hasan Leka, Shumbat) autori përcjell mesazhin se ka edhe vlera të mira ky vend, kjo krahinë, që duhen njohur, që duhen ndjekur e promovuar.

Ndërsa kur është fjala për Bulqizën "pasuria me tre emra", Sh.Cami, përveçse përshkrimit brilant të pozitës gjeografike, fokusohet edhe në vendbanime të herëshme me gjetjet arkeologjike në Krajkë të Zerqanit apo në Shupenzë, si edhe në fushën e Gjoricës, luginën e Fushë Bulqizës dhe të Vajkalit, që kanë hyrë në histori që nga koha e Skënderbeut.

Pjesë e këtij libri racional, emocional, dokumentar, arkivor është edhe artikulli "Sfida që duhen përballuar"(Mbi kontributin dhe suksesin e Shoqatës Gryka e Vogël Dibër), si dhe intervista dhënë gazetës "Rruga e Arbërit" ("Faktor të bën nevoja e përbashkët") kur Z.Cami ishte nënkryetar i Njësisë bashkiake Nr.1, Tiranë.

Ndërsa në kapitullin e dytë "Opinione dhe analiza" autorishpalos një shpirt të madh, gati parajsor, pothuajse nëtë gjitha shkrimet, si në analizën e librit me vlera globale të gjeneral Gëzim Ostrenit "Dëshmia e Gjeneralit", ashtu edhe në këndvështrimin mediatik mbi luftën e UÇK-së në Maqedoninë e Veriut, për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut si faktor shtetformues, etj.

Testin e saktë të profesionalizmit të tij, Sh.Cami e kalon suksesshëm edhe në pjesën e portretizimit. Këtë ai e jep, jo vetëm në profilet e personazheve të spikatur (sinë profillin e prof.Nuri Abdiut), por edhe kur shkruan për të njohur e të panjohur shumë për publikun, si për "Vlerat qytetare të Leko Makos" ashtu edhe tek "Heroi i shtangës", kushtuar peshëngritësit Aleksandër Kondo.

Në kapitullin e tretë "Politika dhe qeverisja si përgjegjësi" Sh. Cami është i drejtpërdrejtë me lexuesin e tij dhe konformizmi për të është i papranueshëm.Reflektim i këtij qëndrimi janë shkrimet "Tirana, një model

Profilin krijues të këtij autori e evidentojnë më së miri Prof.asoc. dr.Zamira Çavo dhe prof.asoc. dr.Bajram Yzeiraj, vlerësimet e të cilëve janë vënë që në hyrje të librit. Kështu nëse sipas Znj.Çavo: "në këtë libër gjen komunikim njerëzor si dhe vlerësime për individë që kanë kontribuar në shoqëri heshtazi, pa pritur lëvdatat publike, por me besimin që një vepër e mirë nuk harrohet dot kollaj", për Z.Yzeiraj: "botimi sjell një pjesë të jetës e veprimtarisë së autorit në kohë të ndryshme dhe njëherësh pasqyron vlerat e mjedisit familjar, shoqëror e shtetëror ku ai ka zhvilluar veprimtarinë e tij; si dhe problematikën e kohës në fushën politike të qeverisjes, të shoqëruar me përkushtimin e tij si intelektual, për ndryshim e zhvillim".

përtej të majtës e të djathtës", "Të ndjesh përgjegjësinë e përfaqësimit", "Fokusi i punës së ndërlidhësve me komunitetin"etj.

Sh.Cami vjen kështu në tregun e librit shqiptar me një përmbledhje publicistike, sa modeste aq edhe mbresëlënëse. Thjesht dhe bukur, me gjuhë të pasur dhe me një ndjesi njerëzore, ai rrëfen, përshkruan, tregon fakte, ngjarje, jetë heronjsh dhe kontribute njerëzore.Me një gjuhë letrare dhe rrëfim të admirueshëm ato të emocionojnë për detajet e stilin që ai ka zgjedhur dhe që e bën origjinal.

Referuar fakteve që na sjell autori dhe libri i tij me reportazhe, portrete, analiza etj, vetë kultura në këtë libër shumë të detajuar dhe mjaft përfshirës është reflektim nga qasja, tradita, avancimi në njohjen e gjerë të veprave të marra në konsideratë, po ashtu dhe të personaliteve që autori i ridimensionon me thjeshtësisnë e bukurinë e fjalës shqipe.

Profilin krijues të këtij autori e evidentojnë më së miri Prof.asoc.dr.Zamira Çavo dhe prof.asoc.dr.Bajram Yzeiraj, vlerësimet e të cilëve janë vënë që në hyrje të librit. Kështu nëse sipas Znj.Çavo: "në këtë libër gjen komunikim njerëzor si dhe vlerësime për individë që kanë kontribuar në shoqëri heshtazi, pa pritur lëvdatat publike, por me besimin që një vepër e mirë nuk harrohet dot kollaj", për Z.Yzeiraj: "botimi sjell një pjesë të jetës e veprimtarisë së autorit në kohë të ndryshme dhe njëherësh pasqyron vlerat e mjedisit familjar, shoqëror e shtetëror ku ai ka zhvilluar veprimtarinë e tij; si dhe problematikën e kohës në fushën politike të qeverisjes, të shoqëruar me përkushtimin e tij si intelektual, për ndryshim e zhvillim".

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Bëj një abonim
online ose
kopje të shtypur...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com


Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit
ose ndiq linkun:
https://tinyurl.com/lcc3e2f

Ne kujtojmë të kaluarën për të shëruar të tashmen. Vështrojmë mbrapa për të mbajtur moralin lart, gëzohemi me pak gjëra se e ardhmja e jonë dhe e fëmijëve e bashkudhëtarëve të jetës do t'iu ndizen drita jeshile fatmira.

Çukitje kujtimesh në petale jetësh që prej gjysëm shekulli

Kujtimet janë ujëra të pastra që rrjedhin nën mbulesën e gjetheve të vjeshtës. Edhe këto janë shumëngjyrëshe, formash e të përqafuara njëra me tjetrën. Secila prej tyre vjen nga një nanë që quhesh shkurre dru, bimë barishtore. Ato flenë të qeta, meqenënse ujin e kanë vumun për poshtë. Ai veç i freskon dhe i përkëdhel duke kompozuar muzikën e vjeshtës. Shirat dhe stina e dimrit nuk kanë ardhur.

Secili prej nesh e kujton atë qershor. Provimet e klasës së tetë gjysëm shekulli më parë. Aritmetika, gjeometria, shpjeguar me plot art e pasion nga mësuesi Sefedin Xharri. Ne vogëlushët ulur në bangat prej dërrase të lyer me bojë të zezë, vështronim fytyrëndrojtur mësuesin. Ai zgjidhte sisteme, ekuacione në dërrasën që mbushej plotë shifra e shkronja. Gishtërinjtë e mësues Sefedinit bardhësonin nga pluhuri i tyre, si të një mullinxhiu. Ai luante teatrin e mësonjëtorit. Fliste, shkruante, vështronte nga ne e lëvizte nga njëra në anën tjetër të dërrasës së zezë. Ishte kompesatë, rrethuar me një kornizë druri e gjitha lyer me bojën e zezë. Aty ne ngulnim shikimin e përqendronim vëmendjen. Si sot më 14 qershor i vitit 1972, nuk më kujtohet se kujt i lindi ideja për të bërë një fotografi. Ishte një gjë shumë e rrallë, kjo, këtu e pesëdhjetë vjet të shkuara.

Ashtu të ndrojtur, fjalëpakë, plot emocione, u radhitëm sipas këshillës të mësueses Besa Trepça Hoxha. Një strukturë e kulturuar e kohës. Një kujtim që u fiksua në celuloid e pastaj në letër. Shëmbëlltyra e kohës. Vogëlushë të ndrojtur, por me vështrim të kthjelluar. Pse jo të dashuruar ëmbëlsisht pas dijes. Këmbëngulja, vullneti ynë, i ngjanin bletës punëtore që mbledh pjalmin lule më lule, për të ndërtuar hojet e mbush me mjaltë, për vete e kujdestarët njerëz.

Me ato çantat prej bezeje krahaqafë, aty këtu me njolla bojë shkrimi mbushur me libra, me laps të zi, bishtin e penës me majën e saj të lugtë, me boshllëkun në mes në formë maje shigjete luftarake. Mblidheshim si ujët e një përroi malor nga shumë burime: nga Lagjia Zoke në Sinë të Poshtme, nga Shehri i Vajmdheve, nga fshati buzë drinas Rrethi i Kale, nga Stremi i Hoxhe, nga lagjia Leke e Kodra e Mëzeze, nga lagjia Algjone e Lindërsat e Lace... Në agimet qiell kthjellta ose me pak shtëllunga resh, lëviznim rreth fushës së sportit, duke thënë mësimin e ditës të, historisë, gjeografisë, biologjisë etj, me Zaimin, Vebiun, Gëzimin, Munirin, Setkiun etj. Uleshim në banga me pak frikë të brendshme, që rrinte strukur brenda qenieve tona. Por nuk të falnin në matematikë Muniri, Skënderi, Fetija, Vebiu, shkumësi në mes gishtërinjve të hollë shkruante në dërrasën e zezë pa u ndaluar. Zëri i Zaimit në histori, gjeografi kryqëzohesh hera herës, me atë të Dritës, Fluturës, Liries e Alltanes për ngjarje data, krahina, kryeqytete të ndryshme.

Sapo filluam të mësojmë shkronjat e para në ditët e para të shtatorit 1964 u rreshtuam me kova e ibrinxhe. Dora-dorës duke i mbushur nga ujë kthjellti Dri për të ujitur arrat, mollat, kumbullat e sapombjella shpateve të kodrës së Gjarecës. Ato po hidhnin shtatin e tyre në brezaret e kësaj kodre mbushur me historira luftrash. Ne po hidhnim hapat e para në udhët e dijes. Ne rriteshim me pemët frutore, me qingjat e dhistë. Gjithçka po transformohej si një spirale, peizazhi natyror dhe ai shpirtëror. Ndërsa brezaret e dijes po i formonin me mësuesit tonë. Ndërsa ato në shpate kodrash, agronomi arkitekt i peizazheve Xhavit Hysa me Abdurahim Ashikun që i ka skalitur në foto e rreshta shkrimesh gazetash e librash.

Kurorat plepave na kanë future nën krahët e tyre, plotë gjethe gjelbërta. Trungjet e tyre lyer me gëlqere ruajnë dhe ushqejnë masën e blertë duke na dhuruar freskinë e hijen e shumë dëshirueshme. Secili shikon fotografin me mënyrën e vet. Sefedini buzëqesh, ku flokët e zes fshehin paksa ballin, këmisha borë e bardhë i ndriçon fytyrën. Krahun të shtrirë e ka vendosur mbi kamën e djathtë, duke e shtrënguar. Më pas u pasionua pas historisë, por edhe një veprimtar i shquar. Biologjia u bë materia më e dashur, duke mëkuar breza të tanë nxënësish.

Mësuesi i Fizikës, nga fisi Këbej ka kryqëzuar duart. Me shikimin zhbirues djaloshar. Me karrierë të merituar në fushën e arsimit. I përkushtuar fort pas historisë kastriotiane. Krijues i librit historik: ''Origjina Dibrane e Skënderbeut, , dhe i Muzeut të Heroit Kombëtar në Sinë të Poshtme. Besniku që shkruan dhe mbron tezën, që Kastriotët kanë rrënjë të thella në Dibrën e Poshtme si dhe zhvillimi i betejës së Torviollit.

Nëndrejtori i shkollës, mësues Maliq Hasi, (09.04.1942- 31.08.2020). Nga fshati Kandërr vinte në kambë për të mëkuar me dije e kulturë fëmijët në shkollën fillore Reth Kale nga 01.02.1969 deri më 16.02.1971. Pastaj mësuesi i urtë e plotë kulturë Maliqi, transferohet si mësues e nëndrejtor në shkollën 8 vjeçare në Muhur nga 16.02.1971 deri më 29.08.1977.

Mësuesi Mudë Lala, në klasën e tretë dhe të katërt fillore, na mëkoi me dashurinë për të mësuar, na dha edukatën e duhur e kërkues e metodist në disiplinat që na mësonte. Peshkatar me rrjetën e tij me zara plumbi, gjuante peshk trofta në lumenjtë Murrë e Drin. Rosat e tija me fletë e pupla bardhë e zi, gjallëronin e zbukuronin ujërat gurgulluese të Murrës. Mbështetur në krahun e djathtë të tij, gjimnazisti, mësuesi ynë i gjuhës e letërsisë në klasën shtatë dhe të tetë Bashkim Shehu (Gazidede) (02.02.1952-25.10 2008). Djalosh energjik, simpatik, mjaft i amël në biseda. Vazhdoi studimet për matematik në Institutin Pedagogjik Shkodër. Transferohet pedagog matematike në Universitetin e Tiranës. Merret me politik, arrin të bëhet deputet dhe të kryejë detyrën e kryetarit të SHIK-ut. Ndërron jetë në një spital të Turqisë.

Në mes dy nxënësve me emrat Gëzim, në këmbë, mësuesi i biologjisë dhe kujdestar Elez Balliu (06.06.1926-04.02.2009). Urtësia e tij ishte pjalmuar në veprimet e reagimet në çdo situatë. Njihte dhe e shpjegonte lëndën mjaft mirë, po kështu lexonte gjendjen shpirtërore e përgatitjen e mësimeve të nxënësve çdo ditë e në çdo rrethanë me shikimin e tij zhbirues e serioz. Nga partizan në luftën nacionalçlirimtare, në komisar të dritës së dijeve.

Kërkoi të dijë në petalet e jetës të bashkëmoshatarëve të mi ngjarje, data me plotë mbresa. Secili ka përshkuar dallgëzime të shkumëzuara në detin me batica e zbatica të jetës. Ndokush ka udhëtuar në hullitë e tokave duke hedhur farën e grurit, misrit fasules. Të tjerë kanë thithur dijet në bangat e shkollave të mesme. Gjeografia e të cilave është nga Lezha, në Durrës, Tiranë, Shkodër etj. Të tjerë kanë udhëtuar në kam rreth pesë orë çdo ditë, shkuarje e ardhje Muhurr–Peshkopi, për t'u shkolluar në gjimnaz. Edhe pse shiu, yllëzat borëbardha ju binte mbi supet e flokët e shpupurisura apo në faqet e bardha lëkurëbardha, delikate. Ato ecnin, zgjatnin hapin në udhët e natyrës e të dijes. Ato ishin prej mishi e kockash, me mushkëri e zemra, por veçse brenda tyre mbartnin dashurinë për dijen, vullnetin, pasionin e besën prindërve e vetë vetes për të realizuar qëllimin: me u ulur në auditoret universitare. Disa e realizuan ballëlart, krenar duke i zbardhur faqen vetes, familjes, tokës e peizazheve muhurake, si Skënderi, Vebiu, Fitia, Muniri, Zamiri, Selmani.

Në pentagramën e jetës së tyre, bashkëmoshatarët e mi krijuan familjet. Celulën më me vlera në trashëgimin njerëzore. Lindën e rritën fëmijë. Ato u mëkuan si baballarët e nanat e tyre me dije e kulturë. U ngjitën hijshëm e kokëlartë në banga shkollash e auditore universitetesh. Moshatarët e mi tani me flokët e thinjura ose tullacë, me fytyrën e ballin me rrudha, janë bërë edhe gjysha. Por një plagë e re, e thellë, mbushur me dhimbje therëse, ju hap brezit tonë. Kurbeti, syrgjynosja, si murtajë e zezë përlau disa nga neve dhe fëmijët e gjithë secilit. Lotët dhe malli thuhet se shpon gurin. Ndërsa bashkëmoshatarëve të mi po ju tret e ziton shpirtin, jetën, po i thanë si lisa. Ishte kjo fatkeqësia minashpërthyese e shkatërrimit ekonomik, njerëzor, moral dhe breznish të tëra, të errësuar nga padija e të torturuar nga kriminelët e kohës në pushtet.

Nuk gëzohen e lumturohen së bashku me ne në këtë pesëdhjetë vjetor mësues Elezi, Muda, Maliqi, Bashkimi dhe ish nxënësit, Rasimi, Gëzim Çiku dhe Bashkimi. Por ata janë kështu të qeshur, të gëzuar, fytyra e ballëndritur midis nesh, në zemrat e kujtimet tona të pafikshme.

Ne kujtojmë të kaluarën për të shëruar të tashmen. Vështrojmë mbrapa për të mbajtur moralin lart, gëzohemi me pak gjëra se e ardhmja e jonë dhe e fëmijëve e bashkëudhëtarëve të jetës do t'iu ndizen drita jeshile fatmira.

Bashkëmoshatari Selman Meziu
Firence 14.06. 2022

PROVIMI QE I MBUSHI GJYSEM SHEKULLI



Foto nxanës e mësues të klasës së tetë, Shkolla tetë vjeçare ''Nexhat Agolli, , Fushë Muhur, para provimit të matematikës me 14.06.1972. Emrat nga e majta në të djathtë nga rrjeshti i parë ulur:

Sefedin Xharri, Mësues Matematike, Besnik Kabej, Mësuse Fizike; Maliq Hasi N/ drejtor shkolle; Mudë Lala, Mësues në klasën e IV; Bashkim Shehu (Kazideda), Mësues Letërsie; Vebi Rakip Xhani nxanës: Hamije Faik Lleshi; Isamail Qerim Hoxha; Alltane Halit LLeshi; Setki Zenel Dabiçi; Hajrie Mud Kaleshi, Xhelal Hasan Pira;Flora Nazif Sina; Zaim Hamit Rina; Shyqyrie Shaqir Xhani; Bashkim Ismail Zoku; Hanife Arif Laci; Rasim Destan Krrashi; Basri Tufik Farruku; Halim Hamdi Dabiçi; Skënder Sefer Kaleshi; Dine Rufat Sina; Flutur Mud Lala; Besa Trepça Hoxha, Mësuese; Fetie Musa Voka; Gezim Hamit Sina, Elez Balliu, Mësues Biologjie; Gëzim Haxhi Çiku, Nxënës, ; Selim Hidër Rama; Ilmi Daut Kaleshi; Fisnik Shaban Meziu; Selman Tahir Mëziu; Sahit Sefer Rama; Kujtim Selman Xhani; Skënder Zenel Leka; Beqir Hysni Mikli; Barie Mane Prençi; Sulltan Bajram Prençi; Lirie Halit Mikli; Ramie Selim Prençi; Nazmie Xhemal Mikli; Drita Ahmet Lala; Ramazan Abaz Xhani; Munir Idris Sina; Ismet Islam Faruku; Hysni Destan Krrashi.

Rruga e Arbërit nr. 190

Veçanti në ndarjet kanunore në Dibër

Nga **HAKI PËRNEZHA**

(vijon nga numri i kaluar)

Dikush e këshilloi të kërkonte ndihmë te Lusha në Arras si njëri ndër pleqtë e njohur në Dibër për zgjidhjet kanunore që kishte dhënë. Një ditë prej ditësh ai trokiti në derë të Lushës dhe ia tregoi gjithë historinë. Lusha e merr përsipër dhe i caktoi ditën dhe kushtet për zhvillimin e "gjyqit". Në atë ditë do të ishin prezentë njerëzit e afërt të të dyja grave. Dita erdhi. Në shtëpinë e fshatarit atë ditë përveç miqve (të afërmit e dy grave) ishin edhe disa miq të zotit të shtëpisë. Pas pak u dukën edhe tre veta hipur në kuaj. Ishte Plaku i kanunit bashkë me dy stërpleqë të konakut të tij. Hynë brenda dhe pas kafesë Plaku kërkoi të «marrë» në pyetje dy gratë. Në fillim ai thirri të vjetrën e cila u ul përballë «trupës" gjykuese, në mes të dhomës ndërsa djali i vogël qëndronte afër të atit pa kuptuar asgjë se c'po ndodhte. -Kush e ka lindë atë fëmijë, pyeti Plaku. Gruaja e vjetër turfulloi dhe tha - unë e kam lindë, e kam mbajt nëntë muaj në bark, e dinë gjithë katundi. Plaku urdhëroi gruan të shmanget pak e të qëndrojë aty përballë trupës gjyqsore. Pas kësaj u thirr gruaja e dytë, e reja. Edhe ajo zuri vend para "gjyqtarve". Sërish Plaku pyeti- Kush e ka lindë atë fëmijë? Gruaja e re e ndrojtur me gjysmë zëri tha:-unë, dhe nga sytë i rridhnin lot. Plaku i drejtohet babit të djalit dhe i thotë: -Më sill një këmesë dhe një grihën të mirë. Kur kmesa dhe grihni erdhën, plaku ia dha stërplakut duke i thënë : -Mprefe mirë këtë kmesë se do e presim këtë fëmijë përgjysë, tua ndajmë dy grave... Stërplaku filloi të mprehte kmesën dhe herëpashere e provonte me dorë. Të gjithë pjesëmarrësit kishin shtangë nga ato fjalë që tha plaku. Pas pak plaku mori kmesën dhe pasi u sigurua se ishte mpreh mjaftueshëm iu drejtua një të riu aty me të cilin plaku kishte biseduar më parë për rolin që ai do të luante: - hajde ti se je më i fortë dhe kur të të them unë, këta të dy stërpleqtë do e kapin djalin e vogël njëri për njërës këmbë e tjetri për tjetrës dhe ti do i biesh ta presësh djalin e vogël, por ta presësh drejt që çdo njëra prej këtyre grave të marrë pjesën e vetë në mënyrë të barabartë...!!! Fjalët patën efekt pasi filluan pështpëritjet nga gjithë pjesëmarrësit. Gruaja e vjetër qëndronte e qetë ndërsa e reja ishte mjaft e shqetësuar. Dy stërpleqtë ngrihen kapin djalin për krahësh dhe vihen në mes të dhomës ndërsa i riu me kmesë në dorë qëndronte para trupës gjyqësore gati për të vepruar . Plaku tha: -para se ta presim këtë djalë do ti pyes edhe njëherë gratë. Iu drejtua gruas së vjetër: - A ta pres djalin që të merrni secila gjysmën? I menjëhershëm ishte përgjigja e saj- Po, vec preje ...!!! Plaku iu drejtua gruas tjetër: A ta presim djalin që të merrni secila gjysmën? Gruaja e re e trembur shumë se vërtetë ato do e prisnin fëmijën tha: Jooo mos e prisni, le ta mbajë ajo (e vjetra) vec djali të jetojë. Atëhere Plaku u ngrit në këmbë dhe kapi djalin me dorë dhe tha: -Këtë fëmijë e ka lindë kjo grua. Merre fëmijët dhe e gëzofsh. Pastaj i drejtohet gruas së vjetër: -Ti nuk je nënë por as njeri nuk je! Pac faqen e zezë! Njerzit e gruas së vjetër nuk pritën ma por mblodhën cigaret dhe dolën duke marrë me vete edhe motrën e tyre e cila nuk kish më vend në atë shtepi.

IV. PAJTIM, JA ME DALË FARE!

E dalmja fare ishte njëra nga mënyrat shtrënguese që ka funksionuar në Dibër të Poshtme, për të detyruar palët e konfliktuara të shkojnë drejt pajtimit.

(Vijon në faqen 19)

Historiani dhe shkrimtari



Nga **XHAFER MARTINI**

Që të njihet një popull ose një epokë, në asnjë mënyrë nuk mjafton të lexohen vetëm historitë e shkruara për të. As historia e Francës në dhjetë vëllime nuk do na japë një pamje të qartë për jetën e shoqërisë franceze pa romanet e Balzakut.
Pra bashkë me të ne mund të themi se e njohim shoqërinë franceze të shekullit XIX

Është një debat i hershëm dhe vazhdimisht ripërtërihet: kush e përshkruan jetën më mirë: historiani, apo shkrimtari? E shtruar kështu në formë pyetjeje, mbase nuk do të tingëllonte dhe shumë e drejtë, realiste, për arsye se historiani dhe shkrimtari janë profesione të ndryshme, se historia dhe letërsia janë disiplina të ndryshme që kanë mënyrat e veta për pasqyrimin e epokave të ndryshme. Megjithatë, e përbashkëta e tyre qëndron në faktin që këto, si historia ashtu edhe letërsia, kanë një objekt - njeriun. Po do të ishim prapë disi të pasaktë nëse thonim për të dyja- njeriun. Historia ka njerëzimin, pra njerëzit në përgjithësi, ngjarje, luftra dhe përpjekje të mëdha , kurse letërsia është ajo që ka si objekt vetëm njeriun, fatin e tij individual ose familjar, është letërsia ajo që hyn thellë, në psikologjinë e protagonistëve dhe të heronjve dhe bën atje zbulime dhe zhbirime të natyrave të ndryshe.

Ka dijetarë që pohojnë të njëjtën gjë, por me forcë dhe me kompetencë:

"Që të njihet një popull ose një epokë, në asnjë mënyrë nuk mjafton të lexohen vetëm historitë e shkruara për të. As historia e Francës në dhjetë vëllime nuk do na japë një pamje të qartë për jetën e shoqërisë franceze pa romanet e Balzakut. Pra bashkë me të ne mund të themi se e njohim shoqërinë franceze të shekullit XIX.

Historitë neve na njohin me ngjarjet, kurse romanet, eposet, (epet) poezitë, tregimet, legjendat dhe përrallat na tregojnë për jetën e një njeriu për atë që ka ndodhur me të vërtetë. Njëra është historia e jashtme, tjetra është historia e

Historitë neve na njohin me ngjarjet, kurse romanet, eposet, (epet) poezitë, tregimet, legjendat dhe përrallat na tregojnë për jetën e një njeriu për atë që ka ndodhur me të vërtetë. Njëra është historia e jashtme, tjetra është historia e brendshme.

brendshme. Historia e jashtme më tepër është e pamjaftueshme, sepse më shumë flet për mbretërit dhe kralat dhe për ngjarjet e një grupi të kufizuar njerëzish, për oborrtarët dhe të tjerët rreth tyre. Prandaj unë nuk mund të them se e njoh historinë e një populli në qoftë se e di ç'mbretër ka pasur, ç'luftra ka bërë, ku ka fituar dhe ku ka humbur. Për më tepër unë nuk mund të them se njoh atë popull edhe sikur të njohë ligjshmërinë dhe kulturën e tij. Unë duhet të di se si ka jetuar individi në shtëpinë e vet, ç'marrëdhënie ka pasur me gruan e vet, me fëmijët, me shërbëtorët, me qeverinë. Kur harmonizohen këto dy pamje(e jashtmja dhe e brendshmja), unë mund të them se e njoh në një farë mase një popull dhe të kalurën e tij." (Izetbegoviç: 2016: 126)

"Historia merret me ngjarjet, kurse romani me përjetimet. Subjekti i historisë është populli, shoqëria, bashkësia apo grupi; subjekti i romanit është personazhi. Historia do të ishte e keqe, në qoftë se do të shkruhej në bazë të romaneve ose të eposit, gjithashtu njohja jonë e plotë për një epokë do të ishte e pamundur pa romanin ose poezinë e asaj kohe. Sadoqë letërsia i tregon ngjarjet historike jo saktë, ajo është e vërtetë në vështrimin e ngjyrimin lokal, të klimës shoqërore, frymë së kohës, të ndjenjës dhe përjetimit subjektiv të ndonjë ngjarjeje historike, të cilën historia e ka regjistruar me saktësi, por nga jashtë. Prandaj t'ua lëmë historinë historianëve, ndërsa jetën poetëve. Këta të fundit, për kohën e kaluar do të na tregojnë shumë të vërteta të cilat në histori nuk mund t'i gjemë." (Izetbegovç: 2016: 52)

Kështu si shembull, nga historia jonë ne e dimë dëshirën që kishte Gjon Kastrioti, i ati i Skënderbeut, që t'i ktheheshin në Shqipëri katër djemtë që i la peng tek sulltani dhe të ndrinte jo vetëm shtëpia e tij, por gjithë Shqipëria, siç ndodhi më vonë kur u kthye Gjergji. Të gjitha ne këto i dimë, por, kur poeti Naim Frashëri tregon e vajton me dhimbje:

"U ngrit Fati i Shqipërisë
Si i vdekuri nga varri
Mori udhën' e Azisë
Duke rendur si i marri..."

emoconohemi tepër dhe tabloja e njeriut që ecën majë kalit nuk na harrohet kurrë.

Ose të marrim si shembull, Napoleonin, figurë shumë e njohur, për të cilin janë shkruar shumë libra, monografi. Historianët e japin me data dhe me fakte jetën e tij që kur lindi e derisa vdiq. Njeri prej tyre, nga më skrupulozët, është Tarle. Ai sikur ka jetuar bashkë me Napoleonin dhe ka shënuar gjithçka nga jeta e tij. Megjithatë, unë për Napoleonin kam mësuar më shumë nga monografia e Cvajgut se sa nga vepra e Tarles dhe e historianëve të tjerë. Kjo për vetë faktin se Cvajgu na e jep Napoleonin edhe si njeri, me dilemat e tij, me ato brerje shpirti dhe ndërgjegjjeje, me atë ambicie dhe vendosmëri për ta realizuar atë, me dashurinë dhe zhgënjime që kishte ai për femrat me të cilat u lidh, në marrëdhëniet me pjesëtarët e familjes etj. Vetëm kur mësojmë këto gjëra intime ne mësojmë kush ishte në të vërtetë Napoleoni. Po kështu për një njeri tjetër të madh të historisë, për Çezarin, më shumë kam mësuar nga tragjedia "Jul Cezari" e Shekspirit se sa nga gjithë historitë e shkruar për Romën e lashtë. Ose meqë jemi tek Shekspiri, ç'do të ishte historia e shekullit XVII të Anglisë pa pasur Shekspirin? Po kështu ç'do të ishte Skënderbeu pa atë veshje që i bën populli me kujtime, me legjenda, me mite, me këngë, me të gjitha format e artit popullor? Po ta zhveshnim nga këto, do të bënim të njejtën gjë sikur një peme t'ia hiqnim lëkurën nga trungu deri në majë, t'i hiqnim klorofilin dhe lëngun jetësor dhe ajo do të thahej. Prandaj përpjekja për ta çmitizuar Skënderbeun është përpjekje për t'ia hequr atij mbështetjen popullore jo vetëm në fushat e betejës sa qe gjallë, por edhe në artin e tij pas vdekjes. Me të drejtë Filip Hauard ka thënë: "Pjesa më e madhe e historisë është dokumentimi i triumfeve, shkatërrimeve dhe budallallëqeve të personaliteteve më të lartë. Ajo që mbetet e paplotësuar në të, si një vrimë e zezë, është jeta e burrave dhe e grave të heshtura, të palavdishme, që nuk kanë bërë zhurmë për vete në këtë botë".

Kam lexuar shumë libra historikë për Gjermaninë dhe pikërisht për atë periudhë që po përgatitej fashizmi për të ardhur në pushtet. Sigurisht që kam mësuar prej tyre, por mësimin më të vlefshëm e mora nga romani "Ora e gjermanishtes" i Zigfrid Lenc, në themel të të cilit është të kuptuarit e detyrës dhe që gjermanët e asaj kohe ose nuk e kuptuan atë - për ta dështuar nazizmin që në vezë- ose nuk e bënë këtë nga frika dhe indiferentizmi.

Romani "Ora e gjermanishtes" fillon me një detyrë konkrete mësimore të një nxënësi shkolle, në një kënd të Gjermanisë, por, ndërkohë, shkrimtari, si mjeshtër i madh që është, krahas detyrës së këtij nxënësi që po zgjaste pambarim, me vite, jep se edhe populli gjerman dhe inteligjenca e tij janë para një detyre të madhe- të pengojnë ardhjen e nazizmit në pushtet.

Detyra nuk u krye dhe nazizmi dhe Hilteri bënë atë që tashmë dihet nga historia.

prozë



TAKIMI

Tregim nga Agron Tufa

Më qëlloi (krejt papritmas) me ndejtë me të... Më thanë të drejtën i druhesha atij takimi, siç na ndodh kur ndeshim përballë një shok ushtrie mbas 30 e kusur vitesh, ndonëse koha e kalueme bashkë ka qenë e pakrahasueshme me askënd tjetër për sinqeritetin, ngushëllimet, trishtimin dhe sfilitjet; për zhgënjimet dhe hidhësitë e një jete pa shpresa, përkundër andrrimeve nën qiellin e natës dyst me yje që shkëlqejnë e kputen honeve të errët; për ngashërimat e heshtuna me kokën e mbulueme ndën batanijet e ashpra ushtarake… Po, por nuk mjaftuakan as këto, se na, prapëseprapë, i bishtnojmë takimit: kthejmë kokën mënjanë, kinse nuk e vemë oroe, kinse jemi t'përpimë prej punës, ndërkohë që vigjëlojmë veshëcurrekë, derisa momenti i takimit të jetë shmangë. Atëherë kthejmë të lehtësuem prapë në udhën tonë.

Se, sigurisht, nuk jemi ma të njajtët, me gjasë, as unë, as ai… Jeta që s'len gur mbi gur pa e ndryshue, ka ba tashma të vetën... Madje ka gjasë, që mbas kaq kohe, na ka gjasë me folë në gjuhë të ndryshme me njani-tjetrit. A ka gja ma t'pikëllueshme se tmerri i moskuptimit? Të qenët i pakuptuem në këtë botë t'randume me shenja?

Por në një qoshk të botës paska qenë parathanë që ernat e vetmisë t'na përballnin pashmangshëm. Isha po ai dhe ai - ishte po unë. Vetëmse fytyrat tona shprehnin ndryshim të dukshëm. Koha që len gjurmët e veta me hartën e brengave, me pakënaqësitë dhe me pengjet e papërmbushuna, atë s'e kishte prekë as përskej: fytyrë rioshe me dy sy shkëlqarë, t'uritun për andrra, njëlloj si atëherë, kur ishim bashkë, para tridhjetë e kusur motesh.

- Si i lodhun më ngjan, si i prishtë, - thotë tue e anue kryet për me më pa n'profil.

- Jam mirë, - ia kthej, - jam mirë, po aq sa ndjehesh mirë dhe ti.

- Unë nuk ndjehem hiç mirë… Nga e gjete se jam mirë? Ku e sheh të mirën teme? – thotë, tue ia qëllue taktikës sime për me i ba lak kuvendimit. Andaj më gozhdon me pyetje:

- Çdo me thanë mirë, simbas teje? Mos ndoshta ti quen mirë atë kohë kur ishim bashkë në kazermë dhe qanim netëve tue ba shërbim roje në kodrat me ullishta?

- Kanë kalue mote dhe nuk them se ishim mirë, por kishim andrrat, - i them. – Të kujtohet Paulini? Vrau veten në vendrojë me një të shkrepme… Pati mbështetë mjekrrën në grykën e pushkës dhe plumbi i kishte dalë përmbas rrashtet. Kishte shpërthye pranvera, nëse e mban mend dhe rrjedha e përronit aty ndanë nuk dëgjohej, por dukej prej rrëkesë së luleshegëve, që skuqte në një vazhdë të vetme drejt Drinit. Na qamë atëbotë për Paulnin që i dha fund vedit: aq i ri, aq i gjatë, aq i pashëm, aq gazmor dhe nuk na besohej, se si mund të ikte ashtu, ai deli djalë, pa asnji shkak të dukshëm, kur tan jetën e kishte përpara e mundej me u ba çka t'ia kishte anda. Nuk e pritshim prej tij…

- Lene Paulinin ti, mos m'iu shmang kuvendimit, - tha, tue m'këputë pa pikë taktit, mandej fill shtoi: - Nuk kemi qa për Paulinin atëbotë, or pallosh groshe…

- Thue ti…?

- As ti e as unë… Paulini ishte thjesht nji shkas. Nji ndërmendje. Nji qortim për mungesën e guximit dhe burrnisë që ti nuk e pate… me e ba të njajtën gja dhe pse e shestoje kahmoti. Po thuej lavdi Zotit që u gjet Paulini…

- Qe, tash po vret të trasha mbarë e prapë e nuk din çka po qet goje… Ç'pate? Ti ma njef guximin… si mundesh me e vu në dyshim?

- Nuk ke qa për Paulin të thashë, mos t'rrejë mendja. Kaq.

- E ti? Ti vetë, për kënd e kishe vajin? Dro për vajzën e komandantit që humbi garën e vrapimit? Se ti i pate ba hartimin, me sa po më bie ndërmend…

- S'po them as për vedi, se po qaja për Paulinin e shkretë, jo…

- A ban me ditë, për kand? Për duditë e prendverës dro?

- Leni mahitë! Vajin tem e kisha për ty! Për diç që po të piqej në mendje, që po t'avitej tinëzash e që unë nuk kisha fuqi me e ndalë, derisa ndodhi pashmangshëm nji mesnate, në kapanonin e braktisun. Pa krismë… me jastëk. Pabesisht. Në kulmin e gjumit të pafajshëm. Bash ditën që prisnim lirimin. Ma qite për dritareje kurmin, kinse të pajetë, e mandej, dite me e heqë zvarrë e me e fshehë në prronin me shegë të egra, tashma të pjekuna. Askujt s'i ra në sy mungesa jeme n'atë tollovi festive, ku ushtarë e komandanta ishin të zanun me ndamje, përqafime dhe zhurmën e kamionave ushtarakë, që prisnin të mbusheshin me ushtarët e liruem në oborrin e repartit. I kishe ba hesapet mirë, si dhelpën vjeshte, me e fshehë vrasën tande mes haresë e galdimit të përcjelljes, nën tingujt e harmonikës. Pse hesht? A mos po rrej? Mandej dihet, u ktheve pa mue… Pse s'e thue? Kjo asht arsyeja pse më bishtnon e ndërron rrugë? Ke bash fytyrën e atij që nuk guxon me u përballë.

- Qe pra… a po përballemi? - qita e thashë, tue e pa drejtazi në bebe të synit. – Po përballemi, ani, por ta dijsha, sak kam qenë tue ndërrue udhë…

- Ta dijshe? Ta dijshe çfarë?

- Që je kaq budallë. Ke qenë qysh atëherë, a po tani je ba i marrë?

- Por nuk asht kjo arsyeja që të shtyu me më hekë qafe ashtu, si brac, në mesnatë, me jastëk në fytyrë, në pikun e gjumit që e kput njérin si deka…

- Në kjoftë se ty t'ashtë ulë galuc ndër tru se të paskam hjekë qafe në atë mënyrë, besa boll mirë paskam ba, por s'po ma spiegon nji gja: pse hem të paskam mbytë e hem më del përpara si fanti spathi, tue më broçkullisë nji thes me marrina?

- Ti veçse kujtove se më hoqe qafe… Po siç e sheh, unë kam jetën teme, ashtu siç deshe ti ta kem, ndamas prej tejet. Dhe a e di ç'ka? Po ta them nji gja të mbrame e po largohem kësaj radhe, se nuk po mundem ma gjatë me të durue: je ba i shëmtuet, i prishtë e i mërzitshëm, mu si një gazetë lokale e kohës sonë…

- Mirëmbetsh! – thotë e largohet për me hupë në turmën laramane të rrugës.

- Ani, prapë ka me kthye, kem me u ndeshë, - them, tue ngushëllue vedin, me nji përballje tjetër, për të cilën nuk jam krejt i sigurtë.

Bex, 1 nëntor, 2020

Promovohen dy libra te autorit Jahe Delia Selmani

Nga ILMI DERVISHI

Promovimi e librave "Andrra e qiellit do jetojë" poezi dhe "Radomira jonë" me reportazhe nga vendlindja, të poetit Jahe Delia Selmani, në mjediset e Muzeu Historik Kombëtar, u shndërrua në një festë të librit, ku krahas diskutimeve rreth librave, u lexuan poezi, u kënduan dhe këngë nga këngëtarë të njohur me tekste po nga Jahe Delia Selmani.

Për librin "Radomira jonë" botuar nga Botimet "M&B" foli shkrimtari Xhafer Martini, njëherësh dhe redaktor i librit. U fol rreth librit, por dhe për autorin e krijimtarinë e tij, ku shkrimtari solli para auditorit një fakt. Kur shkrimtari filloi mësues, e kishin emëruar në Radomirë, e nxënës në ciklin 8 vjeçar ishte Jahe Delia. Kur Jahe Delia mbaroi studimet, ai filloi si mësues dhe ishin kolegë me shkrimtarin dhe tani po bashkë me krijimtarinë e tyre.

Për librin me poezi "Andrra e qiellit do jetojë..", një libër me 207 faqe, foli poeti dhe studiuesi Qazim Shehu, ku evidentoi disa nga veçoritë artistike dhe arritjet nga libri i katërt i botuar.

Mësuesja poete Adriana Cili, një zë i bukur poetik nga Pogradeci i Lasgushit, përveç përshëndetjes, lexoi dhe poezi nga libri.

Moderatori i talentuar Defrim Methasani prezanton kryetarin e shoqatës "Korabi" z. Hasan Domi, përveç fjalës së tij për librat dhe autorin i dha "Mirënjohje" për kontributin e dhënë me botime dhe në shoqatën "Korabi"

Ndërsa moderatori Defrim Methasani po prezanton dy bilbilat e këngës të zonës Myfterim Kupa e Fatmir Daku, me një karrierë mbi 40 vjeçare në këngë shkon vetë në sallë dhe shoqëron drejt skenës këngëtaret, "A e di" Myfterim Kupa, siç e ka cilësua në reportazhet e tij autori Jahe Delia.


Salla e shoqëroi gjatë me duartrokitje, para këngës, gjatë këngës dhe në mbarim të saj. Ishte një këngë e njohur, kënduar rreth viteve '80, me titull "Lule bjeshkatore", me tekst po të Jahe Delia Selmanit.

Edhe këngëtarët Musa Dauti e Arif Madana kënduan disa kënge me tekst të Jahe Delisë.

Të pranishëm në sallë ishin miq e dashamirës të autorit, personalitete të artit e kulturës, poetë, gazetarë e botues. S'kishte si të mos ishte dhe ikona e muzikës popullore Lirie Rasha e Sajhe Poleshi. Emocione solli në auditor përshëndetja nga vendi i këngëtares Lirie Rasha, ku këndoi lajv, posaçërisht për auditorin këngën "Oj Fusha e Korabit" dhe "Cuca e Radomirës".


Fjalëpak, emocione e duartrokitje shumë pati fjala e autorit Jahe Delia Selmani dhe kur moderatori mbushi podiumin me nipa e mbesa të autorit, mbushur duart plot me tufa lulesh, mes tyre dhe mbesa, vajza e djalit, pilotit Forian Delia, Dëshmor i Atdheut. Në vendlindje ka një rrugë "Rruga Florian Delia", por do perifrazoja nga vargjet e poetit I. Cani ku shkruan... të gjitha rrugët e qiellit kanë emrin e tij...

Në mbyllje u dha një koktej, ku u shkëmbyen libra, u bënë fotografi dhe duke i uruar shëndet e krijimtari njëri-tjetrit!



Poezia si shprehësi lirike dhe bartëse e unit origjinal

Nga **QAZIM D. SHEHU**



Jaho Delia, prej kohësh e ka spikatur veten si poet i afirmuar me zërin e tij origjinal, duke na dhënë një poezi të ngrohtë plot emocione njerëzore, me një verb të thjeshtë ritmik e mjaft të pëlqyeshëm. Në librin e tij të ri, ai i ngrë më lart këto cilësi dhe cilido që do ta lexojë këtë libër do të mbetet i kënaqur, do të ndjejë jehonën e historisë, këngët për trimat e motit, këngët e reja elegjiake për të birin e Jahos, Floranin, Dëshmor i Atdheut, këngët për njerëz të zakonshëm plot virtyte e njëherit edhe një lirikë që thuret përmes vargjeve të çiltëra e me finesë.Si poet, ai qëndron mes rapsodisë dhe lirikës dhe e ke të vështira t`i ndash këto dy forma të të shprehuri gjuhësor , ndonëse ato kanë një ndarje të mirëfilltë.

Rapsodia e Jahos, edhe pse siç e ka natyrë rapsodia, zotërohet nga toni epik-heroik, merr një ndryshim dhe përpunim të rëndësishëm ndjesor; në të, krahas tonit epik shprehet dashuria dhe malli për njeriun , për kohërat, adhurimi dhe respekti për aktet trimërore, të gjitha këto të kaluara nëpër filtrin e një shpirti të ndjeshëm.Kjo ndodh , se heronjtë apo njerëzit e zakonshëm, që u bënë emra të nderuar dhe mbetën në kujtesën popullore ishin njerëz të mirë, të dashur, paqësorë, që e donin jetën dhe, për ta mbrojtur atë, u ngritën e lufuan trimërisht kundër armiqve të ndryshëm që shkelën tokën shqiptare.

Jaho është nga Kala e Dodës, nga Radomira, Dibra, një zonë që mbart histori dhe kjo histori peshon sa malet e saj.I rritur në këtë trevë bujare e të mençur, ai nuk kishte sesi të mos mëkohej pikërisht me tamlin e rrëfenjave dhe legjendave, të mos i bridhte mendja pas trillit të historisë , të mos kapte pikërisht me imagjinatën e tij kohërat e shkuara, për të spikatur ato virtyte të të parëve.Kjo jo vetëm ndihet në poezinë e tij, por është një vlerë që ai e realizon përmes vargjeve plot vibrime të tonaliteteve të ndryshme, duke shprehur krenari e besim se fjala e tij do të dëgjohet.Elementi i këngës e bën poezinë e Jahos mjaft të konceptueshme dhe ndikuese.

Ai merr nga ajo vijën melodike dhe ritmin, nga melosi popullor merr çka më të mirë ai jo si një imitim të rëndomtë, por si një përthithje të tij.

Jo më kot, vargje të tilla të bëjnë për vete:"Dibrën e burrnisë se ku është e dini/Roje i bën Korabi, hije i bën Drini/Rrënjët në histori, të futura thellë/Nëpër shekuj çdo gur kish kështjellë".

Por mund të vazhdojmë edhe me vargje të tjera, të cilat shprehin ndjenjën e adhurimit dhe shpalosin bëmat e heronjve e luftëtarëve të lirisë:"Më njëzet, pa hy vjeshta/Nji gjamë përcjell bjeshka/Pse Korab kaq fort je nxi/Ku po ngjitet kjo urdi" ; vagje të tilla plot thirrma , apostrofa e tonalitete kushtruese , na afrojnë gjithnjë me vijën melodike të këngës.

Poezia është një pasyrim i dinjitetshëm historik i atyre ngjarjeve të rëndësishme kombëtare, ku zonat e para të ekspozuara ndaj armikut iu bënë barrierë atij, për të mos hyrë në thellësi të tokës shqiptare e këto ishin Dibra, Ploshtani, Kalisi, Luma , me trimat dhe luftëtarët zëmëdhenj, që meritojnë të gdhenden në vargje .

Jaho këndon natyrshëm.Bukur i flet ai me fjalë mallëngjyese djalit Floran:"-Fort me zor bllokun e mora/Për atë peng që në zemër kam/Kurrë ma fort nuk m`u drodh dora/Më fal për lotët, o Floran!".

Malli dhe dashuria për të birin përshkohen nga forca burrërore e një prindi zemërcopëtuar, i cili, përmes notave elegjiake, ngrë lart vlerat e rinisë dhe të bukurisë së të birit, që lartësohen me cilësitë e larta morale në shërbim të atdheut.Një poezi e bukur, prekëse dhe aq brishtë, delikate.

Edhe pse autori në rapsoditë e tij frymëzohet nga ngjarje reale, ai nuk është një përshkrues i thjeshtë i tyre. Ngjarja kalon në plan të dytë kur është fjala për të nxjerrë nga sharmi i saj frymën poetike, tharmin burrëror, për të përshkruar tiparet fizike e morale të protagonistëve.Dhe fjalët janë të zgjedhura, ndonëse herë- herë kemi ndonjë paradigmë apo stilemë të njohur, gjë e cila nuk mund të shmanget dot jashtë tipologjisë së rapsodisë.

Nuk mund të shmanget edhe një fjalor tipik si:urdi, allti, zanë, martinë, kollan, vatan, kuvend, tabe(llogore) etj, etj ; një fjalor që sjell ngjyrimet historike të kohës, të cilat poeti i njeh mirë dhe po aq me zotësi di t`i ndërfusë e t`i përcjellë përmes rrjedhës së frymëzimit poetik.

Poezia është e veçantë , sepse ajo ngrihet mbi besimin se kulte e vlerësime të tilla morale, dëshmojnë për qëndresën historike të një populli, i cili nuk iu nënshtrua të huajit dhe diti t`i vlerësojë ato deri me gjakun e vet.

Lirika e tij është një përvijim i atyre dridhjeve shpirtërore plot intonacione të buta dhe këndellëse.Ai ka shfrytëzuar mirë këngët e dasmave, psikologjinë e popullit në konceptimin e gëzimit të jetës, ka ditur dhe ia ka arritur që këto veçori t`i transfigurojë poetikisht dhe, po ashtu, t`i përcjellë në vargjet impresionuese.

Poezitë e tij lirike i kushtohen nënës, gruas, babait(Poezia" Mandolina e babait"), një dashurie të vjetër që rizgjohet dhe koha mundohet të mbushë mungesën, po kjo është e pamundur;kurbetit, natyrës, vjeshtës, qershisë, kohës që ikën, njeriut të sotëm, po me ato ndjenja si të njeriut të hershëm, dhe kësisoj ajo fiton një vlerë gjithëkohore.

Poeti ngrë në kultin e bukurisë cucën malësore me gjithë tiparet e bukura morale të saj, pa përjashtuar ato fizike , që ndërthuren dhe krijojnë harmoni.Si Çajupi , ai është konkret në këngëtimin e dashurisë, nuk lëngon prej mungesë së saj , edhe pse nuk i mungojnë nuancat e trishtimit prej kësaj mungese."A e ke lidh shaminë fitoz/Ti moj lulja e Serezit/Dimri i gjatë nuk u sos/Tue prit ditën e Shëngjergjit"...

A nuk ngjet kjo pyetje e shkëlqyer retorike me një këngë dasme në trevat tona kur gratë dhe vajzat i drejtohen nuses në valle dhe ajo kthen përgjigje vetëm me bukurinë e saj, pa fjalë.Këto intonime di t`i sjellë vetëm një poet i lidhur ngushtë dhe perceptues i natyrshëm i imazheve të tilla që sjell folku..

Motivi i vetmisë, i mungesës, shprehet në vargje të tilla si:"Sa herë letra të kam çue/s`mu përgjigje, pa u ndjerë/a do ketë pranverë për mue/A do shihemi ndonjëherë?"...e të tjera vargje vijnë si një klithmë e heshtur e një shpirti të ndjeshëm, që vuan nga mungesa, trilli, koha, vitet e njohjes që lënë vragë etj, etj.

Me mall e frymëzim i këndohet nënës, babait, gruas.Kuptohet , ato janë figura që nuk mund të mos u thuren vargje , veçse nga thellësia e shpirtit.Antologjike mbetet poezia "Mandolina e babait", ku përmes veglës muzikore poeti shkon te njeriu, përmes sendit të drunjtë sjell një refleks nderues ndjenjash:"Heshtjen mandolinës shpesh dua t`ia prish/Jap e marr t`ia shprush të lashta melodi/Ngazëllehem, dështoj, ia filloj sërish/Me ikjen e babait, iku e shenjta magji"...Kjo ta kujton një poezi të Martin Camajt:"Lahuta pushon në tra/Se nipat nuk dinë me i ra", ndonëse poezia e përmendur ka tjetër koncept ideor.

Si poet i peizazhit ai e sjell atë me ato detaje që vijnë përputhshëm dhe natyrshëm me ndjenjën, peizazhi është nuk vjen si dekor i thjeshtë, por funksionalizues:"I shoh të ronitura gjethet e vjeshtës/Si zogj të përhumbur po i degdis era/Venitur në stinë të tretë të jetës/Se u zverdh e blerta që u fali pranvera".Detaje filigramiste mund të gjesh gjithandej në këtë vëllim duke ia zbukuruar kostumin natyrës, por edhe gjendjeve poetike të subjektit lirik.

Shumë herë poeti e merr shtysën-frymëzuese nga ngjarje konkrete dhe, përmes tyre, ndërton minifabulën, ndaj vargu i tij është sintetik e aspak rrëfyes.

Poezia e këtij libri vjen nga zëri vetjak i një poeti në sendërtimin e saj organik plot rima, ritme me vetvetishmëri, larg çdo synimi për të shkruar diçka që të bjerë në sy dhe, për këtë shkak, ajo bie në sy dhe pëlqehet.Nuk ka gjë më të rëndësishme për një poet sesa të jetë vetvetja, të këndojë me zërin e tij dhe këtë e gjen te Jaho Delia Selmani, një poet i natyrshëm që i rri besnik tematikës dhe shtjellimit të saj, motiveve dhe procedeut krijues të vetvetes...

kujtime

Çmallesh kur kujton vitet...

Nga DESTAN RAMA

Në një ditë të bukur Maj po rrija në ballkonin e shtëpisë sime.Fshatin e kisha, si i thone fjalës, si në pëllëmbë të dorës . Kënaqesha kur shihja atë pamje të bukur natyrore të fshatit tim.Çdo gjë e ka mbuluar ngjyra jeshile.Në mes të këtij gjelbërimi dalloja"Rrugën e Arbërit"e cila bollëron mes për mes fshatit.Ajo s'rrinte e qetë për asnjë minut.Makinat vozitnin në të dy krahët e saj me shpejtësi për të shkuar në destinacionin e duhur.Fshatarët ngrihen herët, akoma pa dalë dielli, dhe shkojnë në parcelat e arës, të livadhit të jonxhës për të kryer punët e stinës.Tufa e deleve doli të kullosë në shpatin jugor të Temlës.Blegërimat e qingjave të vegjël të kombinuar me atë të deleve, si edhe bariu me shkopim në dorë që u prin, i japin fshatit një pamje magjike si për të thënë se këtu ka jetë ka gjallëri, ka traditë. Sa i bukur është fshati im!

Ky gjelbërim, këto lule të bukura e të shumëllojëshme, më ngacmuan kujtesën time dhe më cuan në ato vite të largëta të shkollës fillore.Kishte ardhur momenti të testoja kujtesën.Ajo sikur lozte me mua;herë afrohej, herë largohej, ndonjëherë edhe bllokohej.

Doja t'i kujtoja ato vite, pasi për ta kisha shumë nostalgji, kisha shumë mall.Këta ishin vitet e para që na hapën udhën e rrugëtimit shkollor. Ata na çelën sytë, na hapën zemrën, na çelën shpirtin e dashurisë për mësimin.Ne atëherë ishim vetëm 7-10 vjec, fëmijë me mendje të kthjellët që prisnin të thithnin në trurin tonë të vogël çdo fjalë të mësuesit, dhe të lexonim me kureshtje çdo fjalë në faqet e librit.E filluam klasën e parë unë Destani, Fadili, Sheqerja, Fiqiriu, Hazbija, Fatimja, Hysniu Bashkimi, Kadifja, Lulja.

Çdo ditë mblidheshim në cepin e bahçes, ngjitur me oborrin e shkollës, për të rikujtuar mësimet që kishim atë ditë.Kontrollonim pastërtinë, detyrat e shtëpise dhe mjetet mësimore.Kujdestari i klasës i raportonte mësuesit pë çdo gjë. Tingujt e ziles na ftonin për të hyrë në klasë, në mësim.Mezi e prisnim këtë moment. Secili kërkonte të lexonte i pari abetaren, të mblidhte, të zbriste, të shumëzonte e pjestonte numrat në orën e aritmetikës, apo të zgjidhte problemën.Po kështu bënim në lëndën e historisë, të dituri natyrës, të vizatimit, këngës, punëdorës, edukim fizik dhe të asaj që ne e quanim më të bukurën, Bukurshkrimi.

Mjaft mbresëlënëse dhe që më ka mbetur pa u fshirë nga kujtesa ime ishte ajo ditë fundmaji që do të zhvillonim provimin në klasën e katërt. Në provim merrnin pjesë edhe nxënësit e shkollës Godvi.Ishte një biçim gare që zhvillohej në heshtje.

I merrnim pyetjet e provimit në fillim të muajt maji.I studionim ato, konsultoheshim me mësuesit për çdo paqartësi.

I kam mësuar të gjitha pyetjet e provimit, -thoshte Fadili, Sheqerja, Lulja etj.Nja dy a tri pyetje nuk i kam të qarta, ishalla s'më bien mua, lutej Fiqiriu, Fatimja...

Ditën e provimit visheshim me rrobat më të bukura që kishim në atë kohë.Mblidhnim lulet më të bukura në atë gjelbërimin pranveror.I lidhnim, i bënim tufë dhe i vendosnim në një kavanoz në tavolinë, përpara komisionit të provimit.Secili nga ne kërkonte të përgjigjej sa më mirë dhe më saktë.Në fund të provimit ne ndiheshim të kënaqur, pasi kishim marrë produktin e punës sonë, duke kaluar të gjithë klasën e katërt.

Por nuk mund të jemi sot, këtu ku jemi;mësues, inxhinierë, economist, mjek etj, pa ata që quhen'Mësues'.I kujtoj si të isha në ato vite mësuesit e mi të dashur.Jam mirënjohës dhe gjithmonë dashamirës për ta. E si të mos kujtosh mësuese Hbibe Shehun(Dervishi), ose"Mimozën e Grykës së Madhe".Qe e para që theu normat zakonore në trevën tonë, të cilat shtypnin të drejtat e vajzave e të grave ndaj me të drejtë u quajt Mimoza e Grykës së Madhe. I pëlqente shumë profesioni i mësueses, ndaj vazhdoi shkollën dhe ia doli.Erdhi mësuese në shkollën tonë. Një mësuese e kompletuar me njohuritë e sakta metodiko-shkencore.Ajo la mbresa të thella me punën dhe sjelljen e saj tek ne. Thuajse çdo ditë që vinte në këmbë nga Krajka, ne i dilnim përpara në oborrin e shkollës dhe e përshëndesnim. Ajo na përshëndeste me dashurinë e motrrës, të nënës dhe të mësues, duke na ledhatuar flokët dhe përkëdhelur faqet. Na merrte përdore dhe bashkë me të shkonim në klasë për të filluar mësimin.

Po këtë dashuri dhe respekt ruan kjo mësuese edhe në vitet kur ne u rritëm, u shkolluam dhe një pjesë u bënë kolegë me të.Dhe ne sot ia shpërblejmë me fjalën''Mësuese".

Kujtoj me dashuri dhe mall mësues Isuf Fikun.Zëri i tij kumbues edhe sot më vjen në vesh.Shkrihej në të shpjeguar, kërkonte shumë, këmbëngulte në të interpretuarit e mësimit



Shkolla fillore Peladhi

nga nxenësit.Kërkonte vazhdimimisht rregull e disiplinë tek ne nxënësit.Na mbante afër, na edukonte, si të ishim fëmijet e tij. Ishte njeri i thjeshtë, modest, i zgjuar, sakrifikues që i jepnin vërtet vlera njerëzore.Unë në këtë shkrim dua ta kujtoj me shprehjen popullore"I vdekuri kujtohet për çka bërë nderohet".

Mësuesi Fadil Shehu gjithmonë i dashur me ne gojëëmbël, fjalë pak e punë shumë.Me atë shkrimin e tij të bukur na bënte për vete, duke u bërë kështu model për ne.Motoja e punës sonë ishte:"Të shkruajmë edhe ne si mësues Fadili".Korrekt në punën e tij, i përpiktë në shpjegimin e mësimit, i ngrohtë në komunikim me nxënësit.Vitet kanë kaluar dhe ai është në pension, për ne është i paharruar dhe i nderuar.Me mall mirënjohje dhe respekt kujtoj mësues Aqif Muren.Ai ishte tamam shpirt njeriu.Ne nxënësve na donte shumë.Ai dinte te futej në botën shpirtërore të cdo nxënësi.Njihte dhe lidhej me prindërit tonë komunikonte me ta, diskutonte për problemet e mbarëvajtjes së mësimit, njihte shumë mirë gjendjen ekoniomike, kushtet e punës të familjes së cdo nxënësi.Ai ishte kërkues ndaj vetes, bënte përpjekje të vazhdueshme për ngritjen profesionale, gjë që e pasqyroi edhe në kualifikimin e mësuesve të trevës, si përgjegjës i saj.Sot ky mësues nuk rron më, por ka mbetur në mendje dhe zemrën tonë i paharruar.

Nuk mund të lë pa përmendur mësues Tahir Roçin.Shkurt ne i thirrnim mësues"Tiri".Kështu në pamje të jashtme dukej pak si i sertë, serioz, por në shpirt i dhembshur dhe dashamirës. Kur ndonjëri nga ne nuk e kishte bërë detyrën atë ditë ai i thoshte:Mirë, për sot të kam falur, por ruaju se mos na e bën rrugë.Nxënësi ndiente ngrohtësi në këtë moment dhe zotohej se nuk do ta përsëriste më.Me shumë takt e kulturë na qortonte kur shfaqnim ndonjë veprim jo të mirë, si fëmijë që ishim.

Kanë kalur vite e vite. Ai nuk jeton më, por mbeti për t'u kujtuar. Unë si ish-nxënës i kësaj shkolle çmallem sot kur i kujtoj ato vite, të cilët ikën shpejt si vesa para diellit.

Veçanti në ndarjet kanunore në Dibër

(Vijon nga faqja 16)

Kjo masë apo formë shtrënguese në Malet e Dibrës, është e njohur edhe pse janë të rralla rastet kur ajo është praktikuar pasi edhe kushtet në të cilat ajo duhej të zbatohej ishin specifike dhe të rënda. Sipas së drejtës zakonore, për zbatimin e kësaj praktike shtrënguese, palët e konfliktuara duhej të viheshin në të njëjtën dhomë dhe nuk dërgohej njeri për t'ju shërbyer, as për kafe e as për t'iu dhënë zjarr. Veç kësaj, tek dera ku hynin palët në gjak, viheshin dy djem të armatosur dhe porositeshin që në rast se dëgjoheshin krisma nga brenda dhomës, ata qëllonin mbi këdo që del jashtë.

Ndoshta prej shumë shekujsh kjo s'kishte ndodhë edhe pse njihej si "praktikë" për pajtim, por rrethanat dhe dështimi i të gjitha formave tjera, i kish detyruar krerët që ta aplikojnë. Ne po sjellim një rast ku kjo formë shtrëngese u përdorë pasi nuk dhanë rezultat përpjekjet, thirrjet, ndërmjetësimet për të pajtuar dy fise në një konflikt të gjatë, i cili sa më shumë zgjatej sillte vrasje të reja. Dy fise të mëdha në Çidhën, Sulet me Koltraket prej vitesh ishin në gjak dhe konflikti kish marrë 19 jetë njerëzish. Që të dy këto fise kishin jetuar gjatë me të*m'shel*a. Herë nga njëra palë e herë tjetra, vritej dikush dhe kështu vazhdonte prej gati 20 vitesh. Hera-herës, ishin krijuar mundësi për të ndërhyrë në pajtim por, ose nuk pranonte njëra palë, ose personat që merreshin me këtë problem nuk ishin gjithnjë ato të duhurit. Nuk kish mbetë plak a stërplak, që nuk ishte marrë me këtë punë. Lutjet e thirrjet për pajtim ishin të panumërta, por asgjë nuk ishte arritur. Përmasat e konfliktit nuk po zvogëloheshin asnjëherë dhe kjo ishte shqetësuese për gjithë krahinën.

U mendua se për dy fiset, Sulet e Koltraket, nuk kish mbetë rrugë tjetër, veçse me i vu para alternativës: *"O pajtohuni, o dilni fare"*. Ishte një mendim e më pas vendim i bluar e i peshuar shumë gjatë. Dhe rasti erdhi. Salë Demir Alia kish dasëm dhe, meqenëse i kishte miq të dy palët e konfliktuara, vendosi tu vërë kusht pajtimin. Salë Demir Alia e njihte situatën e gjaqeve mirë dhe e dinte se fisi i Sule kish për të marrë një gjak te Koltraket. Nuk kish kaluar shumë kohë, kur ishte plagosë djali i njërit prej burrave më të njohur në Çidhën, djali i Selman Sulit(Çuni). Salë Demiri shumë herë e kishte prekë hollë këtë problem në bisedë me Selman Sulin(Çunin), i cili ishte i një mendjeje me shumicën e njerëzve, se konflikti me Koltraket kishte kohë që nuk pëlqehej, që kritikohej dhe që duhej frenuar edhe pse atij i ishte plagosë djali dhe gjaku i tij ishte pa u marrë.

SalëDemiri(Alia) vendosi t'i kujtojë babait të të plagosurit, se në kanun, është edhe një normë, *që të detyron me u pajtue ose me dalë fare*. Dhe kështu bëri. Ai thirri Selman Sulin(Çunin) në shtëpi dhe larg e larg ia zuri bisedën. Selman Suli(Çuni) ishte mjaft i zgjuar dhe menjëherë e "thithi" muhabetin dhe u përgjigj: *"Unë e marr vesh se ç'thua ti, o Aga, edhe atë normën e detyrimit me u pajtue e di, por gjak i madh asht' derdhë dhe nuk është kollaj!"*Salë Demiri(Alia) ia kthen: *"Epo, punët e rënda e të vështira, prandaj janë lënë për burrat e qanun"*. Biseda mbaroi. Selman Suli(Çuni)shkon në shtëpi të vet e agai në të tijën. Pas pak kohësh, rasti e solli që Salë Demiri(Alia) kishte dasëm, ndaj vendosi që të bëjë hapin e rëndë e të vështirë, për t'i shtrënguar dy fiset e fuqishme të krahinës të pajtohen.

Agai i Çidhnës, i ftoi dy fiset që ishin në konflikt pasi i kish miq shtëpie. Dita e dasmës erdhi dhe në dhomën e caktuar nga Sali Demiri, në fillim hynë Sulet. Pas dy orësh erdhën edhe Koltraket. Edhe këto u pritën me nderime dhe i drejtuan për tek konaku, ku ndodheshin edhe hasmit e tyre, Sulet. Nuk kish burrë që nuk drithërohej nga kjo skenë. Koltraket hynë brenda në konak dhe habiten kur gjejnë aty hasmit e tyre! Nëkrye të vendit ishte Selman Suli(Çuni), i cili ia liron atë të parit të Koltrake. U ulën. Në njërën anë të dhomës u vendosën Sulet dhe në anën tjetër Koltraket, përballë njëri tjetrit, të gjithë hijerëndë e të gërthyer me armë. I pari e mori fjalën Selman Suli(Çuni), të cilit, Koltraket i kishin plagosë djalin para një viti. *-A je tu e pa se ç'nakanë ba, or Koltrak*?

- Po, iu përgjigj Koltraka, i cili për shkak se kish borxh me la, nuk fliste asnjëherë para Sulit. Përsëri foli Selman Suli(Çuni): *-Ene hyzmetçi nuk na kanë pru këtu e kjo do të thotë që na, ja duhet me upajtue, ja duhet me dalë fare*.

-Të kam të parë, or Selman! -ia ktheu Koltraka*, - unë rri ku të më vesh ti!*

Biseda ishte e rëndë, por burrat si Selman Suli(Çuni), rrallë i vijnë krahinës.

- Unë mendoj që të caktojmë një që të na japë zjarm e kafe e pastaj dy prej të mijëve e dy prej tuve të barazojnë gjaçet, - përfundoi Selman Suli(Çuni).

Ashtu u bë, dolën katër veta dhe u ulën në fund të dhomës së madhe të Alie e filluan të numërojnë gjaçet, ndërkohë që Selman Suli(Çuni) atë ditë do tëkryente një akt të lartë burrëror. Ai e njihte mirëdjaloshin e Koltrake që i kish plagosur djalin, i cili ishte ulur në fund të dhomës dhe sytë nuk i ngrinte fare. Pinte duhan mendueshëm dhe mallkonte veten për veprimin që kish bërë një vit më parë. Përsëri foli Selman Suli(Çuni):

- Unë them që ai djali në fund të dhomës të na bëjë hysmet, - dhe gishtin e drejtoi pikërisht tek ai që i kish plagosë djalin dhe vazhdoi: *-Ngreu e na jep nji zjarm!* Koltraka i ri brofi në këmbë, kapi mashën që ishte pranë votrës, mori një poptesh dushku nga zjarri dhe iu afrua Selman Suli(Çunit), i cili kish vënë llullën në gojë dhe priste zjarrin. Djali iu afrua me mashën në njërën dorë e dorën tjetër në zemër. Askush nuk fliste, tensioni ishte shumë i lartë. Të gjithë i kishin armët në brez dhe askush nuk e dinte se ç'bluante në mendje Selman Suli(Çuni). Po sikur...Koltraka i vuri zjarrin në llullë dhe, kur po largohej, plaku i Sule ngriti sytë dhe iu drejtua djalit:

- Ti je ai që ke plagosur djalin tim?

–Po, ia ktheu Koltraka, - dhe drejtoi trupin e qëndroi ashtu më këmbë në mes të dhomës.

- Unë ta kam falë gjakun e djalit tim, prandaj afroju e më jep dorën!

Djaloshi i Koltrake shtangu dhe masha që pati në dorë i ra në mutaf. Ai iu afrua Selman Sulit(Çunit), e përqafoi dhe sytë i kish plot me lot. Ai mallkonte me shpirt atë ditë që ngriti dorën e shtiu mbi djalin e këtij plaku të urtë. Ky veprime ç'tensionoi situatën dhe ndërkohë grupi i gjaqeve nga fundi i dhomës njoftoi se tani jemi baras. (Të gjithë e dinin se duhej të falej plagosja e djalit të Selman Sulit(Çunit) që të barazoheshin gjaqet.) Pas këtij momenti në dhomë vërshuan shumë njerëz, miq e të ftuar të cilët përgëzonin Selman Sulin dhe gjithë të tjerët për pajtimin e këtij konflikti kaq të stërzgjatur mes dy fiseve të zëshëm në Dibër.

REFERENCA

17. Nga FGJSH, shek/e-ja, enë druri

18. Intervistë e vitit 2020, me Haki Manukën

Në promovimin e librit "Magjia e fjalës", vlerësohet nga Akademia Shqiptaro-amerikane e Shkencave dhe Arteve, me seli në Nju Jork-SHBA

"Akademik", titull i merituar për shkrimtarin dhe publicistin Halil Rama

Nga **EGLANTINA ALLIAJ**

Pasi ka marrë më parë titujt "Mjeshtër i Madh" nga Presidenti i Republikës (Dekret Nr.11724, datë 17.09.2020), avokat (Licensë nr.7979, datë 31.10.2014) dhe "Amabasador për paqe" (Dhënë nga Federata Botërore e Paqes Universale), shkrimtari dhe publicisti i njohur Halil Rama, më 21 qershor përjetoi emocionin e marrjes së titullit "akademik", dhënë nga Bordi i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me qendër në Nju Jork-SHBA.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast në Bibliotekën e Akademisë së Shkencave në Tiranë, me praninë e më shumë se 50 personaliteve akademike, të letrave, artit e kulturës, Kryetari i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me qendër në Nju Jork, Prof.Dr.Skënder Kodra, ndërsa i ka dhënë Çertifikatën e anëtarësimit dhe të titullit "akadamik" ka vlerësuar veprën shumëdimensionale të Halil Ramës, të identifikuar në21 libra të botuar prej tij në harkun kohor të dy dekadave, të mirëpritur nga lexuesi dhe të promovuar bujshëm, si edhe gjashtë dokumentarët televizivë që mbajnë autorësinë e tij.


NË SHËRBIM TË LIBRIT NË GJUHËN SHQIPE

Për librin "Magjia e fjalës" botim i UET PRESS (Universiteti Europian i Tiranës), foli poeti, prozatori, analisti dhe politologu Preç Zogaj, i cili ka bërë dhe parathënien e këtij libri.Ndër të tjera Zogaj tha se "Të lexuarit për Halilin nuk mbetet në kuadrin e nevojave dhe kënaqësive individuale. Duke hedhur në letër e botuar rregullisht vështrimet e tij për librat që pëlqen, ai vihet në rolin e ndërmjetësit special mes librit dhe lexuesve. Merr kështu rolin e një shërbyesi publik, që ndërsa nuk ekziston në nomenklaturën zyrtare të funksioneve, i përgjigjet një kredoje më të lartë që përcakton vendin e intelektualit në shoqëri". Sipas poetit, prozatorit, esseistit e analistit të mirënjohur Zogaj, "Magjia e fjalës", përveçse një adresar titujsh për t'u lexuar dhe një koleksion citimesh që në lidhjen e tyre krijojnë një buqetë perlash për njohjen dhe kujtesën, është një shërbesë e madhe letrare dhe intelektuale në këto kohë të vështira për artin dhe kulturën. Nëse do të përfytyronim një "Urdhër" për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës si pasuri e shoqërisë dhe njerëzimit, Halil Rama është aty në shërbim të librit në gjuhën shqipe.

Duke vijuar në të njejtën linjë, prof. Bujar Kapexhiu - Nderi i Kombit vlerësoi krijimtarinë rezultative të Halil Ramës, në arsenalin krijues të të cilit tashmë janë 20 vepra mjaftë cilësore, që nga monografitë "Një filozof popullor në oborrin mbretëror" (kushtuar mendimtarit dhe patriotit dibran Dine Hoxha), e "Muharrem Xhediku-kompozitori i tangos shqiptare", "Rrahman Parllaku-një legjendë në kufirin e dy kohëve", "Muhurri-histori dhe personalitete", e deri tek më e fundit "AND-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut, botuar dhe promovuar vetëm para disa ditësh.

"PËR HALIL RAMËN, E PARA ËSHTË SHQIPËRIA"

Mbresëlënëse qe për pjesëmarrësit edhe fjala e shkrimtarit Shpendi Topollaj, i cili ndër të tjera tha se "Me shkrimet e tij për njerëzit që lanë gjurmë të pashlyera në fatet e krahinës apo atdheut, një intelektual i përkushtuar, i kulturuar dhe i ndershëm si Halili, qoftë edhe me ngjyrime letrare, ka dhënë ndihmesën e tij në saktësimin e historisë. Krijimtaria e tij me përmasa shkencore, si në gazeta ashtu edhe në librat e tij monografikë, me shembujt që ai ka zgjedhur dhe analizuar, është njëkohësisht edhe një kontribut i çmuar në rritjen e ndjenjës së dashurisë për vendin tënd, krenarinë për qenien shqiptar, përpjekjet për bashkim kombëtar, i prirjes për ta respektuar tjetrin si vëlla, i largimit të urrejtjes e përçarjes, dhe sidomos i besimit të palëkundur se Shqipërinë do ta bëjmë ne dhe vetëm ne, e jo të huajt, kushdo qofshin ata".





Ndër të tjerë, të pranishëm ishin Prof. Bujar Kapexhiu - Nderi i Kombit;poetët, shkrimtarët dhe politikanët Preç Zogaj e Besnik Mustafaj;Prof.asoc.dr.Bernard Zotaj; Prof.dr.Shefqet Hoxha, Prof.dr.Ylber Bezo-President i Kolegjit Universitar të Biznesit; Prof dr.Jashar Demiri, Presidenti i këshillit Atlantik të Shqipërisë, Dr.Arian Starova, gjeneral Piro Ahmetaj, Muharrem Gjoka-Mjeshtër i Madh, President i Ansamblit Artistik "Hazis Ndreu"-Nderi i Kombit; sipërmarrësit e suksesshëm Musa Riçku, Faik Bruçi, Latif Miha e Astrit Kuçi; shkrimtarët dhe poetët Sakip Cami e Demir Rusi, botuesi Bujar Karoshi, gazetari i njohur Defrim Methasani etj.



Kadri Tarelli, një tjetër shkrimtar i njohur nga Durrësi e vlerësoi Halil ramës si një personalitet që nuk resht të dojë dhe nderojë mëmëdheun. "Personalisht jam takuar rrallë, por kam njohur një pjesë të mirë të krijimtarisë së tij letrare e publicistike, dhe ca më shumë ç'kanë thënë të tjerët për të, ku përfshihen pena të njohura të letrave shqipe. Besoj se të bëhesh personazh i ajkës letrare kombëtare, është nderim dhe lakmi për të gjithë krijuesit", -tha Z.Tarelli. Një gjykim i shpejtuar, por jo i nxituar, e shtyn ta shtrydh mendimin se: Në të gjithë prodhimtarin e tij intelektuale, që dikush e quan, "Testament i vyer historiko-kulturor", dominon atdhedashuria, si kumti më i qenësishëm për çdo shqiptar. Fjalia e, shkurtër se, "Atdheu fillon nga familja", në mënyrë lakonike flet shumë, duke jetësuar një fjalë të urtë Amerikane, që thotë: "Dashuria e madhe për atdheun, lind nga dashuritë e vogla për vendlindjen". Të gjitha më çojnë në mendimin logjik, se "Për Halil Ramën, e para është Shqipëria".

HALIL RAMA I KA DHËNË SHOQËRISË VLERA CILËSORE KRIJUESE NË DISA ZHANRE NJËKOHËSISHT

Mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e z.Halil Rama foli akademik Fatos Daci, i cili moderoi këtë event, ndër të tjera tha se "Tashmë, Halil Rama është aktor dhe faktor i vlerësuar në fushën e gazetarisë dhe të monografisë, ku nuk është rastësor, ku nuk është kalimtar, pasi me dekada, në vijimësi, ka qenë dhe është një zë i fuqishëm dhe i afirmuar, duke i dhënë shoqërisë vlera cilësore krijuese në disa zhanre njëkohësisht". E rëndësishme , -sipas tij, është se, në gazetari, nuk ka kryer detyra të dorës së dytë e të tretë, apo të korrespondetit e kronikanit të thjeshtë, pasi ka kryer detyrën e gazetarit-redaktorit në dy nga gazetat më të mëdha ditore të vendit dhe detyrën e kryeredaktorit e të drejtorit në 5 (pesë) gazeta të tjera periodike, punë që aktualisht e kryen edhe sot.

"Mjeshtri i Madh Halil Rama është qëmtues i hollë i ngjarjeve e fenomeneve shoqërore dhe politike, kërkues i palodhur i personazheve të tij, të cilët mbartin vlera përgjithësuese, shoqërisht të dobishme. Personazhet e këtij autori, asnjëherë nuk kanë qenë rastësor dhe të çfarëdoshëm, por janë të përzgjedhur dhe me vlera e kontribute në fushat e tyre", tha botuesi i gazetës "Dibra" Fatos Daci.Kjo sipas tij për faktin se Halil Rama ka lëvruar me sukses, si shkrimtar, edhe fushën e monografive historike për fshatra, krahina dhe personazhe.Deri më tani, ka shkruar e botuar 20 monografi, që të gjitha të mirërealizuara dhe me vlera ideo-artistike, të cilat kanë përcjellë te lexuesi i shumtë vlera të padiskutueshme letrare, historike e shoqërore.

Vlerat publicistike, letrare e qytetare të akademik Halil Rama, Mjeshtër i Madh, u shpalosën para pjesëmarrësve dhe nga:akademik Arjan Hamiti, prof. dr. Bernard Zotaj, prof dr.Ylber Bezo-President i Kolegjit Universitar të Biznesit, prof. Shefqet Hoxha, prof.Jashar Demiri, Gjinovefa Kadriu-Këshilltare e kryebashkiakut Veliaj;, Bashkim Lami-kryetar i shoqatës "Bulqiza", inxh.Munir Hoxha, akademik Xhelal Marku etj.

Ndër të tjerë, të pranishëm ishin edhe poeti, shkrimtari dhe politikani Besnik Mustafaj, Presidenti i këshillit Atlantik të Shqipërisë, Dr.Arian Starova, gjeneral Piro Ahmetaj, Prof.asoc.dr.Bernard Zotaj; Prof.dr.Shefqet Hoxha, Prof.dr.Ylber Bezo-President i Kolegjit Universitar të Biznesit; Prof dr.Jashar Demiri, Muharrem Gjoka-Mjeshtër i Madh, President i Ansamblit Artistik "Hazis Ndreu"-Nderi i Kombit; sipërmarrësit e suksesshëm Musa Riçku, Faik Bruçi, Latif Miha e Astrit Kuçi; shkrimtarët dhe poetët Sakip Cami e Demir Rusi, botuesi Bujar Karoshi, gazetari i njohur Dëfrim Karahasani, etj.

Kësisoj, Halil Rama ndau me miqtë, kolegët dhe personalitete e krijimtarisë letrare e publicistike në vend dy gëzime: përuroi librin "Magjia e fjalës"dhe mori titullin "akademik"nga Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe Arteve, me seli në Nju Jork – SHBA.

Shpëtim Toska do të shkruante me Korabin faqe suksesi në planin individual, duke shënuar në karrierën e tij plot 320 gola

Flet "Maradona i Dibrës", Shpëtim Toska:

Biografia m'u bë pengesë të arrija më shumë, por publiku ishte krah meje

Intervistoi: **Adriatik BALLA**

Ishte viti 1986. Tek Dinamo stërvitej me grupin një prurje e re, jo i panjohur, një prej më të spikaturve të atyre viteve, Shpëtim Toska. Kur gjithçka ishte gati dhe pritej federimi me "nëndetësen", lojtarin e ftojnë në zyrë dhe ia thonë hapur: "S'mund të luash me Dinamon, biografia juaj bëhet pengesë". Toska kthehet në Peshkopi, me skuadrën e Korabit. Kështu, biografia iu bë pengesë të kapte majat njërit prej talenteve më të mëdha të futbollit shqiptar, i mbiquajtur në kohën e tij "Maradona i Dibrës", për shkak të cilësive teknike dhe ngjashmërinë me lojën që bënte ikona argjentinase. E megjithatë, Shpëtim Toska do të shkruante me Korabin faqe suksesi në planin individual, duke shënuar në karrierën e tij plot 320 gola, kryegolashënues në Kategorinë e Dytë për 9 vjet rresht, duke i dhënë Peshkopisë emocione dhe duke pasur një kontribut jo të vogël në zhvillimin e futbollit në Dibër. Gazeta "SOT" sjell këtë fundjavë intervistën me këtë legjendë të futbollit dibran, njeriun e urtë e profesionist, dibranin model, Shpëtim Toska.

Kush është Shpëtim Toska?

Datëlindja: 08.02.1960
Vendlindja: Peshkopi, Dibër
Klubi i karrierës: Korabi Peshkopi, Korabi Dibër e Madhe
Roli në fushë: Sulmues i majtë
Arritjet e vlerësimet
- Gola në karrierë 320
-9 vjet rresht kryegolashënues i Kategorisë së Dytë
-Mban titullin "Mjeshtër Sporti" nga viti 1991
-Nga këshilli bashkiak i Dibrës dhe nga Bashkia e Peshkopisë mban titujt "Nderi i qytetit" e "Qytetar Nderi i Dibrës".

- Duket e pabesueshme, por ju e keni ndërtuar karrierën vetëm me një skuadër, Korabin. Pse kështu?

Unë kam luajtur me Korabin e Peshkopisë nga viti 1972 e deri në vitin 1991. Më pas, 1992-1994, kam luajtur me Korabin e Dibrës së Madhe.

- Si ka ndodhur që u angazhuat në futboll?

Ishte viti 1967, isha 7 vjeç, te xhamia e Peshkopisë, e cila u prish dhe ambientet e saj u kthyen në fushë basketbolli. Aty e kam nisur me fëmijët e lagjes, aty u brumosa. Në vitin 1971 më morën me pionierët, u ngritën grupet, u hapën klasa sportive. Unë doja që të dilte një grup mangët që të më fusnin mua. Në një moment mu dha mundësia dhe unë tregova vlera. "Po ku paske qenë ti more", më thanë. Në fillim e nisa me atletikën, me trajnerë H. Shehun, E.Sadikun dhe trajneren Sh.Delishi. U bë një spartakiadë, do të shkonim në Vlorë. Para se të niseshim bënim prova në kërcime. U luta e u luta e më në fund ma dhanë një mundësi. Kërceva së larti 20 cm më shumë se ai që kishin planifikuar. Pasditen e asaj dite shkuam në gjendjen civile për të bërë letrat e të më certifikonin si sportist të klubit dhe në Vlorë dola i dyti në rang kombëtar, madje theva dhe rekordin e pionierëve. Nga 23 pikë të ekipit tonë 12 i mora veç unë. Me Korabin ndeshjen e parë e kam bërë në moshën 13-vjeçare. Më pas, kur isha 14 vjeç, me trajner Naxhi Lazimin, më futi një çerek ore nga fundi. Bëra një gol e në golin e dytë të skuadrës bëra disa veprime të bukura. Aty mora emër, publiku ngrihej në këmbë dhe kërkonte aktivizimin tim.

- Karriera juaj ishte e kushtëzuar nga biografia në atë kohë. Ndoshta ky është dhe pengu juaj që nuk mundët të luanit në elitën e futbollit shqiptar dhe në ekipin kombëtar. Ju ishit shumë afër Dinamos, por diçka shkoi keq, si qëndron e vërteta?



Në sistemin e kaluar këto probleme ekzistonin dhe mua më ra pjesë edhe t'i përjetoja. Në vitin 1986 mua më kërkoi Dinamo dhe unë bëra dy javë stërvitje atje, por situata ndryshoi krejtësisht në disfavorin tim kur erdhi puna të bëheshin letrat. Unë isha nip bejlerësh, nga ana e nënës kisha një gjysh të pushkatuar dhe ky ishte problemi. Njerëzit shkruanin, një pjesë edhe për arsye se donin që unë të mos largohesha nga Peshkopia, pra të më shihnin në fushë me Korabin. Më morwn në zyrë e më thanw hapur: "O Toske, po a vetëm me ty merren këta njerëz, nuk kanë punë tjetër? Me këtë CV që ke ti, për më tepër që ky është klub i Ministrisë së Brendshme, është e pamundur të luash këtu". Në fakt trajneri më donte, më kishte parë në stërvitje e në ndeshje dhe dëshironte që unë të luaja për Dinamon, por i tillë ishte sistemi. U detyrova u ktheva në Peshkopi, të luaja me Korabin.

- Keni qenë shumë pranë Kombëtares në një moment të karrierës tuaj…

Jam grumbulluar një javë me Kombëtaren, në vitin 1985. Në fakt u bë grumbullimi i Kombëtares A dhe B. Nga Korabi ishim unë dhe Prençi. Na grumbulloi zv/trajneri Medin Zhega. Ky grumbullim u bë thjesht për të testuar elementët, për të parë talentet e Kategorisë së Dytë, më pas u shpërndamë.

- Me Korabin keni shënuar shumë gola në Kategorinë e Dytë. Sa gola keni shënuar në karrierën tuaj?

Kam shënuar shumë, rreth 320 gola, por këtu përfshihen edhe golat që kam shënuar në Dibër të Madhe me Korabin atje. Në Kategorinë e Dytë të atyre viteve kishte goxha cilësi, pasi luanin ekipe si Fieri, Kavaja etj që binin nga Kategoria e Parë, por edhe skuadra të tjera, kishte rivalitet. Nga viti 1981, e në vazhdim, unë kam qenë për 9 vjet rresht kryegolashënues i kësaj kategorie. Periudha më e mirë ka qenë me 27 gola në 18 ndeshje, në vitin 1981.

- Sipas jush, kur ka qenë Korabi më i mirë ndonjëherë?

Mendoj se skuadra e viteve 1984-1988 ka qenë Korabi më i mirë. Në ato vite ne e mbyllnim fazën e parë në vend të parë e në fazën e dytë binim në vend të dytë. Por duhet të themi edhe këtë tjetrën që në atë kohë infrastruktura rrugore e bënte të vështirë për ne dhe për ata që vinin të luanin me ne. Për ekipet që vinin nga zonat e tjera duhej 3 ditë rrugë vajtje-ardhje, kjo sillte shqetësime. Prandaj skuadrat e Peshkopisë dhe të Gjirokastrës nuk preferoheshin shumë në Kategorinë e Parë.

- Ju keni një episod me mbrojtësin e Vllaznisë Hysen Dedja. Është folur shumë për atë ngjarje…

Luanim për ndeshje kupe, Korabi kundër Vllaznisë. Ishte ndeshje deçizive, po të fitonim shkonim në katërshe. Në fillim shënoi Vllaznia, por ne e rritëm lojën dhe u angazhuam ta kthenim rezultatin. Unë isha protagonist me aq sa mundja, por ai u fut ashpër disa herë, por në një moment bëri një ndërhyrje të gabuar, që rezultoi e dëmshme, pasi mu thye këmba. Ndodhi ditën e ditëlindjes time, me 8 shkurt 1987. Qëndrova 3 muaj jashtë, por në atë kohë partia u interesua për mua dhe u bënë përpjekje maksimale që të shërohem sa më shpejt e të rikuperohem e të riluaj sërish. Natyrisht që kjo të pengonte, sepse binte niveli, do të luaje më i kujdesshëm duke iu shmangur ndërhyrjeve. Por luajta me pllaka në këmbë edhe për disa vite të tjera dhe pllakat i kam ende në këmbë.

- Ju keni luajtur sulmues, por a keni provuar të luani në role të tjera? Cila ka qenë arma juaj më e fortë si lojtar?

Unë kam luajtur gjithnjë sulmues i majtë, por kam mundur të integrohem edhe në skemën me dy "pyka". Arma ime më e fortë mendoj se ka qenë driblimi. Por që të arrish nivele të tilla duhet stërvitje e madhe dhe e vërteta është se në atë kohë bëhej më shumë stërvitje se tani, madje ne bënim stërvitje më shumë se atletika sot.



Në fazë përgatitore detyroheshe të stërviteshe fort, por dua të them edhe këtë tjetrën që unë kam pasur kushte cilësore, kam pasur trajtim special.

- Kush kanë qenë idhujt tuaj në atë kohë?

Unë simpatizoja Tiranën e atyre viteve, me Agustin Kolën, Tit Dibrën, por edhe Muça që ishte lojtar i veçantë.

- Shumë figura të futbollit zgjedhin të bëjnë trajnerin pasi lënë futbollin. A e ushtroni ju këtë profesion?

Unë punoj trajner me grupmoshat U-15 dhe U-17, në cilësinë e specialistit të klubit të Korabit. I kam qëndruar besnik Peshkopisë. Populli këtu më do, më respekton dhe ndihem mirë.

- Korabi nuk ia doli të kthehet në elitë këtë sezon, iu afrua shumë, por s'ia doli. Çfarë mendimi keni për ekipin?

Futbolli është i bukur, shkon afër objektivit por në fund s'ia del. Gara i ka këto, ka dhe të papritura, por grupi s'duhet të jetë pesimist, do ta provojnë prapë sezonin tjetër.

- A ka talente në Peshkopi aktualisht?

Ne kemi pasur vazhdimisht elementë të mirë, por sapo kapin një moshë të caktuara ata ikin në shkollë dhe largohen nga Korabi, duke u aktivizuar gjetkë. Megjithatë, mund të them se punohet mirë në Peshkopi me moshat. Presidenti i klubit Fehmi Meziu na ka mbështetur. Madje kemi investuar edhe në futbollin e femrave dhe sot që flasim kemi 34 vajza në dispozicion që do të seleksionohen, për të pasur një ekip cilësor vajzash. Këtë skuadër e drejton Nefize Kapxhiu. Për t'u përgëzuar janë familjarët që i kanë besuar vajzat të luajnë futboll.

- Ju jeni specialist futbolli. Na jepni një mendim për ekipin kombëtar sot, nisur dhe nga zhgënjimi i madh që pësuan tifozët nga rezultatet e fundit. Çfarë nuk shkon me skuadrën?

Ka ndryshime të shpeshta që nuk më pëlqejnë, skuadrës i duhet një stabilitet, gjë që i mungon. Në 20 lojtarë, 13 duhen në skuadër. Ndërkohë, janë disa lojtarë që japin shumë jashtë vendit, me skuadrat e tyre, ndërsa në Kombëtare nuk e kanë atë rendiment. Mendoj se këtu çalon trajneri, ka diçka që stafi s'po i merr 100% grupit. Kam rezerva për mënyrën e drejtimit të Rejës, janë shumë fakte, duhet menduar edhe për një lider në skuadër. Më parë ekipet tona kishin 1 e 2 lojtarë që e udhëhiqnin grupin në fushë, sot skuadrës i mungon një lider. Shkurt, duhen ndryshime, sepse ekipit i mungon stabiliteti.

Marrë nga gazeta "Sot"

https://sot.com.al/sport/flet-maradona-i-dibres-shpetim-toska-biografia-mu-be-pengese-te-arrija-me--i522105?fbclid=IwAR1OL74-bBPCV95w187UyOFmDXHzKBCfPwlpXtpm9upapKtp2xWRI_CpEd4

Rruga e Arbërit nr. 190

kujtesë

Një bust në vendlindje, në Bllatë, në ndarje së Rrugës së Arbrit drejt Dibrës së Epërme dhe Dibrës së Poshtme, në 100 vjetorin e lindjes së ADIVIJE HASAN LAZRIT...

Adivie Lazri, zonja e hekurt e maleve të Dibrës

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Njihni ADIVIE LAZRIN?

Brezi im e njeh. Mjafton të shkruash emrin ADIVIJE LAZRI dhe në kujtesë të vjen e gjallë, një grua-burrëreshë, e hekurt në punë dhe në jetë. Ajo jetoi në një kohë të vështirë, më të vështirën për një brez femëror, por më të lavdishmin për kontributet që dha në betejën që filloi ato vite, betejë që vazhdon edhe sot, emancipimin e gruas, emancipimin e shoqërisë shqiptare, ende nën thonjtë e obskurantizmit mesjetar.

Për të rinjtë dhe të rejat po e sjell zbehtë, se heroizmin e saj me shoqe nuk e nxënë volume të tëra.

Adivie Lazri lindi më 10 janar të vitit 1923 dhe u nda nga ata që i desh dhe e deshën më 6 shtator 1999, në moshën 76 vjeç, ende e re për ti dhënë[Dibrës vlerat e saj...

Lindi në Bllatë të Epërme të Maqellarës në një familje të varfër fshatare. Pesë klasë të fillores i kreu në Allajbegi ndërsa shtatëvjeçaren në Maqellarë... Në vitin 1942 i vdes babai, për ti lënë më të madhes, Adivijes, ndër katër fëmijët e Hasan Lazrit, motrës dhe dy vëllezërve barrën e rëndë të familjes. Thonë se ishte një vajzë e shkathët, e kudogjendur, e dashur dhe e lidhur me njerëzit.

Bashkë me Zife Gjocin Adivie Lazri zgjidhet për të drejtuar organizatën e rinisë dhe të gruas në fshat. Një detyrë e vështirë në kushtet e asaj kohe kur vajzat dhe gratë ishin nën trusninë e një jete të mbyllur nga zakonet dhe nga paragjykimet shoqërore e fetare. E kjo trusni fillonte në gjininë dhe gjakun e saj, xhaxhallarët e të tjerë



që nuk e kuptonin të renë që kishte lindur e ecte duke mposht konceptet e paragjykimet prapanike. Dy nipërit e saj, Dilaver e Xhetan Muça iu bënë krah dhe barrikadë mbrojtjeje...

Në vitin 1945 në Bllatë vjen si doganiere një personalitet i gruas Dibrane, një ndër veprimtaret më të dalluara të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare Sibe Gjura. Adivija e priti me gëzim duke i lëshuar për jetesë, bashkë me djalin e saj Maliqin, një dhomë të familjes së saj. Bashkë me Zife Gjocin e prezantuan Sibe Gjurën fshat më fshat duke u pranuar me respekt e dashuri si banore e Bllatës së Epërme.

Në vitin 1946 emërohet instruktore e organizatës së Bashkimit të Grave të Shqipërisë për Dibrën. Në vitin 1947 zgjidhet kryetare e Bashkimit të Grave të Shqipërisë për rrethin e Dibrës.

Që nga viti 1946 e deri në vitin 1969, për 23 vjet ka punuar me gratë në Dibër... Për një njeri që nuk e njeh kohën, që nuk ka lexuar asgjë e nuk ka dëgjuar për vështirësitë e atyre viteve kur buka, për shkak të luftës qe kthyer në legjendë, kur niveli arsimor dhe kulturor i popullit ndriçohej vetëm nga 32 shkolla fillore me 1280 nxënës e 62 mësues, kur zakonet prapanike rëndonin egër mbi shpatullat dhe qenien e gruas, është vështirë ta kuptosh vajzën e re Adivije Lazri në detyrën saj për emancipimin e vajzës dhe gruas dibrane.



"Sikur të isha djalë" shpërthente në një roman shkrimtari dibran Haki Stërmilli ku vajza dibrane e kërkonte të ardhmen jo në gjininë e saj, si vajzë dhe grua, por si djalë, si burrë.

Adivije Lazri do të bëhej simbol i kohës që vajzat dhe gratë të dilnin në dritë me tërë dhuntitë e saj, të punës, të personalitetit, të jetës shoqërore, të arsimit, kulturës...Një rrugë e gjatë, e vështirë, me shumë pengesa që obskurantizmi do ta shihte në grykën e pushkës.

"Shkollë femërore e mashkullore në Peshkopi, në Brezhdan, Bellovë, Grevë..." shkruhet në një dokument të 14 nëntorit 1934...***"Shkollë femërore në Peshkopi me dy mësuese dhe 66 nxënëse..." "Shkollë fillore e përzierë në Allajbegi me një mësues dhe 90 nxënës ..."***

E ndarë shihej vajza dhe gruaja dibrane, e ndarë në shtëpi ku shprehej se edhe trarët qajnë kur lind vajzë, e ndarë në shkollim, edhe në atë pak dritë dijeje që vinte nga pak vite larg, e ndarë në punë, jetën shoqërore. Ajo ishte e detyruar që botën ta shihte përmes perçes së zezë mbi fytyrë...

Duheshin pishtarë që fytyra e gruas dibrane të merrte pak dritë. E një ndër këta pishtarë do të ishte vajza e re nga Bllata e Maqellarës...

Nga arkivi im, lundrim faqe gazetash të atyre kohëve po përcjell disa tituj kronikash...

18 maj 1946

Pardje u bë në këtë qytet inaugurimi i maternitetit. Ky institut u ngrit me iniciativën dhe punën e palodhur të gruas antifashiste.

U bë inaugurimi i maternitetit edhe në Zerqan... Për herë të parë ngjet që Qeveria të hapë maternitet nëpër krahinat...

29 maj 1946

Me një ceremoni të thjeshtë ku merrnin pjesë mjaft të ftuar...u bë inaugurimi i shtëpisë së kulturës... Është e para herë që në Peshkopi hapet një shtëpi kulture, e cila do të jetë një vatër për përhapjen e kulturës së re.

2 qershor 1946

Në nënprefekturën e Qendrës hapen 16 shkolla fillore dhe një shkollë unike.

6 nëntor 1946

Në qytetin e Peshkopisë funksionon një bibliotekë popullore e cila frekuentohet mesatarisht prej 150 lexuesve në muej.

Në gazetën "Bashkimi" 2 qershor 1946 krahas njoftimit se ***"Në nënprefekturën e qendrës hapen 16 shkolla fillore dhe 1 shkollë unike"*** shkruhet që ***"Ngrihen 58 kurse kundër analfabetizmit me 875 nxënës dhe tre stacione shkollore. Japin mësim 37 mësues" Shkruhet se "I gjithë populli***



ka bërë 19.288 orë punë vullnetare në sektorin e arsimit, duke i kursyer pushtetit 90.400 franga shqiptare"

Për të zhvilluar arsimin dhe kulturën në këtë kohë gratë dhuruan edhe kujtime të çmuara të jetës së tyre. Në gazetën "Bashkimi" shkruhet se ***Safije Baholli dhuroi një palë vathë floriri kurse Mereme Shehu një myhyr floriri. "***

"Bashkimi" shkruan më 12 korrik 1946 ***se "Populli i Peshkopisë u shpall garë gjithë prefekturave të Shqipërisë" me pikë të parë "Ngritja e 37 shkollave fillore".***

Shkolla pedagogjike e Peshkopisë, "universitet" i verilindjes së Shqipërisë, hapur në vitin 1947, do të ishte një shkollë "mashkullore" për shumë vjet derisa në vitin 1959 do të dilnin prej saj kontingjenti i parë i madh me mësuese të reja; Tefta, Kumria, Hidja, Sanie Berisha, Sanie Zeneli..., për të shpërthyer kënga-valle:

Oj Sanie oj motër-ooo
Hiqe vallen rrotull-ooo

Deri atëherë në Dibër do të vinin mësues e mësuese nga e gjithë Shqipëria. Nga një letërkëmbim me mësuesen time në Brezhdan NIGJARE VINÇANI në vitin 1951 po shkëpus një fragment që flet qartë për heroikën e një brezi që përcolli në Dibër emancipimin e gruas





dhe dibrane...

"Akoma pa mbushur 16 vjeç, pas një kursi metodik pedagogjik, lash Beratin dhe erdha në Peshkopi, fillimisht në fshatin Brezhdan, i cili më ka lënë mbresa të paharruara në kujtesë dhe pastaj në kufi, në fshatin malor të Cerjanit ku e ndjeva veten në shtëpinë time. Pra për herë të parë hyra në jetë, në punë si arsimtare për tu dhënë njohuritë e para të gjuhës sonë të bukur shqipe vocërrakëve aq të etur për dije. Në këtë kohë aq të vështirë për të jetuar ku përveç varfërisë qemë të detyruar të përballemi edhe me kërcënimet dhe ofendimet e disa skeptikëve apo keqdashësve që e shihnin si luks duke ndikuar që fëmijët e sidomos vajzat të mos ndiqnin shkollën. Pra ne arsimtarëve të atij brezi na duhej jo vetëm të jepnim mësime në shkollën fillore etj. por edhe të shkonim në çdo familje, shtëpi më shtëpi për tu mbushur mendjen disa prindërve që hezitonin të dërgonin fëmijët në shkollë si dhe për të grumbulluar të gjithë analfabetët në kurset e luftës kundër analfabetizmit që i zhvillonim mbrëmjeve pas pune.

Për mungesë të klasave dhe numrit të domosdoshëm të arsimtarëve na duhej të jepnim mësim në klasa kolektive. Puna kaq e ngarkuar na detyronte të përgatisnim planet e punës për dy klasa dhe kurset e analfabetizmit deri natën vonë. Por kjo punë, megjithëse e lodhshme nuk na demoralizonte, përkundrazi ndjenim sadisfaksion. Ne e bënim këtë sepse e quanim për detyrë ndaj brezave, e quanim të domosdoshme dhe në asnjë mënyrë nuk na shkonte mendja se të kesh dhënë apo të japish mësim në fshat është ofendim apo ke qenë dhe je i persekutuar. Një mendim i tillë është ofezë për çdo patriot, ofezë për rilindësit që kthenin shtëpitë e tyre në shkolla dhe nën kërcënimin otoman apo të shovinistëve grekë, serb apo maqedonas, u jepnin dritë, pra u jepnin arsim fëmijëve shqiptarë të lënë në errësirë duke sakrifikuar edhe jetën. E pra, këta, qenë frymëzimi për ne dhe e quanim për nder të mësonim fëmijët e malësorëve të lënë në errësirë e injorancë pa shkrim e lexim."

Ishte e vështirë "koha" e Adivije Lazrit. Pikërisht në rrjedhë të kësaj kohe i takoi të punojë. Kohë e vështirë ekonomike, nivel të ulët shëndetësor përballë epidemive (Një spital me 25 shtretër kishte Dibra në vitin 1946. Një spital vetëm në qytet. Asnjë në fshat. Pesë spitale do të kishte në vitin 1966, dy në qytet dhe tre në fshat me 223 shtretër... Zakone prapanike e paragjykimet fetare, veprime subversive që morën jetë veprimtaresh, hakmarrje e gjakmarrje, fillesat e kolektivizimit, tensione të luftës së klasave e një sërë problemesh që për gratë ishin të panjohura e të pa përgatitur për ti përballuar, lidhur kjo edhe me analfabetizmin dhe nivelin arsimor, presionin ndaj tyre që nga familja e akoma më shumë në rrethin e gjerë shoqëror.

Dy ngjarje të mëdha, hapja e Rrugës së Rinisë Kukës Peshkopi në vitin 1946 dhe aksionet kombëtare si ai i hidrocentralit të Ulzës do të ishin një shkollë e madhe për vajzën nga Bllata, tash drejtuese të gruas dibrane. Dy herë do ta çonte motrën e saj, Seren 14 vjeçare në aksionin e dritës. Do të shkonte edhe shoqja e saj e punës dhe e aksionit Hasie Miftari (Pira) një fotografi të së cilës po e përcjell si dokument i kohës ashtu siç po përcjell edhe shumë foto të tjera... Në këtë vorbull të paparë problemesh vajzës së re nga Bllata e Maqellarës iu desh ta përqendrojë vëmendjen në ngritjen e nivelit të punës të organizatës së BGSH në çdo fshat: Krijoi grupe që u shquan për veprimtari kudo. Në Sllovë aktivizoi Fidaie Rexhën e cila shtëpinë e saj e ktheu në spital partizan, në Lurë Dile Vladin, në Mqellarë Zife Gjocin e Zirakë Gjonin, në Shupenzë Sibe Gjurën e Hasije Miftarin (Pira), në Ostren Hazize Muçën, në Klenjë Hatixhe Avdën, në Brezhdan Aishe Hajrullain etj. Të gjithë veprimtaritë i ndiqte vetë. Në kushtet e kohës në të shumtën e fshatrave shkonte në këmbë. Edhe në dimër i ka takuar të shkojë me Dila Vladin në fshatrat Kumbull e Mërkurth asokohe pjesë e Dibrës...

"Nga viti 1972 deri në vitin 1986, kujton vëllai i saj Shahin Lazri, kemi jetuar 7 persona në një hyrje të vogël prej 42 metro katrore, Adivija dhe unë bashkë me familjen..." Adivije Lazri do të mbahet mend si një nga deputetet e para gra të Dibrës, deputete në tre legjislatura të Kuvendit Popullor, si anëtare e Këshillit Popullor të Rrethi, anëtare e Byrosë së Partisë të rrethit, drejtuese të kuadrit në Ndërmarrjen Tregtare dhe Ndërmarrjen e Prodhimeve të ndryshme, si një grua e hekurt dibrane që dha gjithçka për Dibrën dhe gruan e vajzën dibrane.

Adivije Lazri përgatiti dhe la pas një brez të gjerë veprimtaresh të gruas dibrane...Tefta Cami, Sanije Batku, Sheza Balliu, Rina Rena, Ismete Jashari, Bukurie Kaja, Kumrie Shehu, Hatixhe Avda, Lirie Rexha, Lirie Rasha, Mira Neziri, Vera Muça, Hajrie Karasani, Hamdie Beqiri, Kimete Goxhi, Violieta Kola, Nevrez Manjani, Merita Lala, Dashurie Gjunkashi, Sanie Çipuri, Eli Gushi etj., etj., për të ardhur tek gratë e ditëve të sotme, Frezileta Gjika, Marjana Bulku Zeneli, Miranda Troci Derti, Margarita Markja ... që janë në ballë jo vetëm të grave por edhe të burrave të Dibrës që i thonë JO SKAVICËS, jo zhdukjes përgjithmonë të luginës së saj pjellore e historike të Drinit të Zi e të mbarë Dibrës, me guxim qytetar, me dije shkencore e kulturë të gjerë publike.

Më 10 janar 2023, jo larg, 9 muaj më pas, Adivije Hasan Lazri ka përvjetorin e NJËQIND të lindjes.

Një vlerësim publik i saj, një bust në vendlindje, në Bllatë, në ndarjes së Rrugës së Arbrit drejt Dibrës së Epërme dhe Dibrës së Poshtme, do ti bënte nder Trevës... Një firmë imja si gazetar, firmë që me siguri do ta nënshkruajnë mijëra burra e gra që e njohën dhe jetuan kohën e saj, në një kërkesë drejtuar Këshillit Bashkiak të Dibrës që ADIVIJE LAZRI të nderohet me titullin "NDER I DIBRËS", një bust në vendlindje, në Bllatë, në ndarjes së Rrugës së Arbrit drejt Dibrës së Epërme dhe Dibrës së Poshtme, do ti bënte nder Trevës...

31 maj 2022

Meditim për Xhixhen, gjyshen e djemve të mi, Ermal e Arbër, si dhe Nënën e bashkëshortit tim... me rastin e 5 vjetorit të vdekjes.

Duert e Nànës...

Nga **Kujtime ISLAMI - SARAÇI**

Dihet që vetëm e sotmja është reale, ekziston, kurse e kaluara dhe e ardhmja nuk ekzistojnë. Kjo s'do të thotë që ne s'mund të flasim apo të shkruajmë për to. Kjo s'do të thotë që ka dhe përjashtime... Për shumë e shumë arsye. Ka dhe njerëz që mbeten të pavdekshëm, në kuptimin që jeta, sjellja, veprimtaria e tyre mbeten përjetësisht në kujtesë, jo vetëm te familja, (që është normale) por dhe te shumë e shumë të tjerë.

Do të shkruaj dy fjalë për Xhixhen. E lindur më 5 janar 1927 në Dohoshisht, motër e katër vëllezërve: Besim, Fadil, Haqif dhe Shemsi, si dhe 2 motrave Zemrije dhe Urije në një familje të madhe (Bajraktari), e njohur për tradita patriotike e atdhedashëse dhe e martuar në një familje tjetër të njohur në rrethin e Dibrës, familje me vlera bashkëkohore, në familjen e veçantë Saraçi, ku jetoi me 3 kunetër, Munir, Ismail dhe Uzri, të cilët e mirëpritën në familjen e tyre dhe jetuan si një familje e madhe.

Pasi hyri nuse në këtë familje, emri i saj Xhile, u ndryshua, në Xhixhe, sinonim i së bukurës, së resë, begatisë që sjell ardhja e një personi nga një familje e fisme. Sipas zakonit dibran, Xhixhe nënkupton xhixhë, që xixëllon, rrezaton nur e hijeshi... Në fillim u thirr ashtu nga fëmijët e familjes, mëhallës, fshatit dhe më gjerë... Dhe nga fshatrat përreth, dalëngadalë filloi të përmendej më pak emri i vërtetë.

Jo vetëm fshati i saj Bellova, por edhe Cerjani, Zagradi, Rabdishti, kushdo që e njihte, fliste mw dashuri për të, hynte mik



Xhile Saraçi (Xhixhe)

në shtëpi të saj. Me këtë emër e thirrën dhe gjithë kuadrot, mësuesit, mjekët e zonës dhe të ardhur nga qyteti i Peshkopisë dhe nga gjithë Shqipëria. Për të gjithë ajo ishte dhe mbeti Xhixhja dhe Nëna e tyre.

Ajo lindi, rriti dhe shkolloi 6 fëmijë, duke u shquar secili në profesionet e tyre: inxhinieri, mjekësi, mësuesi, ekonomi, financë. Ishte vepër e saj që të 6 fëmijët shkëlqyen në çdo drejtim , nga puna e saj e palodhur, si në shpi, ashtu dhe në kooperativë, si një Nënë shembullore, duke u bazuar te tradita dhe duke përkrahur të renë dhe bashkëkohoren. Bujaria, mikpritja, pastërtia, e bukura, e reja, progresivja ishin tipare të saj.



Xhixhja në fejesën e nipit, Ermalit.

Ajo u shqua si një grua e rregullt, e qetë, komunikuese dhe me jetesën e përbashkët në të njëjtin oborr me 5-6 familje. Falë kujdesit të saj gjithçka ndriste dhe shkëlqente nga pastërtia, lulet shumëngjyrëshe dhe aromatike që ishin me të bukurat e gjithë zonës. Pavarësisht se familja saj ka pasur burra të njohur e me emër, ishte ajo që si në një prapaskene organizonte festat e sebepet e herëpashershme.

Xhixhja lindi, rriti dhe shkolloi 6 fëmijë, duke u shquar secili në profesionet e tyre: inxhinieri, mjekësi, mësuesi, ekonomi, financë. Ishte vepër e saj që të 6 fëmijët shkëlqyen në çdo drejtim , nga puna e saj e palodhur, si në shpi, ashtu dhe në kooperativë, si një Nënë shembullore, duke u bazuar te tradita dhe duke përkrahur të renë dhe bashkëkohoren. Bujaria, mikpritja, pastërtia, e bukura, e reja, progresivja ishin tipare të saj.



Trëndafilat e mbjellë nga dora e saj në Bellovë



Xhixhja me motrën dhe dy djemtë, Safeti dhe Selamiu



Xhixhja me vajzat, nuset dhe nipërit.

Ajo u shqua si një grua e rregullt, e qetë, komunikuese dhe me jetesën e përbashkët në të njëjtin oborr me 5-6 familje. Falë kujdesit të saj gjithçka ndriste dhe shkëlqente nga pastërtia, lulet shumëngjyrëshe dhe aromatike që ishin me të bukurat e gjithë zonës. Pavarësisht se familja saj ka pasur burra të njohur e me emër, ishte ajo që si në një prapaskene organizonte festat e sebepet e herëpashershme.

Ndihmesa e Xhixhes vazhdoi dhe ndaj nipave e mbesave, duke u kujdesur me shumë dashuri edhe për dy djemtë e mi, Ermalin dhe Arbrin...

Njeriu nuk duhet të mendojë vetëm për të tashmen dhe të ëndërrojë për të ardhmen. Duhet jo herë pas here, po shumë shpesh të kujtojë të kaluarën, të reflektojë, të dijë rrënjët nga ka ardhur, të jetë mirënjohës për gjithçka të bukur që ka përjetuar dhe ndaj çdo përkushtimi nga paraardhësit... Pa rrënjë, je një trung pa jetë, pa tokën ku do të vendosësh këmbët... Prandaj dua me gjithë shpirt që të gjithë brezat të bashkëjetojnë e të ndihmojnë njëri-tjetrin. Duke kujtuar këtë grua, Nënë, femër, trimëreshë, gjyshen e djemve të mi, Xhixhen e paharruar e të veçantë, që asnjëherë nuk e kam konsideruar si vjehërr, por ndërtova një marrëdhënie të bukur... Duke dhënë një shenjë, mesazh kujtese të gjithëve se jeta është apo bëhet dhe më e gëzuar, kur dimë të vendosim urat e komunikimit...

Do më pëlqente shumë të shkruaj dhe për takimin e parë me këtë Nënë, në vitin 1979... Një moment i veçantë e i paharruar... Kalimthi, në autobus, vetëm siluetën e saj pashë, dhe për të dyja ishte një emocion pozitiv, në kuptimin e pranimit reciprok të mirësisë dhe dashurisë së pastër... Duke njohur dhe dashur djalin e saj, si mund të ndodhte e kundërta??!!

Xhixhja vdiq më 11 korrik 2017, por do të jetë gjithmonë në zemrat tona.

Shpesh kam diskutuar me shoqe, gra, vajza për këtë marrëdhënie dhe rrallë e kanë pranuar mendimin tim, duke më quajtur naive... idealiste, po secili ka mendimin e tij dhe secilit sipas kokës, festes, thotë populli...

Një djalosh shqiptar zgjohet nga ethet dhe temperatura. Nuk kupton ku ndodhet, ëndërron vendlindjen, Shkodër, shpinë me bahçe plot drandofile... Dhe papritur, thërret:

- Nånë

- Deshët gjë zotëri? - e pyet e zoja e shpisë.

- Po, përgjigjet. - Duert e Nànës...

Ernest Koliqi

BOTIME TË REJA



ALBAN TUFA
Nishanet në formë L-je
Roman
Shtëpia botuese: Botimet Toena
Numri i faqeve 144
ISBN 9789928376022
Çmimi: 800 lekë

"Nuk më mori gjumi deri ndaj të zbardhur, deri atëherë kur zunë të këndojnë gjelat e tretë. Sa herë mëtoja t'i mbyllja sytë më shfaqej fytyra e A. Vreshit.

Mandej më përvijohej trupi i saj i bronztë, ashtu krejt lakuriq. Më shpërfaqej gjithë sa ajo kishte, gjithë sa unë kisha pasur tërë këto vite. Gjithë sa kisha velur prej saj sa e sa kohë, me idenë se isha i vetmi, krejt i vetmi. Sa nisja t'i shijoja këto pamje, përanash saj shpalosej edhe një trup burri, me një fytyrë që nuk e shquaja dot, me ca shpatulla që s'i harroj, shpatulla të cilat i pashë mbrëmë mbi trupin e saj, mbi krevatin tim.

Sa herë rrihja ta shtyja tutje imazhin e saj, më futej me përdhunë në kokë ashtu krejt e lakuriqtë, bashkë me pesë nishanet e saj në formën L-je në fundshpinë. Këtë nuk harron të ma paraqesë sa herë më përball me imazhin e saj."



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**
Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**
Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.
Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.
Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.
Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE JEMI GAZETË E LIRË DHE E PAVARUR NGA NDIKIMI POLITIK. PAVARËSIA DHE LIRIA JONË GARANTOHET VETËM NGA MBËSHTETJA E LEXUESVE... BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.** Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.

Dhurimet pranohen **VETËM PËRMES LLOGARISË BANKARE** që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë.
SWift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:
https://tinyurl.com/lcc3e2f

BIGmarket
një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani
GJITHMONË ME OFERTA...
PESHKOPI MAQELLARË